



"FUNDJAVA" ► Faqe 13-20

Prëfimi i Eda Zarit: Shqipëria është një dhimbje e bukur



Trafikimi
Gardistët seks me minorenën, ja klientët

► Faqe 10



Kryqi i Kuq
"Pallati i Princeshave" i yni, jo i Leka Zogut

► Faqe 11

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi FUNDJAVA

VITI II - NR. 128 E premte, 01-06-2012

së shpejti...

TELEVIZIONI MË I RI
INFORMATIV NË SHQIPËRI

A1 REPORT!
origina e lajmit...

TRONDITET UNIVERSITETI / Dekani dhe pedagogu zbulojnë implikimin e titullarit

REKTORI FIRMOSI PER DHENDRRIN Na thotë: Do ju shkel me këmbë

Thellohet skandali i provimeve të studentit Redi Shijaku. Mori provimet kur ishte në Britani. Dekani kundër rektorit Vejsel Rizvanolli: Ai e dinte se ku e kishte dhëndrrin. Pedagogu Ferdinand Mara: Më ka qëlluar fizikisht

AKUZAT

► Faqe 10



Kujdestaria për fëmijët, lirohet ish-gruaja e "Mirit të Xhikes"

KRIZA

► Faqe 9

Shkurtime në buxhet, eksperti: Pasoja negative në ekonomi

1 QERSHORI

► Faqe 21



Festa e fëmijëve, të rritur që duan ende lodrat e vogëlushëve

REPORTAZHI

► Faqe 22

Festivali i valles burimore, tri ditë feste në Lushnje

Lajmi

Mehmet Spahiu, dekani i fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, pranë Universitetit të Sporteve, pranon që pedagogëve edhe mund t'u ketë hedhur "hi syve" ndonjë student, por ai në gjithë këtë histori, bën fajtor kryesor rektorin, pasi në momentin që ka firmosur procesverbalin e notave të dhëndrit të tij, e dinte shumë mirë se ku ndodhej ai.

■ ■ ■ **TIRANE**

ESMERALDA KETA

Për dekanin e Shkencave të Lëvizjes, Mehmet Spahiu, fakultet në të cilin është student edhe dhëndëri i rektorit të universitetit të Sporteve, Vejsel Rizvanolli, por që dyshohet se i ka marrë provimet... ► vijon në faqe 2-3



Ferdinand Mara, mjeshtër i sportit



Rektori Vejsel Rizvanolli



Dekani Mehmet Spahiu

Analizë



NGA ADELHEID WOELFL

Një votim pa kandidat

Fama e Xhezair Zaganjorit nuk zgjati shumë. Të martën në mbrëmje ish-gjykatësi u dërgua nga koalicioni qeveritar në garën për president, që u zhvillua të mërkurën. Pak më vonë askush nuk kujtohej më për Zaganjorin. Sepse për tu votuar në parlament, Partia Demokratike e dinte se ishin të nevojshme 84 vota ose tri të pestat e deputetëve. Kandidati as nuk u zyrtarizua, duke u djegur. Kur zgjidhet presidenti në Shqipëri, duke pasur parasysh polarizimin politik, nuk ka gjasë që një kandidat të mbështetet nga kampi tjetër... ► vijon në faqe 6

Koment



NGA ELJAN TANINI

Qyteti ku fëmijët kanë harruar të luajnë!

Çfarë nuk bënim për të luajtur kopac ndër lagje! Çfarë nuk bëja për të shqyer kopsat e veshjeve në dollape! Si dënim, disa ditë pa dalë nga shtëpia! Pastaj fiksimi me rumbullaksinë duket më i hershëm, që me petat për të luajtur sërish me lagje dhe për të qenë më i miri me të cakturat e tyre! Shtrimi i ndonjë ruge me zhavorr, ishte shtimi i thesarit të petave! Më e shpifura? Kaladibrance, të duroje tjetrin mbi ty! Po futboll? Portier si gjithmonë!... ► vijon në faqe 21


RAUNDI II TE HENEN

Ruçi: Presidentin e zgjedh Meta LSI: Duhet takim Rama-Berisha

PS, debate në kryesi për kandidatët. PD: Nuk ka takim mes kryetarëve

■ ■ ■ **TIRANE**

JAKIN MARENA



E di Rama dhe Ilir Meta janë takuar dy netë më parë. Burime të Shqiptarja.com konfirmojnë se dy liderët e PS dhe LSI kanë zhvilluar... ► Faqe 4-7

NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Ushqime aziatike dhe meksikane
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshak, Tiranë. Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

Rregullorja, provimet e Lirimit vetëm në fletore

Provimet e Lirimit do të zhvillohen në fletore, krahas testit special. Për lëndën Gjuhë Shqipe do të përdoren fletore shkrimi, ndërsa për lëndën Matematikë, do të përdoren fletore me katrorë. Ky është udhëzuesi më i fundit i Agjencisë Kombëtare të Provimeve, në prag të zhvillimit të provimeve të Lirimit për nxënësit e klasave të nënta. Kështu, kreu i

AKP-së tërheq vëmendjen se për pyetjet me zhvillim, nxënësit do të shkruajnë numrin e pyetjes dhe në krah të saj të gjithë përgjigjen e nevojshme. "Nuk do të shkruani emrin tuaj në kapakun e fletores dhe në asnjë faqe të saj, pasi do të konsiderohet si shenjë", - thekson udhëzimi më i fundit. Sipas AKP-së, teza e provimit të Gjuhës Shqipe dhe Matematikës përmban

25 pyetje. Nga këto, 13 pyetje janë me qarkim, ndërsa 12 pyetje të tjera janë me shpjegim. "Përgjigjet e të gjitha pyetjeve do të shkruhen në fletore. Për pyetjet me alternativa do të shkruani në fletore si në shembullin më poshtë: Shembull, pyetja 1 C, pyetja 2 B", - thuhet në udhëzuesin më të fundit, të firmosur nga kreu i Agjencisë Kombëtare të Provimeve, Alfons Harizaj.

Mehmet Spahiu: Edhe pedagogët me përgjegjësi, sot verifikimet

Dekani i Sporteve: Rektori firmosi për dhëndërrin

Universiteti i Sporteve, sot mbledhje për provimet fantazëm

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

vijon nga faqja 1

...pa qenë në të vërtetë i pranishëm fare në Shqipëri, nuk largon nga përgjegjësia pedagogët e lëndës. Por, në një intervistë për "Shqiptarja.com", ai thotë se përgjegjësinë kryesore e ka rektori, pasi ai kishte lidhje të afërta familjare dhe e dinte shumë mirë se ku ndodhej personi në fjalë.

Profesor, si qëndron e vërteta e studentit tuaj Redi Shijaku?

Unë e lexova në gazetën tuaj këtë lajm, por në këtë moment nuk mund të të jap një përgjigje të saktë, pasi duhet të verifikohen dokumentet, nëse përputhen gjërat apo jo.

Por pedagogu i lëndës, i cili ka firmosur edhe procesverbalet, duhet ta dijë nëse x student ka qenë i pranishëm ose jo në provimin e tij?

Po sigurisht, pedagogu i lëndës, në momentin që i vjen lista emërore me studentët për të futur në provim, kuptohet që ai duhet të jetë i saktë për personat që janë përgjigjur dhe kanë marrë vlerësimin përkatës si dhe për personat që nuk janë paraqitur, ku në procesverbalin përkatës vihet shënimi "nuk u paraqit". Pa diskutim që pedagogu është direkt i lidhur me provimin.

Nëse ju vërtetoni se personi në fjalë nuk ka qenë prezent ditën e provimit, pedagogu i lëndës që ka firmosur çfarë përgjegjësie ka?

Unë e mendoj kështu. Sekretaria është starti i një veprimtarie administrative për një rast të tillë. Që do të thotë se pasi nxjerr zyrtarisht studentët që kanë bërë pagesat dhe që plotësojnë kushtet për të hyrë në provim, ata plotësojnë procesverbalin dhe e siglojnë që një grup prej 20 stu-



Rektori

Vejsel Rizvanolli, rektori i universitetit të Sporteve, deklaroi për gazetën se nuk i kishte bërë presione për notat asnjë student për dhëndrin e tij dhe gjithçka që flitej ishin vetëm thashetheme

Në foto:
Dekani
Mehmet
Spahiu

dentësh, hyn në provim. Kjo listë vjen në dekanat dhe dekanati bën thjesht një firmë përcjellëse, pasi nuk ka të drejtë vule. Nëpërmjet kësaj firme vërtetohet që pedagogu ka të drejtë të marrë grupin në provim. Ky pedagog pasi merr

Ndërsa rektori, kur bëhet fjalë për një personin e tij të familjes, nuk ka se si ta shmangi përgjegjësinë pasi ai e di shumë mirë nëse është jashtë

grupin në provim bën vlerësimin. Këtu me thënë të drejtën, përse i përket identifikimit të studentëve, vihet re një mangësi thelbësore që studentit jonë, që me sa di edhe e paguan 2 mijë lekë të vjetra, për kartën e regjistrimit, aktualisht nuk e ka. Dhe pasi mbaron ky provim dhe pedagogu bën vlerësimin përkatës, është rektori që përfundimisht e firmos

dhe mbi firmën e tij vihet vula dhe arkivohet në protokoll.

Unë dua të këmbëngulmërisht në një fakt, a ka faj pedagogu i lëndës që ka firmosur në notën kundër emrit?

Sigurisht që pedagogu nuk shmanget nga përgjegjësia, por ka dy gjëra. Në rastet kur pedagogu ka dijeni dhe ka bërë kompromis për këtë marrëdhënie, është diçka që rëndon mbi të dhe do të mbajë edhe përgjegjësinë, por ndoshta pedagogu, në një grup studentësh prej 150-250 vetash, që jo të gjithë i vijnë rregullisht në mësim, part-time dhe sistem ditë, ndoshta mund të mos jetë në gjendje t'i identifikojë të gjithë dhe mund t'i parakalojë ndonjë. Kjo nuk është se ia lehtëson gabimin, por së paku është një gjë që i ka ndodhur pa e kuptuar. Ndërsa rektori, kur bëhet fjalë për një personin e tij të familjes, nuk ka se si ta shmangi përgjegjësinë, pasi ai e di shumë mirë nëse është jashtë apo jo i afërmi i tij dhe të fir-

Mangësia

Dekani
nuk ka vull,
firmos
vetëm rektori

Profesorët na shpjegojnë se në këtë universitet gjithçka është e centralizuar dhe dekanatet nuk kanë vull dhe të drejtë firme. "Dekani firmos këtë procesverbal ku i jepet e drejta studentëve të hyjnë në provim dhe pasi hyjnë në provim dhe vlerësohen nga pedagogu, është rektori ai që firmos, vulos dhe arkivon vlerësimin e studentëve. Pra pedagogu në këtë rast është thjesht një përcjellës i shkresës, pasi gjithçka është e centralizuar te rektori", na shpjegon dekan Spahiu.

mosi atë që i shkon në tavolinë. Kjo është krejtësisht një marrëdhënie tjetër.

A mund të ndodhë që në vend të një studenti të futet një tjetër dhe pedagogu mos ta njohë?

Studenti jonë nuk ka librezë notash dhe kjo lë shpatull, që ndoshta, në vend të një personi të futet një

tjetër, madje ka pas edhe tentova për një gjë të tillë, por në rastet kur ne i kemi identifikuar i kemi skualifikuar direkt.

Por a nuk i kërkohet studentit karta e identitetit?

Është normale, që pedagogu, nëse ka shkallë njohje me studentët bën identifikimin e tij, por është normale që nëpërmjet kartës së identitetit ai të identifikojë se çfarë personash ka në provim.

A keni ndërmarrë ndonjë veprim për të vërtetuar këtë fakt?

Pikërisht për këtë problem, gjatë ditës së sotme kemi një takim me këshillin e fakultetit, për të kërkuar një informacion më të plotë në administratën tonë dhe të na vihen në dispozicion të gjithë proces-verbalet dhe aktet zyrtare dhe pas verifikimeve të dalim në një konkluzion zyrtar.

Profesor, a ja janë ankuar ndonjëherë pedagogët tuaj, për ndërhyrje nga ana e rektorit për të favorizuar një student të caktuar?

Zyrtarisht nuk kam pasur ndonjë ankesë në kuptimin e trysnisë apo pretendimit, por ata fakte që ju keni publikuar në media, nëse do të dalin të vërteta, do të marrim disa vendime të rëndësishme.

Rektori ka akuzuar dje se pedagogët nuk bëjnë mësim, a është e vërtetë kjo?

Unë me përgjegjësi e them që në fakultetin tonë ka pedagogë me tituj dhe grada shkencore, me karrierë të gjatë në sport, mjeshtrë të merituar në sport dhe kryejnë rregullisht detyrën me korrektesë dhe saktësi gjatë gjithë vitit. Sigurisht përsosmëri nuk ka, por ka pasur një rregullsi për t'u pasur zili në drejtë të mësimdhënies dhe marrëdhënies me studentët.

Atëherë akuzat e rektorit janë të pabaza?



? PYETJE PËRGJIGJE

■ **Çfarë ka ndodhur në universitetin e Sporteve?**

Sipas një dokumenti të zbuluar së fundmi rezultojnë se rektori Rizvanolli, ka favorizuar dhëndrin e tij, Redi Shijaku, aktualisht student i vitit të katërt të sistemit part-time të fakultetit i Shkencave të Lëvizjes, të kalojë në të gjitha provimet, megjithëse ai nuk ka qenë fare i pranishëm në Shqipëri në datat kur, sipas procesverbalet, janë dhënë provimet.

■ **Nga vërtetohet kjo?**

Sipas të dhënave të siguruara nga sistemi TIMS, për të gjitha hyrjet e daljet e këtij personi nga Shqipëria, rezultojnë mospërfutje me datën e departamentit apo dekanin, ku është student dhëndri i tij.

■ **Po rektori çfarë thotë?**

Ai shprehen se janë thjesht akuzat, pasi ai nuk ka pushtet mbi të gjithë pedagogët, shefat e departamentit apo dekanin, ku është student dhëndri i tij.

Për mua ata janë deklarata emocionale që mund ta kenë lidhje me një pedagog të veçantë për mospërfutje të mendimeve apo konflikteve aktuale që mund të kenë, por unë si drejtues i këtij fakulteti them me përgjegjëshmëri që niveli i mësimdhënies ka qenë i lartë dhe korrektesia e pedagogëve ka qenë maksimale.

Letërsia, nesër 43 mijë maturantë në testim

Nesër, 43 600 maturantë do të testohen në provimin e parë me detyrim të maturës 2012, atë të Letërsisë, për t'i lënë më pas radhën Matematikës dhe provimeve me zgjedhje. Lënda e Gjuhës shqipe dhe e Letërsisë është provim i detyruar i Maturës Shtetërore për të gjithë nxënësit që mbarojnë gjimnazin. Për këtë, ata do t'i nënshtrohen një testi, në përbërje të të cilit

do të jenë njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë lëndë gjatë viteve të gjimnazit. Kështu, testi i Letërsisë do të ketë në përbërje fragmente nga tekste të ndryshme (tekst tregimtar, tekst poetik, tekst dramatik, tekst bindës/argumentues, tekst përshkruar, tekst shpjegues, tekst informativ, tekst eseistik, tekst kulturologjik), jo domosdoshmërisht të

punuara në klasë. Specialistët shpjegojnë se testi do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tre nivelet e vështirësisë. Më konkretisht, peshat specifike për çdo nivel do të jenë: niveli bazë 40%; niveli mesatar 40%; niveli i lartë 20%. Sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, provimet e Maturës të detyruara dhe me zgjedhje do të fillojnë në orën 10:00.

Pedagogu: Ministria e Arsimit dhe Institucionet të ndërhyjnë

“Rizvanolli na bën vazhdimisht presion”

Ferdinand Mara: Na thotë se do ju shkel me këmbë



Në foto: Rectori Vejsel Rizvanolli dhe Universiteti i Sporteve, Tiranë

Ministria e Arsimit

Universitetet kanë autonomi, kontroll kur sinjalizohemi

■ ■ ■ TIRANE

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpjegojnë se universitetet publike në vendin tonë, kanë autonomi të plotë dhe janë ata vetë që e menaxhojnë procesin mësimor dhe administrativ. “Ne kontrollojmë vetëm studentët që pranojnë në ciklin e parë tre-vjeçar, ndërsa gjithçka që ndodh brenda universitetit është përgjegjësi e tij. Universitetet publike kanë autonomi të plotë, dhe ministria nuk mund të ndërhyjë në procesin mësimor e akademik pasi quhet shkëlqje e autonomisë. Sigurisht që kur ka raste të tilla që denoncohen publikisht, apo na vijnë sinjalizime të ndryshme se mund të kemi të bëjmë me abuzime, atëherë ne nisim kontrollin, siç do të bëjmë edhe në këtë rast”, - na kanë shpjeguar specialistët e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Ndërkohë që universiteti i Sporteve është i vetmi universitet në vend që këtë vit nuk iu nënshtrova procesit të zgjedhjes së drejtuesve të rinj. Kjo pasi senati akademik vendosi si kriter moshën e kandidatimit 65 vjeç, vendim që nuk u pranua nga rektori, ndaj dhe tashmë janë në proces gjyqësor. Por duket se Universiteti i Sporteve do të vijojë të mbetet e pezulluar



deri në fillim të vitit të ardhshëm akademik. Zgjedhja e këtij konflikti, pritej të vinte nga gjykata, ditën e djeshme, e cila duhej të shqyrtonte kërkesën e Vejsel Rizvanollit, nëse ka të drejtë të rikandidojë ose jo. Çështja në gjykatë është shtyrë për më 12 korrik, një datë që shtyn për disa muaj procesin e zgjedhjeve, pasi në këtë universitet është i mbyllur mësimi.

Profesor a iu bëhet juve, pedagogëve, presion nga rektori?

Kemi presione të vazhdueshme, jo vetëm për këtë rast, të dhëndrit të tij, që unë e njoh shumë mirë, sepse në provimin tim ka qenë se nuk ia mban të bëjë lojëra të tilla, por edhe për raste të tjera. Ai bën presione të hapura të gjithë pedagogëve. “Do t’ju shkel me këmbë” ka thënë sapotë mbarojë gjyqi. Me pak fjalë ai është bërë pronari i shkollës dhe se ka problem fare. Këtu u bëhet presion rregullisht pedagogëve. Thirrjen pedagogët nëpër zyra, bëhen mbledhje dhe u bëhet presion qoftë femra, qoftë meshkuj, sidomos pedagogëve femra.

Në çfarë kuptimi iu bëhet me shumë presion pedagogëve femra?

“Keni kujdes, ruani vendin e



Gjyqi

Rectori i universitetit të Sporteve, Vejsel Rizvanolli ka nisur një proces gjyqësor nga senati të akademik të universitetit të tij. Dje ishte caktuar të zhvillohej seanca gjyqësore, por është shtyrë për datë 12 qershor

Në foto: Ferdinand Mara, mjeshtër i sportit

punës, jo studentët nuk janë në rregull”, gjëra të kësaj natyre. Ajo që ka thënë rektori për gazetën tuaj, se nuk bëhet mësim në universitet, unë e gjykoj në një formë tjetër: përgjegjësinë kryesore duhet ta

“Kush jeni ju që ngelni studentët e mi”, na ka thënë, pasi ai çdo student e mendon si votë

mbajë autoriteti i shkollës. Ai e ditka se nuk u bëka mësim, ndaj përgjegjësinë kryesore duhet ta mbajë ai, pasi na ka akuzuar të gjithë pedagogëve. Ne kemi procesverbalet që kemi vënë notat dhe firmat në regjistra që kemi bërë mësim, ndaj nuk ka të drejtë të na akuzojë. Aktualisht ai e ka shkrehur të gjithë shkollën. E ka mendjen vetëm te fasada, por brenda molla është e kalbur.

Këtu ka probleme të mëdhaja, është bërë një terror i paparë dhe nuk e them me millef këtë, por sepse këtu ka arritur situata në universitetin tonë. Rectori ka deklaruar sot(dje) se është shtyrë gjyqi sot për në dt.12, ndërkohë që sot(dje) në gjyq është paraqitur një kërkesë nga vetë rektori për ta shtyrë gjyqin, pasi është sëmure, ndërsa ai del në TV dhe jep intervista të tilla. Ai bie në kontradiktë me vetveten.

Profesor, ju konkretisht a keni pasur presione nga rektori?

Unë di të them se jam i gatshëm të provoj presionet e rektorit për dhëndrin e tij, por edhe personave të tjerë. “Kush jeni ju që ngelni studentët e mi”, na ka thënë, pasi ai çdo student e mendon si votë. Por nëse një student nuk vjen, nuk mëson ne duhet të bëjmë punën tonë. Pastaj këtu ka edhe një problem tjetër që e tejkalon pedagogun.

Mirë pedagogu se njohu, po ti si rektor, që vulos dhe arkivon këtë notë, nuk e di se dhëndri jot është në Angli? Atëherë ai, pse e ka vulos dhe firmos kur e di shumë mirë se Redi Shijaku ka një vit e gjysmë që është në Angli? Pra mirë pedagogu e hëngri se se ka njohur personin akoma, po ti si e lejon këtë gjë?

Si është aktualisht situata në universitetin tuaj?

Ka filluar një terror i paparë mbi pedagogët. Unë jam një ndër personat që jam sulmuar direkt nga ai, madje unë kam bërë edhe denoncim në polici për të. Më ka kërcënuar direkt fizikisht, më ka çuar persona të tjerë që më kanë kërcënuar me emrin e vet.

Po pse keni kaq shumë konflikte? Si kanë lindur?

Gjithçka ka lindur për poshtin e rektorit, ai më mban inat sepse nuk ia kam dhënë votën në mandatin e para katër vitesh, kur ai u zgjodh rektor. Dhe që atëherë kemi pasur përplasje të forta. Më ka thënë që unë do të të zhidë nga ky fakulteti. Unë i bëj thirrje Ministrisë së Arsimit dhe organeve kompetente që të bëjnë punën tyre dhe të marrin masa ndaj këtij personi.

Studentët e rinj

Artet, Sportet e Arkitektura me konkurs

■ ■ ■ TIRANE

Të gjithë ata kandidatë, që kanë ap likuar për një nga degët e shkollave të larta ku përzgjedhja bëhet me konkurs, për t'u futur në garë, duhet të kenë kapur pragun minimal të pikëve. Në të kundërt skualifikohen për këtë preferencë. Janë mbi 30 degë, të cilat për shkak të karakterit që kanë, aplikojnë edhe konkurset spe-



cialë. Bëhet fjalë për ata që duan të nisin studimet e larta në një nga degët e Universitetit të Arteve, Universitetit të Sporteve në Sportet pranë Universitetit të Shkodrës, në Arkitekturë apo në Pedagogji e Specializuar në Universitetin e Vlorës. Për të gjithë ata kandidatë që kanë zgjedhur si preferencë kryesore një nga këto degë, ka një prag minimal dhe maksimal pikësh, të cilin duhet ta fitojnë. Nëse një konkur-

rent, i cili nuk ka siguruar pragun minimal të pikëve, nuk ka asnjë shans për t'u shpallur fitues në këtë preferencë, pasi skualifikohet direkt. Ndërsa fituesit për Arte dhe Sporte do të përzgjidhen vetëm në bazë të sasisë së pikëve që do të grumbullojnë në konkurs, ata të Arkitekturës dhe të Pedagogjisë së Specializuar, përveç pikëve të konkursit, do u shtohen edhe pikët e siguruar në maturën Shtetërore.



Mesila Doda:

Rama sillet më keq
se një adoleshent

Raund "të hidhur", për të cilin mazhoranca investoi çdo gjë, duke kaluar dhe kufinj të vetes. Kështu e sheh raundin e parë të votimit për kreun e ri të shtetit, deputetja e PD-së Mesila Doda. Ajo ia faturoi këtë "dështim" liderit të selisë rozë, Rama, duke u shprehur se ai nuk dha konsensus për atë çfarë vetë kishte kërkuar, president as nga PD, as nga PS. Duke e konsideruar qëndrimin e tij një

sjellje guerile, ajo e cilesoi lidhjen e katër kushteve të PS me zgjedhjen e Presidentit të pavend në një moment kyç për vendin. "Në pikëpamjen time si politikane është një raund i parë i eazuarr. Ne si mazhorancë tejkaluam veten për të vazhduar atë klimë të qetë në një moment kaq të rëndësishëm për vendin. Fillimisht kryetari i PS kërkoj një kandidat jashtë PS dhe PD, dhe ne për të pasur mundësinë të japim diçka të tillë

konkludim një figurë të rëndësishme, jashtë përfaqësues. Zaganjori është një figurë mjaft e kompletuar. PS erdhi me 4 kushte tjera, është një sjellje guerile. Nuk e di si ky person do mund të qeverisë një ditë, kur nuk është stabil në qëndrimet e tij. Një sjellje e tillë nuk do të ishte lualaje as nga ndonjë adoleshent. Kishim gjithë të drejtën tonë të zgjedhim një kandidat nga mazhoranca", u shpreh ajo.

Kreu i LSI kërkon uljen në një tryezë të Ramës dhe Berishës për Presidentin

Meta: Opozita të mos marrë për dobësi konsensusin tonë

"Kandidatura politike do të konsiderohej provokim nga opozita"

Lajmi

Kryetari i LSI Ilir Meta është shprehur se opozita duhet të përfshihet në procesin e zgjedhjes së presidentit, dhe se konsensusin e mazhorancës s'duhet ta marrë si dobësi. Ai këmbëngul se një takim mes Ramës e Berishës do t'i shërbente zgjidhjes më shpejt të situatës.



Meta

"Opozita ka të drejtën e saj që të bëjë edhe propozime të caktuara por në fund të fundit mendoj që mazhoranca ka hedhur hapin e parë. Hapi i mazhorancës është një hap i menduar, është një hap serioz, dhe për këtë më së miri flet edhe vetë figura e kandidatit të propozuar".

Në foto:
Kreu i
LSI-së,
Ilir Meta

cesi konsensual dhe larg paragjykimëve të panevojshme.

Kush e propozoi z.Zaganjori, si u arrit konsensusi..?

Në radhë të parë më duhet të theksoj se janë diskutuar shumë kandidatura, politike dhe jo politike. Për rastin konkret mund të them që ka qenë një konsensus i plotë dhe kandidatura është tepër e spikatur.

Mund të na e thoni se cila parti politike e propozoi kandidatin?

Kandidati ka dalë si rezultat i diskutimit të katër kryetarëve të forcave politike të mazhorancës dhe mund t'ju them që dhe unë kam qenë një mbështetës i kësaj kandidature duke vënë re, do të thosha, kombinimin shumë të mirë të dy elementëve shumë të rëndësishëm, që janë edhe për postin e Presidentit, atë të përfaqësimit ndërkombëtar dhe njëkohësisht edhe të kapacitetit për të përballuar sfidat e sistemit gjyqësor.



Si do të LSI nëse Berisha kërkon të votohet një kandidaturë që të jetë një prej figurave më të larta të PD për Presidentin?

Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë dhe forcojmë konsensusin brenda mazhorancës por dhe do kontribuojmë për një konsensus sa më të gjerë midis mazhorancës dhe opozitës. Unë shpresoj që opozita këtë mundësi të mos e keqpërdorë dhe të mos e shohë si një dobësi të mazhorancës por si një vullnet të saj për të përfshirë edhe opozitën për një zgjidhje konsensuale.

Ekziston mundësia të shohim edhe një kandidaturë nga vetë LSI?

Kjo nuk është aspak e rëndësishme. Angazhimi i LSI ka qenë dhe mbetet kurorëzimi i këtij procesi si një proces konsensual.

Jemi pranë apo ende larg marrëveshjes për një kandidat konsensual me negociatat tuaja me Ramën dhe Berishën?

Unë mendoj se kemi një kandidat i cili, për sa i takon vlerat të tij, është i pakundërshtueshëm. Është e rëndësishme të eliminohen ato paragjyime të cilat do të përbyllnin të gjithë këtë proces në mënyrë dinjitoze për të gjithë.

■ ■ ■ TIRANE

MUHAMED VELIU

Kreu i LSI Ilir Meta në një intervistë për "Top Channel" tha se nuk duhet të abuzojë me vullnetin e mazhorancës për konsensus. Ai ka bërë thirrje dhe njëherë për një takim Berisha-Rama.

Z.Meta, raundi i parë i dogj. Mendoni që Presidenti i ri të zgjidhet brenda raundit të dytë dhe të tretë?

Absolutisht që janë të gjitha shanset. Ndoshta dhe opozita pati një pamjaftueshmëri kohe për të vlerësuar si duhet kandidaturën për President të ofruar nga ana e mazhorancës. U unë besoj se kemi gjithë kohën e duhur që raundi i dytë të jetë një raund i suksesshëm. Mazhoranca ka paraqitur një kandidat i cili ka vlera tepër solide dhe bindëse. Të paragjykosësh është gjëja më e lehtë në shoqërinë tonë, akoma më keq në elitën e klasës sonë politike.

Si do të gjendet kompromisi me PS?

Qëllimi kryesor është të ndërtohet një proces konsensual i cili tashmë ka nisur. Edhe fakti që mazhoranca s'paraqiti kandidatura të forcave politike s'duhet parë si pamundësi për të ofruar kandidatë të tillë, por si një

vullnet për të lehtësuar konsensusin. Do të ishte konsideruar si një provokim nga ana e opozitës çdo kandidaturë e tillë.

A jeni ju duke negociuar mes dy palëve?

Ne kemi dhënë kontributin tonë për të ndërtuar një konsensus brenda mazhorancës dhe absolutisht që theksojmë rëndësi që ky proces të jetë më i plotë, kjo është arsyeja që kam theksuar gjithmonë

"S'është detyra jonë të negociojmë. Detyra jonë dhe angazhimi ynë ka qenë për të lehtësuar këtë proces komunikimi e të ndihmojmë për të ndërtuar konsensusin".

dhe e theksoj domosdoshmërinë e një takimi midis z.Berisha e z.Rama pasi men-

doj që ky takim do mundësojë shkrijën e shumë paragjyimeve të panevojshme.

Si shkohet drejt një tryeze ku të jetë ulur Rama dhe Berisha?

Nuk është hera e parë që ata janë ulur. Absolutisht kur janë ulur për arkitekturën e Kuvendit të ri nuk ka asnjë arsye që të mos ulen për Presidentin e ri që do të zgjidhet dhe duhet shkuar me vullnetin për t'i shërbyer këtij pro-

Flet dhe Vasili

Tavo: Presidenti, pas raundit të tretë LSI do të mbledhë forumet

■ ■ ■ TIRANE

Nënkryetari i Kuvendit, njëherësh dhe deputet i LSI, Vangel Tavo është shprehur për gazetën se beson në zgjedhjen e një presidenti konsensual me shumë se 84 vota. Ai thotë se nëse s'zgjidhet kreu i shtetit në tre raundet e para me një shumicë të cilësuar, në raundin e katërt dhe të pestë, LSI do të mbledhë forumet drejtuese për të vendosur se si do shkohet më tej. "Ne shpresojmë që Presidenti i ri të zgjidhet një kandidat, i cili të marrë dhe konsensusin e PS, pra të ketë një konsensus sa më të gjerë, mbi 84 vota. Për këtë po punohet dhe negociohet, këtë kërkojnë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë dhe LSI e ka thënë që në fillim një gjë të tillë", tha



Vangel Tavo

dje për gazetën Tavo. Duke kërkuar gjithnjë nga PS që të sjellë një kandidat për president. "Nëse PS nuk bie dakort apo nuk sjell asnjë kandidaturë, atëherë LSI

do të mbledhë forumet drejtuese për të vendosur për qëndrimin e mëtejshëm se si do të operohet për raundin e katërt dhe të pestë, çfarë qëndrimi do mbahet. Por ne gjithnjë këmbëngulim për një konsensus sa më të gjerë për zgjedhjen e presidentit të ri", deklaroi Tavo. Ndërsa nënkryetari i LSI, ministri i Shëndetësisë Petrit Vasili. Sipas tij për Presidentin loja është e hapur për të gjithë. "Mazhoranca e ka mbaruar detyrën e vet, ka hedhur një kandidaturë në tavolinë. Këtë të drejtë e ka dhe opozita, të propozojë ose jo një kandidaturë të sajën për postin e Presidentit. Rëndësi ka që procesi të vijojë normalisht. Tashmë gara është e hapur dhe në garë sipas Kushtetutës dhe rregullores gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë me kandidatë ose jo për të mirën e vendit", tha Vasili.



Presidenti, Topi: Të garantohet zgjedhja me transparencë

Presidenti Bamir Topi ka pritur një delegacion të grupit parlamentar për marrëdhëniet e Gjermanisë me shtetet e EJT, të kryesuar nga Peter Vajs, Kristel Apah Kasan dhe Andreas Lamel. Delegacioni është duke zhvilluar një vizitë informuese në vendet e Ballkanit Perëndimor, Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë. Topi informoi delegacionin me

hapat e ndjekura për procesin integruar të Shqipërisë, ku vuri theksin tek reforma zgjedhore parlamentare dhe procesi i zgjedhjes së kreut të ri të shtetit. "Një rol kyç gjatë gjithë këtij procesi luan edhe institucioni legjislativ dhe veprimtaria e tij parlamentare, sidomos aktualisht gjatë synimeve për realizimin e reformës zgjedhore, reformës parlamentare dhe

zgjedhjes së Kreut të ri të Shtetit nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent për t'i dhënë vendit garantuesin e ekuilibrit dhe të pavarësisë së institucioneve kushtetuese", është shprehur Topi. Deputetët gjermanë vlerësojnë rolin kyç të Shqipërisë në forcimin e paqes dhe sigurisë në rajon drejt integritetit në strukturat euro atlantike.



Letra

Kadare u përgjigjet studentëve: Nuk mund të jem president i vendit

■ ■ ■ TIRANE

Shkrimtari i njohur Ismail Kadare i është përgjigjur negativisht propozimit të studentëve të Shkodrës për të qenë ai një kandidat për Presidentin e ri të vendit. Në letërën dërguar Këshillit Studentor, Kadare pohon se me mospranimin e tij ka ndihmuar për normalizimin dhe europianizimin e Shqipërisë. "Së pari ju kërkoj ndjesë për vonesën e përgjigjes për letërën që më keni dërguar më 26 maj 2012. Dëshira për të vonuar një përgjigje zhgënjyese ka qenë arsyeja, jo fort e përligjur, ndoshta, për një gjë të tillë", shkruan Kadare në letërën e tij për studentët shkodranë. "Në të vërtetë letra juaj më dha një besim dhe kënaqësi të veçantë. Për fjalët tuaja fisnike, për vlerësimin e



Ismail Kadare

shkrimtarit, e nëpërmjet tij të artit, e sidomos për shqetësimin tuaj të bukur për vendin ku jetoni e për kombin të cilit i përkisni. Kur studentët e një kohe

shqetësohen seriozisht për fatet e komunitetit, kjo është shenjë e sigurtë se gjendja e shëndetshme, ajo që aq gjatë ka munguar, nuk do të vonojë. Ju keni të drejtë të zhgënjeheni me qëndrimin tim mospranues. Ka gjasë që një ditë unë vetë të them, ashtu si ju, se në përpjekjen për t'i dhënë një ndihmë vendit tim, unë nuk arrita dot dhe u mposhta. Ndërkaq, nuk përjashtohet e kundërta, që me mospranimin tim, kam ndihmuar ndoshta për atë që ju, e bashkë me ju gjithë të tjerët, ëndërojnë me padurim: Përparimin, Normalizimin dhe europianizimin e Shqipërisë", përfundon letra e Kadaresë. Studentët shkodranë i kishin kërkuar shkrimtarit të madh që për hir të interesave të kombit të pranonte kandidimin për postin e lartë të Presidentit të Republikës.

Negociatat mes LSI, PS e PD. Pasdite takim me Berishën

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Edi Rama dhe Ilir Meta janë takuar dy netë më parë. Burime të Shqiptarja.com konfirmojnë se dy liderët e PS dhe LSI kanë zhvilluar një takim për zgjedhjen e presidentit, edhe pse ende nuk është marrë vesh se çfarë është diskutuar. Por ky takim erdhi pas një takimi të mëparshëm, për të cilin shqiptarja.com disponon edhe fotot. Gramoz Ruçi, kryetar i grupit parlamentar të PS dhe Ilir Meta, kryetar i LSI janë ulur pasditën e të mërkurës në bar-kafenë e Sheratonit për të diskutuar mbi emrin e kandidatit për president.

Dy politikanët kanë qëndruar për më shumë se një orë dhe shqiptarja.com disponon ekskluzivisht fotot nga ky takim i cili vjen në një moment kur opozita nuk e ka dhënë konsensusin për zgjedhjen e Xhezaire Zaganjorit në postin e presidentit. Nuk dihet se çfarë ka biseduar Ruçi dhe Meta, ajo që dihet qartë është se Petrit Vasili deklaroi dje në "Fakt" në Ufo Tv, që LSI është e vendosur për të votuar deri në fund presidentin e propozuar nga maxhoranca. Ndërkaq, po dje, ishte Komisioneri për djelimin i BE Stefan Fyle, që shprehu pakënaqësinë e tij për mënyrën sesi po shkon procedura e zgjedhjes së presidentit. Ajo që kërkohet është zgjedhja e presidentit pas konsultimeve, ndërkohë që i

Meta takon Ruçin më pas dhe Ramën

Kryetari PS mbledh Grupin pas takimeve



Braçe

"Nuk është zoti Zaganjori kandidati i Berishës për raundin e katërt. Unë di që deputetët e PD kanë mbledhur firmat për një kandidat politik. Ky do të jetë fundi i procesit drejt shtetit njëpartak. Kundërshtia ndaj shtetit njëpartak duhet të jetë beteja jonë", tha Braçe.

Në foto: Kryetari i LSI-së, Ilir Meta duke pirë kafe me kryetarin e grupit parlamentar të PS, Gramoz Ruçi

kujtoi politikës shqiptare katër kërkesat që kanë të bëjnë me reformën zgjedhore, reformën parlamentare imu-

netetin dhe presidentin. Kështu, duket se kanali i komunikimit LSI-PS mbetet i hapur, në pritje të raundit të dytë të

presidentit, por pa e ditur nëse do të jetë Xhezaire Zaganjori ose jo. Burimet saktësojnë gjithashtu se pas orës 14.00 Meta është takuar në zyrën e Topallit dhe me Berishën, ku kanë diskutuar ofërën e PS. Njëherësh burime të pakonfirmuara saktësojnë se Meta është takuar dhe me Ramën pasditën e djeshme. Ndërkohë që fill pas këtyre sinjaleve përs kanaleve komunikuese dhe të drejtë përdrejta PS-LSI dhe

PD-LSI kryetari i PS, Edi Rama ka mbledhur dje pasdite deputetët që nuk janë anëtar kryesie, në një takim për situatën politike dhe për nevojën e diskutimit të strategjisë së PS në këtë vit elektoral për organizimin e një fushate model në funksion të fitores së zgjedhjeve. Por takimi ka filluar me vonesë, ndërkohë që ka zgjatur vetëm pak dhe ka pasur si prelude batutat mes deputetëve për veshjen e tyre të thjeshtë të pasdites, por dhe për shqetësimin për zgjedhjen e kreut të shtetit, ku deputetët kanë kërkuar të qillohen nga pesha e propozimit të një kandidature të PS por të vendosin për një listë që mund të vijë nga

drejtuesit e lartë. Kështu, kolegët e tij deputetë i kanë thënë me shaka deputetit Piro Lutaj se "pse ke ardhur si në plazh", ndërkohë që dhe ky i fundit nuk ka munguar t'ju kethej se "dhe ju keni ardhur me rroba siç keni qënë në shtëpi". Këto batuta me njëri tjetrin mes deputetëve të pak të këte mbledhje kanë vijuar derisa Rama i ka pyetur duke qeshur se "çfarë problemesh keni?", ndërkohë që deputetët thuajse me një zë i janë përgjigjur: "Atë problem që kanë të gjithë shqiptarët, zgjedhjen e presidentit të ri". Njëherësh deputetët i kanë kërkuar Ramës që të mos kërkojë prej tyre propozimin e kandidatit për deputet. "Do të donim që të mos e kërkonin nga ne propozimet për kandidaturën e Presidentit, bëjeni siç është bërë gjithnjë me kandidataturat dhe ne e shohim", mësohet të kenë thënë deputetët socialistë në mbledhjen e djeshme të shkurtër. Nga ana tjetër, mësohet se Rama sërisht ka kërkuar në mënyrë miqësore që të mos nxjerrin ato që thuheshin jashtë mureve të sallës, sipas tij me mbledhjen e grupit parlamentar të para dy ditëve. Referuar kësaj mbledhjeje, ka qënë nënkryetari i grupit parlamentar Erjon Braçe ai që janë shkruar dhe duke deklaruar se Xhezaire Zaganjori nuk do të jetë kandidat për president në raundin e katërt, por një kandidat politik i PD.

Grup Zjarrfikseje
Pompa
Gjeneratore
Pishina
Përpunim uji

Adresa: Unaza e Re, pranë Alpha Bank Tiranë;
Tel/fax: +355 4 8320162;
Mob: +355 69 400 95 87
E-mail: erjon@crystal-blue.gr



Regjistrimi, partia e re e Topit dorëzon dosjen në gjykatë

Fryma e Re Demokratike depozitoi të enjten në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e saj si person juridik. Dokumentacioni përmban kërkesën, programin minimal dhe Statutin e Partisë, të miratuar nga Grupi Nismëtar i themelimit të Fryma e Re Demokratike. "...themelohet me vullnetin e lirë të 11.432

(njëmbëdhjetëmijë e katërqind e tridhjetë e dy) shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e bindjeve, ideve dhe interesave të përbashkëta", thuhet në kërkesën e depozituar në gjykatë. Në preambulën e Programit të saj FRD angazhohet të jetë parti e lirisë dhe e barazisë, parti e mundësive dhe e shanceve të barabarta për të gjithë. Në Statut

FRD sanksionon parimet themelore mbi të cilat do të organizohet dhe do të funksionojë. "Një anëtar një votë", institucionalizimi i mendimit ndryshe dhe mandatet e kufizuara të drejtuesve partiakë. Ndërkohë që kjo parti pritet të legalizohet në mënyrë të shpejtë dhe në gjykatë për shkak të situatës së paqëndrueshme politike, që mund ta lërë atë jashtë garës zgjedhore.

Lajmi

Kryetari i grupit parlamentar socialist Gramoz Ruçi është shprehur se Meta ka paketën kontrolluese për Presidentin. Njëherësh ai nuk ka përjashtuar mundësinë e hedhjes në tryezën e negociatave me Berishën kandidaturën e ish-kryeministrit Nano.

TIRANE

Kreu i grupit të PS, Gramoz Ruçi në emisionin "Top Story" të Sokol Ballës në "Top Channel" tha se Meta vendos për zgjedhjen e kreut të ri të shtetit. Ndërsa kërkon një President konsensual.

Jeni prapa me negociatat, kemi emër konkret ju?

Nuk diskutojmë emrin e kandidatit. Unë pranoj emër në tavolinë, nëse arrijmë të diskutojmë emra në tavolinë. Duam të shkojmë një problem madhor, që grupet politike e shikojnë njëri tjetrin si armiq, jo si kundërshtarë. Kundërshtari nuk pranon fare dialogun.

Por çfarë qëndrimi keni për Zaganjorin...?

Nuk është kandidat zyrtar, nuk është institucionalizuar. Kur dëgjova Metën, mu duk sikur fjalët e tij i kisha shkruar unë, apo ato që kanë thënë unë të kishte bërë Meta.

Zaganjori përputhet me vizionin tuaj për presidentin?

Parlamenti të mblidhet dy here në javë, një ditë reformën zgjedhore, një ditë presidentin. Ta fillojmë me presidentin.

Po mocioni..?

Në çdo Parlament, mocioni është çështje e opozitës. Berisha mendon se mos ne kemi bërë ndonjë kulisë me parnetin e tij Ilir Meta për ta rrëzuar. S'është e vërtetë. S'më janë krijuar kushtet e mundësitë për mocion ndaj Berishës, se do bëja çdo javë.

Me Metën jeni ulur...?

Meta ka paketën kontrolluese që të kushtëzojë Berishën për institucionin e presidentit, duke ulur kryetarët në tavolinë. Sa herë janë zhvilluar negociatat për presidentin,

Kreu i grupit të PS nuk përjashton Nanon si kandidat

Presidenti, Ruçi: E vendos Ilir Meta

"Kandidatët, në tryezën Rama-Berisha"



Gramoz Ruçi

Ruçi

"Në gjykimin e shqiptarëve s'është fjala se kush fiton për presidentin, PD apo PS. Para dy vjetësh kemi folur për gjera krejt të tjera. Opozita shqiptare ka bërë shumë hapa para, jo për të fituar betejën elektorale apo presidentin. S'kemi për objektiv të fitojnë në presidentin, një kandidat të propozuar nga ne".

emrat e vet më pas.

Ju çfarë po bëni me kandidatin Zaganjori...?

Kushtetuesja ka tre vjet që ka kaluar mandati i tre anëtarëve të saj, në mënyrë antikushtetuese qëndrojnë aty. Presidenti aktual i ka bërë propozimet, mazhoranca nuk e pranon. Di që dhe një anëtar të Kushtetueses dha dorëheqjen, sepse ishte aty në kapërcim të Kushtetutës. Ndërmjet emrat që ka kapërcyer afatin kushtetues është dhe zoti Zaganjori, i cili vijon të jetë në Kushtetuesë.

kutohej dhe dakortësohej, me më shumë se 84 vota.

Nëse takohet Berisha me Ramën, do hiqni dorë nga tre çështjet e tjera dhe Rama do shkojë me emra apo pa emra?

Shpresoj që koshienca e mazhorancës të jetë që të ulet me opozitën. Nëse kemi vendosur reformën zgjedhore, s'do të thotë se pa u zgjidhur këto nuk kalojmë te Presidenti. Këtu është çështje vullneti politik. Secila palë do të ketë

Nano është një nga këto emrat që mund të hodhen në tryzë, do ta merrni parasysh koston e mospropozimit të tij më 2013?

Më vjen mirë që jeni me zotin Nano. Kur unë shtrova problemin që ne kërkojmë negociatat për të shtuar emrat, të cilat nuk mund tua them ju këtu, do të jap përgjigjen që i kam thënë Nanos në takimin me Ramën. Ai na tha: "nëse Berisha shtron



pyetjen, zoti Nano të mbështet PS". Pres që Berisha të ulet me Ramën në tavolinë e pres ta shohim nëse Rama ia thotë në tavolinë Berishës. Pra uroj që Berisha të bëjë këtë pyetje që më beni mua.

Ka kontakte për Rama-Berisha...?

Në emër të 63 deputetëve, apeli im është se rruga e negociatave është rruga më e mirë deri në raundin e tretë.

Do marrë pjesë në votimin e fshehtë...?

Ajo që ndodhi në 2007 nuk është për tu përshëndetur. Tani nga pikëpamja taktike mbetet për tu parë kur të vijin raundet.

Analizë

Një votim pa kandidat



NGA ADELHEID WOELFL
vijen nga faqja 1

por një shumicë e thjeshtë. Shefi aktual i shtetit, Bamir Topi, u zgjodh në raundin e katërt.

Por kësaj here nuk është e sigurt nëse partitë e mëdha-demokratët e socialistët duan që të kenë zgjedhje presidenciale të suksesshme. Nëse votimi dështon, brenda gjashtëdhjetë ditësh ka zgjedhje të reja parlamentare. Socialistët në opozitë e kërkojnë prej kohësh diçka të tillë. Demokratët edhe njëherë i frikësohen formimit të një blloku të djathtë përtej partisë së tyre. Sa më shpejt të bëhen zgjedhje, aq më pak të përgatitur do të ishin.

Koalicioni rreth të fuqishmit kryeministër, Sali Berisha, ka 74 vota në parlament. Por nuk

do jetë e lehtë që të sigurojë 71 vota për kandidatin e tij në votimin e katërt. Sepse ka të paktën tre qëndrime të deklaruara. Partneri i vogël në koalicion, LSI, nuk kërkon si kandidat një emër të njohur të PD, socialistët duan ta lidhin zgjedhjen e presidentit me reformën në ligjin zgjedhor, që kërkon tre të pestat e votave. Në lojë, pavarësisht këtyre lojërave për pushtet, është sërisht afrimi me BE-në, që e dëshiron populli. Për të arritur diçka të tillë duhen miratuar me konsensus ligjet e rëndësishme.

Marrë nga gazeta austriake "Der Standard"

ka pasur tryezë kryetarësh. Është serioze.

ta deklaroni si kandidat?

Unë kam arësye 100 herë më shumë për zotin Nano, sepse kam qënë bashkëpunëtor i tij i ngushtë për 15 vjet, por pozicioni që kam, filozofia e PS që kërkon konsensus, nuk përjashton asnjë emër aq më pak të zotit Nano, që mund të vijë si objekt i dakortësimit të këtyre negociatave pozitë-opozitë.

Shoqëria civile ka nxjerrë Valdete Salën dhe Sokol Sadushin...?

Vetëm në këtë vend që të mos bëhen konsulta me shoqërinë civile për Presidentin. Tani i dëgjova këto 2 emra, i njoh personalisht, duhen përshëndetur e duhej që këto opinione të organizoheshin.

Do ti ktheheshit versionit politik, psh Majkos...?

Në nënqoftëse do të kishte negociata, PS s'do përjashtonte asnjë kandidat. Por kemi vënë një kusht, jo një drejtues të lartë të PS apo PD. Kjo s'do të thotë që ne përjashtojmë apriori klasën politike shqiptare të këtyre 22 vjetëve. Nëse të gjitha negociata, dhe këto propozime do ishin objekt i tyre, natyrisht do të dis-

Nëse LSI zgjedh presidentin me 73 vota, por me pas del jashtë qeverisë, do ndikojë në marrëdhëniet e ardhshme?

Ne do ta përshëndesim jo vetëm Metën por dhe Berishën nëse zgjidhnin presidentin me 84 vota. Të kundërtën nuk do ta uroja, por unë se kam në dorë, e kanë Berisha dhe Meta. Ne

"Opozita kapërceu yllberin, sepse qeveria e ka vrarë opozitën. Pse hiqet barazimi mes demonstratës e atyre që vranë demonstruesit".

s'kemi ç'ndryshojmë, Meta është në pushtet, ne jemi në opozitë. Nëse Meta pas kësaj ka lëvizje, këtu jemi prap do diskutojmë. Në politikë kurrë nuk thuhet kurrë.

Arvizu ka deklaruar se Nano është një kandidat i qendrës së përbashkët të të qenë konsensual, ju pse keni frikë

Program për ish të përndjekurit, PS zgjidhje konkrete

Partia Socialiste është duke formuluar një program të veçantë në lidhje me shtresën e ish të përndjekurve politikë dhe familjarët e tyre. Drejtuesja e grupit të punës në Partinë Socialiste, Ketil Bazhdari tha para ish të burgosurve politikë dhe familjarëve të tyre se deri më tani nuk ka patur vullnet politik për të zgjidhur çështjen e ish të përndjekurve. Sipas saj

është synuar vetëm politizimi dhe militantizmi, gjë që Partia Socialiste s'ka ndërmend ta përsërisë. "Partia Socialiste nuk ka ndërmend që çështjen e të përndjekurve ta politizojë, në mënyrë absolute. Të gjithë ata që janë këtu të majtë, të djathtë do të jenë në gjendje që të bashkëpunojnë me ne, që të krijojmë një program, i cili do të jetë në interes të të

gjitheve, pavarësisht krahut politik dhe nuk synojmë që përmes programit të Partisë Socialiste të blejmë votat", tha Ketil Bazhdari, përfaqësues e ish të përndjekurve politik. Në projektin e përgatitur tashmë, socialistët planifikojnë që brenda një kohe të shkurtër të realizojnë integrimin social, rehabilitimin moral dhe ajo që është më e rëndësishme, dëshmipërblimin.



Presidenti

Raundi i II të hënën, akoma në 'fuqi' Zaganjori

TIRANE

Kuvendi i Shqipërisë Kyvendosi me 74 vota "pro" zhvillimin e raundit të dytë ditën e hënë në orën 10:00. Partia Demokratike së bashku me Lëvizjen Socialiste për Integrim kanë votuar për ditën e hënë, ndërsa Partia Socialiste së bashku me Vangjel Dulen e PBDNJ-it kanë votuar kundër me 54 vota. Partia Socialiste ka kërkuar që të zhvillohet raundi i dytë ditën e martë, për të pasur kohë për të negociar me palët. Ky votim në Kuvend erdhi si rezultat e mos dhënies së dakordësisë në Konferencën e Kryetarëve. Votimi ka kaluar në seancë pa asnjë diskutim mes palëve. Gjatë këtij votimi, por edhe gjithë seancës është vënë re mungesa e kryeministrit Sali Berisha. Raundi i dytë mesohet se do të zhvillohet ditën e hënë, ndërsa ende kemi një kandidatë të sjell nga mzhoranca qeverisëse. Xhezair Zaganjori është i vetmi kandidat i nxjerrë publikisht nga mzhoranca, ndërsa opozita nuk ka dhënë asnjë emër, për aq kohë që ndihet jashtë procesit. Në raundin e dytë ka ngelur të kandidojë vetëm



Zaganjori, por ky i fundit ende nuk i ka marrë firmat e 20 deputetëve, që nuk dihet nëse do të firmoset edhe nga LSI. Raundi i parë u ezaurua pas asnjë kandidat, pasi Partia Demokratike nuk hodhi firmat për Zaganjorin pa marrë konsensusin nga Partia Socialiste. Sakaq edhe sot, kandidati i dalë nga filtri i mzhorancës ende nuk i ka marrë firmat. Ndërsa mund të vihet në pikëpyetje ky emër në raundin e dytë, pasi ngelen edhe tre ditë në dispozicion për të vendosur për një kandidatë tjetër potenciale të pranuar nga të dyja palët. Takimet intensive të kryetarëve të partive por edhe nënkryetarëve, po tregojnë ose pazaret e mundshme për të zgjedhur Presidentin, ose një President të kërkuar nga palët me konsensus.

Deputeti i PD: Berisha nuk do takohet me Ramën

Paloka: Do diskutojmë propozimin e PS

"PS nuk ka folur me fakte kundër Zaganjorit"

TIRANE

FERNADA CENKO

Deputeti i Partisë Demokratike, Edi Paloka ka komentuar zhvillimet e fundit politike në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com". Paloka është shprehur se Berisha nuk do të takohet me kryesocialistin Rama, ndërsa nuk përjashton të shqyrtojë PD një kandidatë të ardhur nga Partia Socialiste.

Zoti Paloka, do të kalojë kandidatura e zotit Zaganjori edhe në raundin e dytë?

Është kandidatura e mazhorancës për momentin, i është ofruar dhe opozitës për konsensus dhe mendoj se është kandidatura më e përshtatshme për këtë gjë. Ne si Partia Demokratike, e kemi pasur të vendosur që kandidati ynë do të ishte një nga funksionarët e lartë të PD-së, por për hir të konsensusit që përfshihet në Kushtetutë në raundin e para, ne propozuam një kandidatë që të ishte sa më e pranueshme nga të gjithë dhe besoj se pyetja që zoti Berisha i bëri Gramoz Ruçit në Parlament, apo kërkesa kur i tha se 'nëse keni qoftë dhe një vërejtje të vogël për këtë kandidat na e thonë', mendoj se deri më sot e kemi marrë përgjigjen për këtë kandidaturë. Asnjë vërejtje nuk kemi nga PS-ja, përveç arsyeve absurde që nuk duan të diskutojnë fare këtë kandidaturë apo kandidaturë të tjera.

Kandidatura e zotit Zaganjori mos ndoshta është një kartë e djegur?

Absolutisht nuk është



Edi Paloka

kartë e djegur, pasi ngelet kandidatura potenciale dhe për raundin e dytë e më pas.

'Bllokimi' i bërë nga PS, mos lidhet me kërkesën për zgjedhje të parakohshme?

Rama e ka bërë të qartë që

Ende nuk janë dhënë firma, pasi përderisa është kandidaturë e ofruar për konsensus, nuk mund të bëhet shpallja e njëanshme e kësaj kandidature.

dëshira e tij është të rrëzojë qeverinë. Kjo është dëshirë e përhershme e zotit Rama dhe kjo nuk besoj se do të ndryshojë ndonjë gjë, kjo është dëshira e gjithëkohshme e Ramës. Nëse ai nuk do të japë

konsensusin siç duket se nuk do e japi, pasi arsyet e tij janë fare të pavend. Arsye që nxirren për të mos hyrë në këtë proces, sikur janë ato të katër kushteve, po nuk u ul Berisha me mua për kafë nuk zgjidhet Presidenti, janë arsye të justifikim. Nëse ai do të vazhdojë me këtë qëndrim, ne vendim nuk do e lëmë pa President.

LSI ka kërkuar një votim më shumë se mazhoranca aktuale?

Pikërisht, në bazë edhe kësaj kërkesë të LSI është zgjedhur edhe kandidati zoti Zaganjori si figurë që mund të merrte konsensusin e të gjithë spektrit politik pasi ne si PD, synim kemi pasur synim që të zgjidhim një funksionar nga PD, synim nga i cili ne u tërhoqëm.

Zoti Zaganjori ka qenë negociues për partin detar?

Nuk e di të ketë një gjë të

tillë, nuk besoj dhe nuk ka rëndësi nëse ka qenë. Nuk kam ndonjë informacion të tillë. Anëtar i Gjykatës Kushtetuese është, nuk di në lidhje me paktin detar nuk e di, ka qenë apo jo negociues çrëndësi ka.

Do takohen Rama dhe Berisha?

Këtë e ka bërë të qartë zoti Berisha, nuk mund të takohen dy politikanë thjesht për të bërë shoë siç kërkon Rama. Kryesocialisti Rama thotë hajt të ulemi ta zgjidhim ne Presidentin. Problemet që janë teknike ai kërkon t'i zgjidhi me Berishën. Berisha e bëri të qartë që nuk mund të flasin dy kryetarë partie për skanerat e zgjedhjeve. Kështu që nuk është e nevojshme.

Një kandidatë e vlefshme mund ta nxjerrë edhe Partisë Socialiste, a do të votohet kjo nga mazhoranca?

Duke nxjerrë kandidatë tonë kemi thënë se ka të drejtë. Çdo kush ka të drejtë të nxjerrë kandidaturën e tij, edhe opozita nuk është e privuar nga kjo e drejtë, ato duhet të diskutohen. Në momentin që thua nuk pranoj të flas për Presidentin pa zgjidhur këto katër probleme, atëherë nuk kemi.....

Ka marrë 20 firma Zaganjori për të qenë kandidat ligjor?

Ende nuk janë dhënë firma, pasi përderisa është kandidaturë e ofruar për konsensus, nuk mund të bëhet shpallja e njëanshme e kësaj kandidature.

Jeni në pritje të PS?

Sigurisht. Megjithatë ata kanë deklaruar se nuk do të shqyrtojnë asnjë kandidaturë.

FISIOMED OFRON SHERBIME FIZIOTERAPIE PROFESIONALE NE NJE AMBIENT KOMOD DHE MODERN. EKSPERIENCA PERENDIMORE DHE APARATURAT E GJENERATES SE FUNDIT JANE TASHME PRANE JUSH. BESOJANI SHENDETIN TUAJ FIZIOTERAPISE PROFESIONALE

FISIOMED

Adresa: Rruga e Barrikadave 18/2, Galeria e Tiranës Ish Kinema 17 Nentori, Kat 3
Tel. +355 42 400 418 / Cel. +355 69 20 533 30;
E-mail: info@fisiomedal.com / Web: www.fisiomedal.com

- Hernie diskale
- Paralizat e ndryshme
- Spondilofrozozat
- Marrije mendsh
- Bursitin
- Enjtnjen e krahut
- Tendinitin
- Dhimbjen e nufullës
- Skoliozen
- Celulitin
- Traumat e gjurit
- Para dhe mbas lindjes



Opozita akuza për drejtimin e KKRT Islami abstenon

Projektrezoluta e KKRT ka sjellë debatë të forta me akuza dhe kundërakuza në Parlamentin e Shqipërisë. Deputetët e Partisë Socialiste kanë akuzuar qeverinë dhe drejtuesin e këtij institucioni për keqadministrimin e këtij institucioni, i cili shkon drejtpërdrejt me interesat e partisë qeverisëse. Rezoluta e paraqitur në Kuvend në përfundim të shqyrtimit të saj nga ana e komisionit të Medias, nxitë mjaft

diskutime. Deputetët e opozitës akuzuan se KKRT-ja ka humbur rolin e saj si rregullatore, ndërsa Ministri për Inovacion dhe TIK, Genc Pollo, në falën e tij nënvizoi se evidentohet qartë dhe trendi pozitiv nga viti në vit i këtij institucioni. "KKRT me rolin e tij në vend që të bëhet pjesë e zgjidhjes është bërë pjesë e problemit. Si një ent rregullator për mediat elektronike në vend KKRT ka dështuar në

realizimin e qëllimit për të cilin ekziston; ka dështuar në pagesat e licensave, për sa kohë ka operatorë që nuk paguajnë dhe po ashtu ka dështuar në vëljën e gjobave, për sa kohë gjobat nuk vilen", deklaroi sot në parlament në emër të grupit të PS-së, deputetja Valentina Leskaj. Kuvendi miratoi me 73 vota pro, 57 kundër dhe 1 abstenim (Kastriot Islami) rezolutën e Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit.

Opozita fton shumicën që të diskutojnë variantet e rikompozimit

Kuvendi

Ligi për peshkimin, rritet kontrolli

Ligi "Për peshkimin" është miratuar në Kuvend me votat e max-horancës dhe opozitës. Por ai nuk ka kalur pa debat, pasi deputetët e majtë ngritën pretendimin se ky ligj nuk e ndryshon gjendjen e rënduar në sektorin e peshkimit. Sipas tyre, flotat e peshkimit janë në një gjendje të mjerueshme, pasi qeveria nuk ka bërë asgjë për sektorin e peshkimit në 7 vite. "Anije të vjetëruara me moshë 20, 45, e 60 vjeçare ka, gadishmëri të ulët teknike, mangësi në infrastrukturën e riparimit të anijeve", evidentoi deputeti socialist, Eduard Shalsi, në lidhje me disa mangësi të këtij sektori. Ndërsa ministri Mediun, deklaroi: "Masat e parashikuara nga ligji janë një mbështetje për rinovimin e flotës dhe modernizimin e anijeve të peshkimit. Mbështetja për peshkim artizanale, masa në karakter social e ekonomik, zgjerim të investimeve në infrastrukturë, sidomos në portet e peshkimit, ndërtimet e bankave dhe e merkatove të peshkut. Marrëdhënia e partneritetit publik-privat në zhvillimin e këtij sektori është jashtëzakonisht e rëndësishme".

Lajmi

Zbardhet formula e re e Partisë Socialiste për të riformatur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Drafti i dytë, i cili ka marrë deri diku edhe konsensusin nga kryeministri Berisha, kërkon rotacion tek anëtarët e KQZ dhe tek kryetari i këtij institucioni. Partia Socialiste ka kërkuar që 2 anëtarët e KQZ të ndërrohen çdo 2 vjet, ndërsa kryetari 1 herë në 3 vjet.

■ ■ ■ TIRANE

FERNADA CENKO

Formulë e re për anëtarët e KQZ-së

Mandatet: 2 anëtarë çdo 2 vjet, kryetari çdo 3 vjet

FORMULA

Anëtarët e KQZ funksionojnë me mandatin katër vjeçar

Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve aktualisht janë me një mandat katër vjeçar, të cilët propozohen nga partitë politike dhe votohen në Kuvendin e Shqipërisë. Të shtatë anëtarët kanë pasur një mandat katër vjeçar pavarësisht se disa prej tyre janë konfirmuar sërish në këtë pozicion. Të gjithë anëtarët e KQZ janë zgjedhur njëherësh në 4 shkurt të vitit 2009, të cilat pasuan me zgjedhjet e përgjithshme. Ndërsa ju përfundon mandati në katër shkurt të vitit 2013. Por ka edhe një nen në Kodin Elektorale që parashikon që anëtarëve mund t'ju ndërpritet mandati nëntë muaj para se të shkohet në zgjedhje të përgjithshme.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

vazhdojnë mes bashkëkryetarëve dhe ekspertëve të ish-komisionit të Reformës Zgjedhore. Sipas Damian Gjiku, PS i'a ka kaluar topin demokratëve për KQZ-në. Por nuk toleron tek varianti i ankimmimeve. "Në kërkojmë që kryetari të mos zgjidhet nga partitë politike, por njëkohësisht kemi qenë fleksibël për formulën, madje i kemi thënë Partisë Demokratike, propozoni ju një formulë të zgjedhjes së kryetarit të KQZ-së, apo qoftë, të ulemi

bashkë e të gjejmë një formë që e quajnë dhe ata të përshatshme. Në këtë pikpamje, ne jemi të hapur që ta rishikojmë qendrimit tonë", deklaroi Gjiku. Sipas asaj që deklaroi në seancën plenare të së mërkurës, formula e re e të majtëve për KQZ-në, duket se mori dhe pëlqimin e kryeministrit. Por, ky i fundit, u shpreh kundër ricklikimit total të anëtarëve të këtij komisioni.

INSTITUCIONET

Sipas propozimit të sjellë

nga Partia Socialiste që pritet të merret edhe "ok" nga Partia Demokratike, kryetari duhet të zgjidhet nga KLD, Konferenca e Gjyqësorit dhe Gjykata e Lartë, duke eliminuar Avokatit e Popullit dhe Presidentin si propozues. Këto të fundit kanë qenë institucione që më herët PS i ka kërkuar si propozuese në formulën e parë të KQZ-së. Këto kandidatura të propozuara nga këto institucione do të kalojnë filtrin e Kuvendit.

SALI BERISHA

Kryeministri Sali Berisha duke se ka shprehur dakordësinë për të riformatur KQZ sipas formulës së sjellë nga opozita. "Është zgjidhur çështja e KQZ-së, si problem amendamenti. Keni sjellë një propozim që pak a shumë mund ta pranojmë, por çfarë ndodh tani. Tani ndodh ekzekutimi politik i të gjithë anëtarëve e të KQZ-së, pavarësisht nga partia politike edhe Subashi dhe me radhë, po pse kështu bëhet?", tha Berisha.

Ilir Gjoni:

Berisha "ngeli" në raportin e DASH

■ ■ ■ TIRANE



Ilir Gjoni

Raporti i publikuar nga DASH ka sjellë reagimi të deputetëve të Partisë Socialiste për mënyrën e qeverisjes nga kryeministri Berisha. Deputetët kanë qenë shumë të ashpër në gjyken e tyre, duke akuzuar Berishën se po vret shpresën për të ardhmen. "Dhe padyshim që është po Sali Berisha arsyeja përse Shqipëria merr një notë jo kaluese kur vjen puna tek liria e shprehjes dhe e medias, si pasojë e shantazheve, kërcënimeve, dhunës mafioze të ushtruar ndaj gazetarëve veçanërisht gjatë dhe pas protestës së 21 janarit dhe mos hetimit e gjykimin e individëve që kanë ushtruar dhunë e presion ndaj tyre. Raporti i

DASH dhe sekretarja e Shtetit Klinton e kanë bërë të qartë: Qeverisë i thonë 'Ne nuk na shpëton asgjë'. Popullin e garantojnë 'ne jemi me Ju'. E po të kesh për aleat kryedemokracinë botërore, fundi i manipulatoreve është i shkruar", shprehet Gjoni. Sipas tij, Berisha refuzon ta pranojë këtë realitet. "Ky është Sali Berisha, i cili, ashtu siç e vërtetoj edhe dje qartazi, në një shou live para ambasadorëve, refuzon kokëfortësisht ta çojë vendin drejt integritetit europian. Ai shkëlmoi reformën zgjedhore edhe pse Raporti i Departamentit të Shtetit thotë qartë se në Shqipëri nën qeverisjen e Sali Berishës është minuar e drejta më themelore që gëzojnë qytetarët në një sistem demokratik. Pra,

e drejta e votës. Duke identifikuar KQZ e Ristanit si një nga arsye të këtyre situatave", është shprehur Gjoni. Sipas tij, referuar raportit, Berisha po vret shpresën për të ndërtuar një Shqipëri ku të mbisundojë shteti ligjor, dhe ku qytetari ta ndiejë veten të lirë e të përfaqësuar denjësisht. "Sali Berisha vazhdon të bëjë sikur nuk e kupton çka kërkon opozita, duke u përpjekur në mënyrë bajate dhe infantile të luajë me kartën e ligjshmërisë. Raporti i DASH na tregon se SHBA, por dhe Europa, po ndjekin me trishtim faktin që Qeveria nuk e ka kuptuar mesazhin e qartë të tyre 'Ne ju vëzhgojmë! Ne jemi me popullin!'", shprehet Gjoni në seancën e djeshme plenare.

Zbardhet formula e re e Partisë Socialiste për të riformatur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Drafti i dytë, i cili ka marrë deri diku edhe konsensusin nga kryeministri Berisha, kërkon rotacion tek anëtarët e KQZ dhe tek kryetari i këtij institucioni. Partia Socialiste ka kërkuar që 2 anëtarët e KQZ të ndërrohen çdo 2 vjet me rotacion, ndërsa kryetari, ose anëtar i shtatë të ketë një mandat tre vjeçar, pra të zëvendësohet çdo tre vjet. Sipas këtij propozimi, mendohet se anëtarët e kanë mandatin 6 vjeçar, ndërsa kryetari e ka 3 vjeçar. Kjo përkethehet kështu: Pasi janë zgjedhur shtatë anëtarët, zhvillohet edhe shorti, i cili hidhet vetëm një herë. Në short dy prej anëtarëve zgjedhin të jenë me mandat dy vjeçar, dy anëtarë të tjerë me mandat katër vjeçar, dhe dy anëtarë të tjerë kanë fatin e mirë për të qenë gjatë vjet anëtarë KQZ. Kjo sjell një vazhdimësi në konceptin e opozitës. Por kjo përjashton kryetarin, ose anëtarin e shtatë, i cili në çdo tre vjet do të ndërrohet. Kjo e bën që KQZ të ketë gjithmonë anëtar me eksperiencë dhe të mos jetë asnjëherë staf i ri, për të mos dështuar edhe në punë. Kjo të paktën është kërkuar edhe nga komuniteti ndërkombëtar, për të shmangur KQZ e 're'.

BLEDAR ÇUÇI

Eksperti i Partisë Socialiste, Bledar Çuçi është shprehur se varianti i rotacionit të anëtarëve të KQZ është për të siguruar vazhdimësinë, duke mos lejuar që brenda një mandati t'ju mbarojnë mandatet edhe anëtarëve të tjerë. "Varianti i rotacionit nuk është një shpikje. Varianti i rotacionin zakonisht përdoret në institucione të tilla për të siguruar vazhdimësinë. Në mënyrë që, vazhdimisht, mbarimi i afatit 4 vjeçar të njërit anëtar të mos përkojë me mbarimin e afatit 4 vjeçar të anëtarit tjetër", shpjegon eksperti socialist, Bledar Çuçi.

DAMIAN GJIKURI

Konfirmohen që negociatat me dy forcave kryesore

Prill, frenohet kreditimi i ekonomisë nga bankat

Kredia për ekonominë pësoi frenim gjatë muajit prill, duke shtuar shqetësimet për kërkesë të dobët dhe ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Portofoli i kreditit në pakësua me rreth 200 milionë lekë krahasuar me një muaj më parë. Ndërkohë, kreditimi i individëve gjatë prillit ra me rreth 500 milionë lekë krahasuar me marsin. Ndërkohë që

kreditimi vazhdon të ecë me paterica, depozitat nuk e ndalin rritjen dhe për në fund të prillit arritën vlerën e 891.3 miliardë lekëve, me një rritje prej afro 7 miliardë lekësh krahasuar me muajin paraardhës. Depozitat në sistemin bankar shqiptar rezultuan 10.5% më shumë se një vit më parë. Struktura e njeteve dhe detyrimeve të sistemit bankar konfirmon një prirje të

theksuar të ekonomisë drejt kursimeve më shumë se sa shpenzimeve. Banka kanë likuiditete më të mjaftueshme për të financuar, por kërkesa e dobët dhe rreziku më i lartë nuk i japin krahë huadhenies. Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të nxitur shpenzimet përmes politikave monetare lehtësuese nuk duket se po e arrijnë qëllimin e tyre deri tani.

Dr. Gjergji Filipi komenton rishikimin buxhetor

Qeveria, planifikime të pasakta fiskale

"Shkurtime, manovra taktike afatshkurtra"

Lajmi

Sipas ekspertit të ekonomisë dr. Gjergji Filipi, shkurtimi i shpenzimeve buxhetore, i parashikuar për këtë mesviti, mund të ketë vetëm pasojë negative. Ai thekson se, faktikisht, investimet janë prekur me kohë nga këto shkurtime, me mospagimin e subjekteve për punën e kryer

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Sipas informacioneve nga ministria e Financave, rishikimi i buxhetit në muajin qershor do të jetë në masën 20 miliardë lekë shkurtime ose edhe më shumë. Ende qeveria pret të shohë shifrat e 5-mujorit, para se të vendosë se ku do të përqendrohet "gërshëra". Për të komentuar rreth rishikimit buxhetor i morëm këtë intervistë dr. Gjergji Filipi, drejtor kërkimesh në Institutin Agenda.

Në Foto:
Dr. Gjergji
Filipi,
drejtor
kërkimesh
në Institutin
Agenda



Zoti Filipi, kush është, sipas jush, arsya e kësaj mase nga qeveria: synimi për të ulur deficitin buxhetor, mungesa e të ardhurave sipas parashikimit apo fakti që nuk jemi në një "vit elektoral"?

Lajmi për rishikim buxhetor është bërë tashmë i zakonshëm që prej vitit 2010. Nga pikëpamja e qëndrueshmërisë fiskale, edhe viti 2009 do ta kishte të nevojshëm një rishikim të tillë, paqsa se ju drejtuar borxheve për të amortizuar (fshehur!) rënien e ritmeve të parashikuara të rritjes dhe deficitin më të lartë buxhetor të regjistruar në dekadën e fundit. Në fakt, është pikërisht ky moment kur rikthehet niveli i borxhit publik mbi kufirin e 60% të PBB-së, kësaj here në momentin më të pafavorshëm historik për botën mbarë.

Në pikëpamjen e arsyetimit të qëndrueshmërisë fiskale, janë njësoj të vlefshëm, si argumenti për të synuar uljen e deficitit buxhetor, ashtu dhe ai i mungesës së të ardhurave sipas parashikimit. Të dyja këto nënkuptojnë të njëjtin shkak: planifikim i pasaktë fiskal. Lidhur me argumentin mbi "vitin elektoral", mendoj se ishte pikërisht presioni politik, i cili detyroi autoritetet financiare të parashikojnë një rritje të pamundur ekonomike prej 4.3% për

vitin 2012. Ndonëse të tërë institucionet ndërkombëtare ishin shprehur qartë - dhe në kohën e duhur për t'u reflektuar në hartimin e buxhetit - që Shqipëria do të shënonte rritjen vjetore ekonomike më modeste që prej ardhjes së krizës globale. Gjithashtu, një sërë aktorësh mediatikë dhe ekspertësh lokalë kishin tërhequr vëmendjen e duhur ndaj këtyre zhvillimeve negative, tërësisht të pritshme.

Sipas burimeve tona, qeveria do të shkurtojë më shumë shpenzimet kapitale, duke kufizuar apo vonuar realizimin e projekteve në infrastrukturë.

Më pak shkurtime parashikohet të bëhen në arsim apo shëndetësi. Çfare pasojash mund të kishite një korrëzim i tillë?

Në kushtet e zhvillimit ekonomik të vendit, si dhe në këndvështrimin e garës rajonale për zhvillim, Shqipëria vazhdon të renditet "e fundit e klasës" për nga të ardhurat për frymë. Krjedhimisht, kudo që të shkurtohen shpenzimet buxhetore, ato mund të sjellin vetëm ndikime negative. Gjithsesi, nisur nga shkurtime të viteve të shkuara, ku sektorë që pësuat rënie të investimeve si bujqësia dhe arsimi janë sektorë me ndikim më afatmesëm

ndaj burimeve apo motorëve të rritjes ekonomike të vendit, informacioni i prekjes së shpenzimeve kapitale vjen si një risi në tashmë traditën e shkurtimeve buxhetore. Në këtë kontekst, vlen të theksohen dy aspekte. Së pari, ndonëse në mënyrë të fshehur, shpenzimet kapitale janë prekur nga "gërshërë", duke mos respektuar

vorizim strategjik i bujqësisë apo arsimit, si sektorë më të qëndrueshëm në synimin të nxitjes së rritjes ekonomike dhe të konkurrueshmërisë rajonale të vendit, informacioni i siguruar nga burimi juaj tingëllon si një manovër taktike shumë afatshkurtes.

Nuk duket se kohët e fundit shpenzimet operative kanë ardhur në rritje, mbi objektivat, ndërkohë që investimet janë mbajtur, si të thuash, "me shiringa"?

Sa i përket nivelit të shpenzimeve kapitale, këto kanë qenë në nivele të kënaqshme deri në vitin e "gropës fiskale", pra 2009-tën dhe kanë ardhur në rënie në vitet e fundit. Ritmet e larta të shpenzimeve kapitale janë shoqëruar me debate të ashpër lidhur me efektivitetin e investimeve të kryera me to, por dhe me tërheqje vërejtjeje nga institucionet financiare ndërkombëtare mbi peshën e borxhit që u imponua mbi vitet në vijim të ekonomisë vendase. Për këtë madje, FMN-ja u shpreh hapur, duke kërkuar përcaktimin e më pas zbatimin e një rregulli fiskal strikt që të ngurtësonte nivelin e borxhit ose të shpenzimeve në mënyrë që të evitoheshin luhatjet e stimuluarra ciklike.

Ishte pikërisht presioni politik, i cili detyroi autoritetet financiare të parashikojnë një rritje të pamundur ekonomike prej 4.3% për vitin 2012


detyrimet kontraktore të qeverisë ndaj të tenderuarve për të kryer investimet publike. Sipas FMN-së, bëhet fjalë për shifra të rendit rreth 1% të PBB-së. Së dyti, ndodhemi përpara një viti elektoral kyç, çka nënkupton se, megjithë favorizimin në dukje të sektorëve afatmesëm të sipërpërmendur duke mos "i futur gërshërë" në 6-mujorin e dytë të këtij viti, është e qartë që investimet në këta sektorë në vitin e ardhshëm nuk priten të jenë aspak optimiste. Padyshim që shpenzimet kapitale në 2013-ën pritet të zenë peshë më të madhe në totalin e shpenzimeve, kështu që, më shumë se sa fa-

Investimet

Greqia, partner nr.2 pavarësisht krizës

■ ■ ■ TIRANE

Pavarësisht nga situata e rëndë e krizës ekonomike në vend, Greqia vazhdoi të ishte partneri i dytë, pas Italisë, më i rëndësishëm i Shqipërisë për vitin 2011. Sipas të dhënave të Institutit Shqiptar të Statistikave (INSTAT) tregtia dypalëshe Greqi-Shqipëri nuk është prekur në mënyrë të dukshme ende nga situata ekonomike. Vëllimi i tregtisë mes dy vendeve ra vetëm 1.5%, në 67.8 miliardë lekë dhe importet shqiptare nga Greqia për 2011 arritën në 57.6 miliardë



lekë, me një rënie të vogël prej 4% që nga 2010-a, por mbajtën peshën 10.6% të vlerës totale të importeve shqiptare. Për përfaqësuesit e zyrës ekonomike të ambasadës greke në Tiranë, "duhet pasur parasysh se, pavarësisht rënies së lehtë, importi shqiptar nga Greqia në 2011-n vlerësohet në nivele të kënaqshme, pasi është 22.5% më i lartë krahasuar me 2006-ën".

Vlera totale e eksporteve shqiptare drejt Greqisë për këtë periudhë, më së shumti produktet bujqësore, tekstile, peshk dhe lëndë të para, u rrit

ndjeshëm me 16% që nga 2010-a dhe arriti një vlerë prej 10.1 miliardë lekësh.

Greqia është gjithashtu burim shumë i rëndësishëm për investimet direkte në vendin tonë. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, stoku i investimeve direkte greke u rrit me 7.8%, duke arritur në 724 milionë euro në 2010-ën. Vlerësohet se 270 sipërmarrje greke operojnë në Shqipëri, ndërkohë që më shumë se 100 kompani të njohura shqiptare janë direkt të lidhura me firmat greke, ose importojnë prodhime greke nga ky vend fqinjë.

LAJME SHKURT

■ Konferencë e BB për raportimin e auditit financiar

Ministria dhe zyrtarë të lartë nga shtatë vende të Evropës Juglindore dhe Moldavisë, pjesëmarrës të programit "Rrugat drejt Evropës" - Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimit Institucional (REPARIS), si dhe përfaqësues nga BE-ja, vende të tjera evropiane dhe organe ndërkombëtare, u mbledhën në Vjenë për konferencën e tretë ministeriale, të organizuar nga Banka Botërore. Ata diskutuan për progresin e bërë në vendet e tyre për përmirësimin e sistemeve të raportimit financiar dhe përafrimin e tyre me legjislacionin e BE-së. Në konferencë u theksua se raportimi financiar i përmirësuar ndihmon në uljen e barrierave të biznesit për investime, në veçanti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të), duke ndihmuar kështu nxitjen e konkurrencës dhe të rritjes ekonomike.

■ Vijon forcimi i dollarit, euro pranë 139 lekëve

Gjatë ditës së djeshme dollari ka pësuar një tjetër forcim vlerë në këmbim kundrejt lekut, me 0.23 lekë më shumë se një ditë më parë. 1 dollar është këmbëruar në 111.92 lekë, duke iu afruar kështu një tjetër kuote historike. Rritja e dollarit është pasojë e rritjes së tij në bursat ndërkombëtare, në një kohë kur monedha evropiane nuk është në ditët e saj të mira. Raporti dollar/euro ka vijuar të jetë në nivelin e 1.24 USD. Euro ndërkohë po humb vazhdimisht terren edhe ndaj lekut dhe dje i është afruar kufirit të 139 lekëve, por me një dobësim të lehtë ndaj monedhës vendase, prej vetëm 0.03 lekë krahasuar me një ditë më parë.



AKTUALITET

Drogë në Gjermani, pranga tre trafikantëve në Shqipëri

Operacioni për ndalimin e tre shqiptarëve të shpallur në kërkim, të akuzuar për trafikimin e një sasie të konsiderueshme lëndë narkotike në Gjermani u shtri në Tiranë, Lushnje dhe Kukës. Burime zyrtare nga policia thane se operacioni "Magnum-Al", bëri që të vihen në pranga Devis Lushnjari, 36 vjeç me detyrë përmbarues privat, Armando Cakaj, 37 vjeç dhe Orest Tabako 32 vjeç. Tre të

sipërpërmendurit në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë kryer trafikimin e 232 kilogramëve lëndëve narkotike në drejtim të Gjermanisë. Mësohet se më 10 mars të vitit 2010 nga Policia Gjermane është sekuestruar një ngarkesë prej rreth 232 kilogramë marijuanë, në kamionin me targa TR 0813 T dhe TR 1914 S, ku u arrestua shqiptari Kletian Kola. Nga ana e policisë thuhet se Kola ka

bashkëpunuar për trafikimin e lëndës narkotike me Lushnjarin, Cakajn dhe Tabakon. Kapja e tre trafikantëve u bë pasi ndaj tyre ishte vendosur masa e sigurisë "Arrest me burg", ndërsa në cilësinë e provës materiale u sekuestruan dy armë zjarri, përkatësisht 1 pistoletë dhe 1 shotgan; 2500 euro dhe 1700 000 lekë të reja, dy makina si dhe 5 telefona celularë.

15 vjeçaria u shfrytëzua nga gardisti Ilirjon Gjoni

Lajmi

Një efektivi i Gardës së Republikës është arrestuar nën akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit. Sipas policisë ai ka pasur rolin e tutorit, duke gjetur klientë për të dashurën e tij 15 vjeçare, të cilën e shfrytëzonte në ambientet e banesës së tij si dhe në motele të ndryshme. Mes klientëve mendohet se janë dhe disa efektivë të Gardës së Republikës.

TIRANE

ELTON QYNO

Një efektivi i Gardës së Republikës kishte kthyer në prostitutë të dashurën e tij 15 vjeçare, duke e shfrytëzuar atë në ambientet e banesës që kishte marrë me qera në zonën e "Unazës së Re" në kryeqytet si dhe në motele të ndryshme. Klientët gjendeshin nga vetë i arrestuari Ilirjon Gjoni, i cili siç mësohet në disa raste ka pranuar që e dashura e tij të kryejë marrëdhënie seksuale me disa nga kolegët e tij të Gardës së Republikës. Prej pesë muaj me rradhë 25 vjeçari Gjoni ishte kthyer në tutorin e minorenes, ku sipas policisë së kryeqytetit për çdo akt seksual ai u merte klientëve nga 150 deri në 200 mijë lekë të vjetra. Hetimet e policisë kanë nxjerrë në dritë se efektivi i gardës Ilirjon Gjoni ka konsumuar plotësisht veprën penale të "Shfrytëzimit të të miturave në prostitucion". Pas sigurimit të provave materiale të mërkuar në mbremje policia e Tiranës ka bërë arrestimin



në flagrancë të 25 vjeçarit Ilirjon Gjoni, i cili ishte duke biseduar me një klient lidhur me shumën financiare që do të përcaktonin, në këmbim të kryerjes së marrëdhënies seksuale me minorenen 15 vjeçare. Ndërkohë që policia gjatë hetimeve ka bërë identifikimin e plot 8 personave, të cilët kanë kryer marrëdhënie me 15 vjeçaren, duke bërë që edhe ata tashmë të jenë në verifikim për akuzën e "Kryerjes së marrëdhënies seksuale me të mitura". Pritet që i riu nga fshati Derjan i rrethit të Matit të dalë pas dy ditësh para

gjykatës, ku do njihet me masën e prokurorisë. **KALLËZIMI NGA FAMILJARËT**
Të afërmit e minorenes kanë qënë ata që të parët kanë rënë në gjurmë të këtij trafiku. Fillimisht ka nisur gjithçka si një histori dashurie mes 15 vjeçares dhe efektivit të Gardës së Republikës, por pasi kanë konstatuar mungesat e shpeshta në banesë, familjarët e vajzës kanë takuar efektivin e gardës duke i kërkuar këtij të fundit që të martohet me ose në rast të kundërt të ndërpiste lidhjen intime. Mirëpo kësaj kërkesë, 25 vjeçari i është

përgjigjur me pretendimin se nuk e njihje fare 25 vjeçaren dhe se me të nuk kishte asnjë lidhje intime. Pas kësaj, familjarët e vajzës kanë kryer verifikime private ku kanë konstatuar se vajza e tyre shfrytëzohej si prostitutë në banesën e efektivit të

seksuale disa herë me të, ndërkohë që mes 8-personave thuhet se janë dhe emrat e disa prej kolegëve të efektivit të Gardës së Republikës. Aktualisht policia është duke verifikuar pozicionin e tyre në këtë çështje, ku gjatë ditës së djeshme por edhe në ditët në vazhdim ata do të pyeten nëse kanë pasur dijeni mbi moshën e vogël të minorenes, me të cilën kryenin marrëdhënie seksuale. Në rast se do të arrihet të provohet implikimi i tyre, klientët do të meren në ndjekje penale.

DËSHMIA E 15 VJEÇARES

Ajo që konsiderohet si prova kryesore në këtë çështje është dëshmia e 15 vjeçares që ka rënë preh e këtij prostitucioni. Në prani të një psikologje por edhe të një oficeri të policisë së Tiranës, minorenia ka treguar të gjithë periudhën dhe skemën se si është shfrytëzuar nga i dashuri i saj. 15 vjeçaria ka pohuar se gjithçka ka nisur kur ajo ka pranuar të kryejë marrëdhënie seksuale me të dhe më pas Gjoni, i ka kërkuar që për hir të dashurisë së tyre të shiste trupin e saj, pasi i arrestuari i kishte pohuar se kishte vështirësi ekonomike.

I ka kërkuar që për hir të dashurisë së tyre të shiste trupin e saj, pasi i arrestuari i kishte pohuar se kishte vështirësi ekonomike

gardës, të cilën ai e kishte marrë me qera në zonën e "Unazës së re". Kaq ka mjaftuar që familjarët të drejtohen policisë së Tiranës, ku së bashku me 15 vjeçaren të bëjnë kallëzim penal. Ndërkohë që nga hetimet e kryera nga ana e agjentëve të sektorit të antitrafikeve është arritur të provohet dhe implikimi i efektivit të gardës, pasi ai është kapur duke biseduar me një nga klientët e radhës, që do të çonte në shtrat të dashurës së tij 15 vjeçare. Policia bën me dije se ka identifikuar dhe tetë persona të tjerë të cilën kanë qënë klientë të minorenes. Disa prej tyre kanë kryer marrëdhënie

LAJME SHKURT

■ Vritet kosovari tek shkëmbi i Kavajës

Një shtetas nga Kosova është ekzekutuar në orët e para të mëngjesit të së enjtes pranë banesës ku jetonte prej kohësh me qera në zonën e Shkëmbit të Kavajës. 44-vjeçari Skënder Spahia është ekzekutuar nga dy persona ende të paidentifikuar, të cilët i kishin zënë pritë pranë shtëpisë herët në mëngjes. Kosovari sapo zbriti nga makina e tij për të shkuar në shtëpi u qëllua për vdekje nga dy personat. Ngjarja e rëndë ka tronditur edhe fqinjët që jetojnë aty, të cilët të pyetur nga policia e Durrësit thanë se autorët pas kryerjes së krimit u larguan menjëherë nga vendngjarja. Burime nga Policia e Durrësit bëjnë me dije se vrasja dyshohet të ketë ndodhur për motive personale.

■ Sarandë vret graun dhe më pas veten

Krimi brenda familjes ngre krye në fshatin Berdenesh të Sarandës, kur në orët e para të mëngjesit së djeshëm një burrë 70-vjeçar ka vrarë me pistoletë pas koke bashkëshorten e tij, teksa po mllte si përditë lopët, dhe më pas ka vrarë veten. Dy bashkëshortët kishin 12 vite të martuar, dhe për të dy ishte martesë e dytë. Krimi ndodhi rreth orës 05:00 të mëngjesit, në banesën ku çifti rronte vetëm, pranë Urës së Çukës, në rrugën që lidh Sarandën me Ksamilin. 70-vjeçari Ismail Lelaj fillimisht ka qëlluar me pistoletë pas kokës gruan e tij, Thëllenzë Ruko 57 vjeç, e cila ishte ngritur në mëngjes dhe po mllte lopët, qëmshtin e të cilave e tregonte përditë në qytet. Pas vrasjes së gruas, rreth orës 05:30, Ismail Lelaj ka qëlluar më pas dhe veten

Seanca gjyqësore

Kujdestaria për fëmijët, lirohet Manjola Prifti

TIRANE

Lirohet nga qelia dhe kyçet në banesën e saj 37-vjeçaria Manjola Prifti, ish-bashkëshortja e Fatmir Ramës ose siç njihet ndryshe si "Miri i Xhikes". Në seancën e djeshme gjyqësore e arrestuara për trafik droge dhe pastrim parash në Itali, nuk ka pranuar të japë asnjë deklaratë përpara togave të zeza ndërkohë që avokati i saj Arben Prifti ka pohuar se e ndaluar nuk mund të mbahet në qeli për shkak të kujdestarisë së dy fëmijëve të saj, njëri 13 vjeç dhe tjetri vetëm 4 vjeç. Nisur


nga kjo situatë por edhe për shkak se prokurorisë i mungonte vendimi i gjykatës Italiane që e ka dënuar me 11 vjet burg 37 vjeçaren, avokati i kërkoj togave të zeza caktimin e masës së sigurimit "detyrim paraqitje". Ndërkohë që prokurori i çështjes Besnik Cengu, bëri me dije se e ndaluar është arrestuar pasi emri i saj ndodhej mes personave të kërkuar të interpolit. Prokurori Cengu, deklaroi se për shkak të kujdestarisë së fëmijëve dhe mos ndarjes së nënës nga fëmijët e saj, gjykata duhet të vendosë masën e "arrestit në shtëpi". Pas dëgjimit të kërkesave të palëve, gjykata e Tiranës vendosi të



Manjola Prifti

pranojë kërkesën e prokurorit Besnik Cengu, duke e lënë të arrestuar në arrest shtëpie. Pritet që brenda 40 ditëve në adresë të prokurorisë së Tiranës, të mbërijë nga Italia letërporsia me vendimin e dënimit të Manjola Priftit për akuzën e trafikut të drogës dhe pastrimit të parave. Ish-bashkëshortja e Fatmir Ramës që njihet ndryshe dhe si "Miri i Xhikes" është arrestuar nga policia e Tiranës, pas një urdhër-arresti ndërkombëtar të nxjerrë nga Interpol Roma në Itali. 37-vjeçaria në momentin e arrestimit ka qënë në ambientet e diskotekës të saj "Doberman Club", ku efektivi të policisë së kryeqytetit

kanë mundësuar arrestimin e Priftit, duke i vënë në dispozicion ekstraktin e nxjerrë nga Italia për arrestimin e saj. Efektivë të Grupit të Operacioneve Speciale rreth orës 16:00 të pasditen së martës kanë shkuar në fshatin Vaqarr, pas informacioneve të marra në rrugë operative se personi që kërkohej nga drejtësia italiane ndodhej në ambientet e një diskoteke. Pikërisht përballë godinës një katëshe në të cilën momentalisht është ndërtuar diskotekën "Doberman Club" që ndodhet përballë kështjellës "Konti", efektivat e policisë kanë mundësuar arrestimin e personave të diskos Manjola Prifti.



VRAU SHQIPTARIN, DEKRETOHET

Për 9 vjet rresht emri i agjentit Agatino Russo është lakuar si vrasësi i shqiptarit 19 vjeçar Julian Alikaj. Russo qëllon dhe vrau shqiptarin teksa ai ishte duke u arratisur me një makinë të vjedhur. Por pas 9 viteve burg, agjenti i policisë Agatino Russo lirohet dhe më pas dekretohet me medalje mirënjohje për shërbimet e tij, të dhëna në luftën kundër krimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike.



SHER PËR PRONËN NJË PLAGOSET

Konflikti për motive pronësie ka bërë që një person të plagoset të enjten në kryeqytet. Ngjarja ndodhi paraditen e të enjtes në zonë pranë ish-parkut të autobusëve në Tiranë. Policia e Tiranës bën me dije se i plagosur ka mbetur Avni Nika, i cili është dërguar menjëherë në Spitalin Ushtarak. Uniformat blu të kryeqytetit kanë mundur të arrestojnë autorin e plagosjes, i cili është Abdyl Zgura.

Reagimi i Kryqit të Kuq pas padisë gjyqësore për kthimin e ish-pallatit të princeshave

Kryqi i Kuq: Pallati është i yni

Zamir Muça: Ministrisë së Kulturës i kemi bërë kërkesa, por s'na ka vënë në dizpozicion ambientet. "Nuk di arsyen se pse na ka paditur në Gjykatën e Tiranës princi Leka Zogu".

Lajmi

Edhe pse godina e ish-pallatit të princeshave është në pronësi të Kryqit të Kuq, Ministria e Kulturës ska pranuar të lirojë objektet, për shkak se në të ndodhet libraria. Tashmë këtë pronë e kërkon nëpërmjet gjykatës dhe princi Leka Zogu II, i cili ka paditur Kryqin e Kuq Shqiptar, duke kërkuar prej tij që të njohë si pronar Leka Zogu e II.



Padia civile

Pak ditë më parë prince Leka Zogu i II paditi në Gjykatën e Tiranës Kryqin e Kuq, duke kërkuar që ky i fundit të njohë si pronar Leka Zogun, për ndërtesën dy katëshe, që ndodhet përballë parlamentit.

Në foto: Zamir Muça, Sekretari i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq në Shqipëri

LAJME SHKURT

Trafiku i drogës, kapet fieraku dhe vlonjati

Dy persona janë vënë në prangat e policisë në kuadër të operacionit të koduar "Shtegu i vjetër". Operacioni në fjalë bëri të mundur prangosjen e 32 vjeçarit Emirjan Ferko nga Mbrostari i Fierit dhe 60 vjeçarit Jonuz Memini nga Vlora. Burime zyrtare nga policia thanë se Ferko dhe Memini u kapën në flagrancë teksa po tentonin të trafikonin në drejtim të shtetasit grek një sasi prej rreth 6 kilogramë marijuanë, me autobusin e linjës Tiranë-Athinë. Në vijim të këtij operacioni gjatë kontrollit në banesën e Jonuz Meminit u gjetën dhe sekuestruar dhe rreth 27 kg 33 gramë marijuanë e ndarë në 23 pako. Sakaq dy të ndaluarve ju sekuestruan edhe 2 makina.

Kapet mashtroesi, hiqet si inspektor i KLD-së

Një 56-vjeçar mashtroer duke u deklaruar si inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për të përvetësuar para përmas mashtroerit është arrestuar nga uniformat blu të qytetit të Vlorës. Mashtroesi quhet Kudret Kopo, 56 vjeç dhe banues në Tiranë. Policia e Vlorës bën me dije se pak minuta pas mesnates Kudret Kopo ishte paraqitur në Komisaratin e Vlorës për të kallëzuar penalisht një tjetër person. Gjatë procedurës së kallëzimit penal, Kudret Kopo deklaroi se ishte inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, pretendim për të cilin dispononte një dokument. Kopo rrefëz se kishte ardhur në qytetin e Vlorës me qëllim, që të takonte shtetasin me iniciale D. Z., të cilin i kishte premtuar se me njohjet që kishte, do t'i mbyllte një çështje penale, angazhim, për të cilin kishte marrë fillimisht shumën prej 5000 euro. Por, më vonë nuk kanë rënë dakord dhe shtetasi D.Z., i kishte marrë me dhunë lekët, që i kishte dhënë vetë bashkë me një sasi prej 1900 euro, që Kudret Kopo kishte me vete.

TIRANE

ELTON QYNO

Ish-pallati i princeshave në Tiranë, që momentalisht është në pronësi të organizatës humanitare të Kryqit të Kuq shqiptar, është kërkuar disa herë nga kjo organizatë por që në fakt ambientet e të cilin nuk janë vënë në dispozicion nga Ministria e Kulturës për shkak se në këto ambiente ndodhet libraria e librit të huaj. Zamir Muça, Sekretari i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq në Shqipëri tregon se ambientet e godinës që ndodhet përballë parlamentit, nuk janë shfrytëzuar asnjë herë nga ana e organizatës, për shkak se ndodhet libraria. Muça tregon për gazetën "Shqiptarja.com" se prona është e regjistruar në Hipotekë në emër të organizatës humanitare. Në intervistën e tij sekretari Muça, fillimisht përjashtoi faktin se godina është dhuruar nga anëtarët e familjes mbretërore por më pas pranon, duke falënderuar këta të fundit për kontributin e tyre që kanë dhënë për organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar. Zamir Muça tregon se ende nuk është njohur me pretendimet e kërkesë padisë të bërë në gjykatë nga Leka Zogu, për shkak se dhe procesi gjyqësor nuk është hapur lidhur me këtë çështje. Më tej Sekretari i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq tregon se gjatë kësaj kohe nuk kanë pasur asnjë mosmarrëveshje për pronën me familjen mbretërore dhe se s'janë takuar asnjëherë për të diskutuar rreth kësaj çështjeje. Ai tregon se objektin e kanë fituar në vitin 1997 dhe që nga kjo periudhë kanë kaluar

shumë vite dhe asnjëherë nuk i kanë shfrytëzuar ambientet. Objekti për të cilin Kryqi i Kuq Shqiptar dhe familja mbretërore janë përfshirë në proces gjyqësor, ndodhet përballë selisë së parlamentit. Zamir Muça, pohan se nuk di arsyet se pse Leka Zogu, kërkon tashmë pas kaq shumë vitesh pronësinë e tij në gjykatë. Siç mësohet vite më parë godina ka shërbyer si burg, dhe më pas është kthyer në rezidençë qeveritare, duke qëndruar në të motrat e mbretit Ahmet Zogu.

Princi Leka Zogu i II ka paditur në gjykatën e Tiranës Kryqin e Kuq Shqiptar për kthim sendi që konkretisht bëhet fjalë për ish-pallatin e princeshave. Juve



Në foto: Ndërtesa që njihet si Pallati i Princeshave

çfarë mund të thoni rreth kësaj çështjeje?

Është një kërkesë dhe një padi pranë gjykatës të cilën ne e kemi marrë vesh dhe nëpërmjet shtypit që e falënderoj. Bëhet fjalë për një pronë që ekzistësisht i bie ish-biblioteka e vjetër kombëtare ose sot që e quajmë biblioteka e librit të huaj, e cila i është kthyer Kryqit të Kuq Shqiptar në vitin 1997. Përkundrejt asaj që thuhet realisht kjo është një pronë e cila i është kthyer dhe tashmë është në hipotekë në pronësi

të Kryqit të Kuq Shqiptar, por që realisht kjo pronë nuk është në dispozicion të Kryqit të Kuq Shqiptar, megjithë disa kërkesa që i janë bërë Ministrisë së Kulturës e cila e ka në varësi për të na i kthyer siç e kërkojnë procedurat nurmale të kthimit dhe kompesimit të pronave.

Në çfarë viti princeshat ja kanë dhuruar ndërtesën shoqatës humanitare të Kryqit të Kuq dhe në çfarë forme?

Titulli nuk lidhet shumë, pra emri "Pallati i princeshave" nuk lidhet me aktin e kthimit dhe unë nuk mund t'ju flas do me saktësi, pasi me atë janë marrë njërës të tjerë. Plus që është një kohë shumë e gjatë, dhe se me këtë çështje janë marrë persona të ngarkuar nga organizata e Kryqit të Kuq. Di vetëm kaq t'ju them se ajo është kthyer në vitin 1997. Elementë të veçantë nuk di të të them lidhur me mënyrën se si është kthyer, por sigurisht që është kthyer duke paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të akteve që përkohë në këto lloj procedurash për kthim dhe kompesim.

Por vitin nuk e mbani mënd kur është dhuruar nga princeshat?

Nuk është dhurim nga princeshat. Unë nuk di të të them gjë për këtë çështje pasi nuk jam konsultuar me dosjen.

Po atëherë pse princ Leka ju ka paditur në gjykatë juve si organizatë?

Këtë pyetje bëjani princit Leka Zogu dhe jo mua.

Po ju si organizatë kur të paraqiteni në gjyq çfarë do të kërkonit, pushimin e padisë apo diçka tjetër?

Po ju them edhe një herë që kjo pronë mbi të cilën po flasim është një pronë e Kryqit të Kuq dhe se është hipotekuar nën emrin e kryqit të kuq, që është një organizatë humanitare

kundrejt të gjithë dokumentacionit. Psenë, e kërkesës së princit e di ai, ndërsa ne kemi këtë realitet sot. Për këtë unë skam se çfarë të shtoj. Plus kësaj, e para është që ne duhet të njohemi me kërkesë padinë e tij, me dokumentacionin me faktet mbi të cilat ai ka vendosur të kërkojë pronën dhe pastaj do shikojmë se si do përcaktohet. Ne sot nuk mund të themi asnjë gjë konkrete sepse është vetëm një ditë nga marrja e informacionit për këtë çështje.

Po pasi u njohët me lajmin e padisë, keni kontaktuar me princin ose ai ju ka kontaktuar juve?

Jo dhe mua më duket shumë kohë e shkurtër për momentin që të bisedonim. Unë nuk e di se çfarë hapash

Biles në disa aspekte mund të themi faleminderit ish-paraardhësve të tij për atë kontribut që kanë dhënë për Kryqin e Kuq Shqiptar

konkretë do ndërmëren sepse duhen këshillime dhe sugjerime të personave profesionistë të kësaj pune në lidhje me çështje prone.

Por para se të bëhet padia në gjykatë keni pasur mosmarrëveshje apo ndonjë diskutim me princin?

Asnjë mosmarrëveshje dhe asnjë diskutim skam bërë me të. Këtu nuk na duket asnjë gjë jashtë normales ai ka pretendimet e tij, ndërsa ne do i qëndrojmë këtij realiteti që është sot. Deri tani nuk kemi pasur asnjë kontradiktë, biles në disa aspekte mund të themi faleminderit ish-paraardhësve të tij për atë kontribut që kanë dhënë për Kryqin e Kuq Shqiptar.

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

**DIGITALB****KANALI 50**

Do na ndiqni në të gjithë
Shqipërinë, Maqedoni,
Kosovë, Itali, Greqi dhe në
pjesën tjetër të Europës

Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:**NE SHQIPERI**

Televizioni
MRM
Intel Media
Inkusat
TVM Devolli
Vjosa
Toshkez
Bradsat
Erzeni
Luna
Mariuxho
Permeti

Qyteti
Korçë
Fier
Pogradec
Devoll
Vlore
Lushnje
Elbasan
Shijak
Kavaje
Bulqize
Permet

Irla
Policani
Elbas North & South
Kombi
Lushnja
Prenjas
Alfa Kabell
Cakran
Kucova
Lapardhaja
Brado
Onikumi
Asparag
Mati

Berat
Berat
Elbasan
Fier
Lushnje
Prenjas
Tirane
Fier
Kucove
Berat
Elbasan
Vlore
Rrogzdhine
Mat

Kukesi
Orxhi
Maqellara
Multivizion
Tata Junior
Divjaka
M&G
Ura Vagurore
Saranda Digital
Pupa
Roskovec
HB-CA
Eni A&A
Iliria

Kukes
Fier
Diber
Kavaje
S.Curri
Lushnje
Elbasan
Berat
Sarande
Lushnje
Fier
Peshkopi
Ballsh
Berat

Reci KGM
S3
Ju-al
Mamurras
Manastri
Beishi
ARD&NET

Lezhe
Tirane
Kruje
Lac
Fier
Elbasan
Fier

NE MAQEDONI

Multimedia
Telenet
Skupi Cable

Maqedoni
Maqedoni
Maqedoni

Së shpejti...

**TELEVIZIONI
MË I RI
INFORMATIV
NË SHQIPËRI**

Redaksia & Marketing

Rruga: "Dervish Hima",
Tre kullat, kulla e dytë, Tiranë
mobile: +355 69 60 60 421
marketing: +355 69 60 60 419

Studiot e prodhimit A1
Rruga: "Aleksandër Moisiu"
ish-Kinostudio Shqipëria Sot



A1 REPORT!

origjina e lajmit...

Lajmi në High Definition

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat
profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike

Intervista

► Faqe 14

Richard Hodges: Ja Shqipëria turistike!

Arkeologu britanik në një guidë për trashëgiminë kulturore



Sugjerimi i javës

Të arredosh me harmoni shtëpinë!

NGA MARINA DANERI

Fillojmë shkrimet tona mbi arredimin, duke folur për feng shui, disiplinën mijëvjeçare, qëllimi i së cilës është arritja e harmonisë së brendshme dhe të jashtme të njeriut me ambientin, në një lojë reciproke ndërveprimesh energjie, të kushtëzuara edhe nga ambiente të



arreduara në mënyrë të shëndetshme dhe të rehatshme. Pastaj folëm për "lojën" e riciklimit të materialeve të destinuara për t'u shkatërruar, që jo vetëm josh bricoleur dhe të pasionuar pas atyre që bëjnë gjërat vetë, por edhe arreduesit. Ç'mund të themi për karriken e stiluar nga rekuperimi i xhinseve... ► Faqe 19

Nr: 17 E premte, 1 qershor 2012

E-mail: fundjava@shqiptarja.com

Fundjava

Suplementi i së premtes të SHQIPTARJA.com



RREFIMI I KENGETARES SE NJOHUR EDA ZARI PER KTHIMET E SHPESHTA NE ATDHE DHE TURNEUN E FUNDIT

SHQIPERIA, DHIMBJE E BUKUR

Këngëtarja e njohur shqiptare në një rrëfim mbi përjetimet e saj në vendlindje, muzikë dhe pasionet


■ ■ ■ TIRANË

ROVENA RROZHANI

Eda Zari po i përkushtohet më shumë mëmëdheut këto kohë. Ardha e saj e fundit ishte në mars, por ajo ja ku është sërish në Tiranë. Shtytas? Toka incognita, fushata promovuese albumit të nëntë, dhe disa projekte në finalizim e sipër. Prania e shpeshtë i ka dhënë dorë të zbojë pak mallin e njerëzve që jetojnë larg vendlindjes, por syri vazhdon të jetë i uritur. "Ke parasysh kur vjen në shtëpinë tënde e shikon çfarë mungon ose çfarë është shtuar?"

Më kap një tjetër ndjesi. Më ngazëllesh rrugët, më ngazëllesh kujtimet, një shkollë, një rrugë, një pemë, që edhe mund të jetë e prerë. Por i kam të fotografuara, sepse kam një memorie fotografike.

Është edhe ajo ana pozitive që më



Në foto: Eda Zari

mbush, më ngazëllen dhe më bën të ndihem fëmijë i vogël në kasollen e vet. Nga ana tjetër janë edhe ato gjëra që deri diku edhe dhembnin, apo nuk i shkojnë idesë sime.... Nuk e di, një ndërtesë e paqëlluar, njerëz që sillen në mënyrë anonime me njëri-tjetrin, komshinj që mund të kenë patur një

tjetër kulturë të komunikimit, ndërsa tani dikush mbyll derën, ai që është në kat të pestë nuk e njeh atë që është në kat të parë,ndryshe nga sa ka qenë më parë."

Ndryshe nga dikur por jo në krahasim me jashtë...

Po po... por unë nuk do ta uroja që

ta kishim kaq të theksuar. Sepse kultura e miqësisë që kanë njerëzit me njëri tjetrin duhet të kultivohet. Por ky është edhe ritmi i jetës ndoshta edhe i huazuar pak nga jashtë. Njerëzit kanë problemet e tyre, dëshirat, interesat. Perspektivat e jetës janë fokusuar ndryshe. Nuk fajësoj askënd sepse

është shumë e natyrshme dhe njerëzore. Nuk vij me kritikë, e dua vendin kështu siç është.

Çfarë të jep energji pozitive këtu?

Është shumë e gjerë kjo gama që më ushqen... ► Vijnë në faqen 20

Luga e Argjendtë

NGA DHURATA THANASI



Imam Bajëlldi Tradita që dhuron elegancë!

► Faqe 18



"Dark Shadows" në Millennium

Muzika e "Deception" premierë në Tiranë



► Faqe 16

► Faqe 17

Dëshironi të udhëtoni?

ARKEOLOGU britanik që prej 18 vjetësh mban në profesionin e tij edhe përkushtimin për Butrintin, në një intervistë rreth trashëgimisë kulturore dhe turizmit

Richard Hodges: Ja Shqipëria turistike!

Një guidë sipas arkeologut britanik

ROVENA RROZHANI

Richard Hodges, është drejtor shkencor i fondacionit Butrinti, njëherazi edhe drejtimi i punës kërkimore shkencore në Butrint. Në instancat zyrtare dhe mediatiqe ky është pozicioni profesorit britanik që prej të paktën 18 vitesh shkon e vjen në Shqipëri. Së fundmi ishte në Ksamil ku volumi më i fundit "Butrinti në shekuj" përcoi tek studiuesit dhe publiku rezultatin e 15 viteve gërmime arkeologjike. Gjatë kohës së tij të lirë shkëputëm disa mendime, ose më saktë një vështrim të shpejtë nga e shkuara në të ardhmen mes ecejakeve nëpër Shqipëri. Dhe pse jo Shqipërinë turistike në sytë e një britaniku

Cili ishte kontakti juaj i parë me Shqipërinë?

Kontakti im i parë me Shqipërinë ishte të shihja refugjatet e pare Shqiptare që erdhen në Itali, kur une punoja si drejtor i shkolles britanike ne Rome, ne vitin 1991. Një kontakt tjetër që unë pata me shqiptarët ishte kur u përpoqën të ngjiteshin nga muret e ambasadës britanike në Romë. Ne vitin 1993 unë dhe koleget e mi u takuam me Aleksander Meksin, kryeministër i Shqipërisë në atë periudhë e më pas vizituum Butrintin dhe Gjirokastrën ku pazari ishte ende i hapur dhe funksional.

Dita e parë në Butrint?
Cfarë ju bëri përshtypje më shumë?

Është një vend magjik që më impresionoi atëherë ashtu siç më impresionon dhe tani po njësoj. Në vitin 1993, gjatë vizitës sime të parë aty, mendova që ishte shumë i mirëruajtur. Gjithashtu u impresionova nga arkeologjia që mu duk goxha më serioze se sa e kisha pritur. Kisha menduar gabim.

Po bëhen rreth 18 vite që shkoni e vini në Shqipëri? Mund të quhet një shtëpi e dytë për ju Shqipëria?

Na është dashur shumë përpjekje për të arritur gjërat që kemi arritur, gjatë një dekade që nga viti 1994 deri në 2005, ka qenë një periudhë e vështirë dhe çdo kënaqësi ishte e kufizuar nga puna për të ndihmuar Shqipërinë.

Si janë ditët tuaja kur vini këtu? Cfarë ju pëlqen të bëni në kohën e lirë gjatë qëndrimit në Shqipëri?

Për fat të keq mbetet

shumë pak kohë e lirë, më pëlqen që të shëtis për të shijuar peizazhet e natyrën e bukur të vendit e të reflektoj në mënyrë romantike mbi to. Por ka patur shumë pak kohë në të vërtetë për ta bërë këtë dhe për të reflektuar gjatë qëndrimit tim këtu. Para disa kohësh përshembull vizitova shpellat dhe peizazhet e bukura të Konispolit.

Një muaj më parë ju keni mbajtur një ligjëratë për magjinë e Butrintit në universitetin amerikan të Romës. Sa e vështirë ka qenë në fillim, që të lobonit për Butrintin?

Ishte e vështirë në fillim për të lobuar për Butrintin, sepse ne flisnim me gjuhën e shekullit të 20-të me një qeveri që i shikonte asetet e veta kulturore të vendit nëpërmjet një këndvështrimi të mbyllur të bërjes së parave. Në anën tjetër të gjithë vizitorët dhe fondacionet e huaja që punojnë dhe vlerësojnë vlerën e Butrintit, na kanë ndihmuar e mbështetur shumë, por sfida e vërtetë ish-

Në këndvështrimin tuaj si shqiptarë, Shqipëria duhet të sigurojë 10 për qind të gdp-së nga turizmi në dhjetë vitet e ardhshme

te në Tiranë me elitën e bazuar atje që jo gjithmonë ka qenë shumë mbështetëse për atë çka flisnim ne. Ne qëlluan shumë me fat që UNESCO ishte shumë mbështetëse për gjithë përpjekjet tona dhe na inkurajuan shumë për të realizuar të gjithë këtë që është arritur sot.

Cila është e ardhmja e Butrintit në këndvështrimin tuaj?

Mendoj se e ardhmja e Butrintit është pozitive sepse komunitetet vendore rreth Parkut të Butrintit gjithnjë e më shumë po kuptojnë rëndësinë e tij në terma të zhvillimit të turizmit. Sfida qëndron në ruajtjen e standardeve pra me fjalë të tjera nëse administrimi i sitit do të



Richard Hodges Drejtor Shkencor i Fondacionit Butrinti

bëhet tërësisht vetëm nga shteti, pa kontributin e Fondacionit Butrinti. Cfarë do të ndodhë me Parkun? Kush do të kryejë pastrimin e vegjetacionit dhe kush do të ndërrojë lllamat në muze kur Fondacioni Butrinti të jetë larguar? Nuk besoj që do t'i ndërrojnë qeveritarët e vendit.

Shqipëria tani pas dy dekadash është më e pasur dhe më e zhvilluar, por ka humbur apo ka fituar ajo nga pasuritë e saj historike dhe arkeologjike?

Shqipëria nuk e ka humbur një pjesë të mirë të trashëgimisë së saj sepse qeveritë në vite janë kujdesur për ta mbrojtur atë. Çështja është nëse do të vazhdojnë në saj

ardhmen e afërt ta ruajnë për vlerat e saj strategjike, dhe me sinqeritet mendoj se trashëgimia në vend është e rrezikuar; duket sikur pamja është e zymte por besoj shumë se në momentin e fundit, shqiptarët do të kujdesen për trashëgiminë e tyre. Nuk e kanë bërë këtë me mjedisin, peizazhet e mrekullueshme të Shqipërisë në vite që janë shkatërruar dhe qeveritë me radhë e kanë lejuar këtë. Çdokush duhet të jetë i kujdesshem dhe vigjilent për ruajtjen e trashëgimisë së vendit. Në këndvështrimin tuaj si shqiptarë, Shqipëria duhet të sigurojë 10 për qind të gdp-së nga turizmi në dhjetë vitet e ardhshme, bazuar në asetet e trashëgimisë së saj

kulturore. Kjo do jetë pa dyshim industria më e madhe në vend.

Cila do të ishte një guidë e juaja për të vizituar dhe njohur të shkuarën dhe të sotmen e Shqipërisë?

Çdokush që vjen në Shqipëri duhet të vizitojë Sarandën për të parë Mesdheun në më të mirën e tij, por ndërtimin në formën e tij më të keqe, të vizitojë Butrintin që është një sit i jashtëzakonshëm, të vizitojë Girokastrën për të pasur një ide për interiorin e Shqipërisë, që prej andej të udhëtojë për në Korçë me makinë ku të shijojë peizazhet e bukura, të ndjekë gjurmët e Via Egantias rrugës për në Elbasan, sa më të kthehet në Tiranë për t'u njohur me atë çka Shqipëria është sot, që në fakt është shumë më e qëndrueshme dhe organizuar nga sa mendohet. Më pas të vizitojë Shkodrën për të parë një sy otoman mbi detin Adriatik. Të kujton që 100 vjet më parë e gjitha kjo ishte pjesë e Turqisë, dhe që bota qysh atëherë

E ardhmja e Butrintit është pozitive sepse komunitetet vendore po kuptojnë rëndësinë e tij në terma të zhvillimit të turizmit

ka qenë vazhdimisht në ndryshim dhe kështu do të vazhdojë të jetë përsëri në 100 vitet e ardhshme.

Cili është armiku më i keq i arkeologjisë?

Pseudoarkeologët në një krah dhe në anën tjetër mungesa e pasionit dhe përkushtimit në pjesën e arkeologëve profesionistë.

Prej korrikut do të jeni më pranë Shqipërisë. Do të vini më shpesh?

Sinqerisht nuk e di nëse do të mundem. Di që pozicioni im i ri si president në Universitetin Amerikan të Romës, kërkon përkushtimin tim qind për qind, gjë që do të thotë që koha ime do të jetë më shumë e ndarë midis Amerikës dhe Italisë.

Turizmi

Butrinti

Vipat e lashtësisë



Luftërat e Napoleonit rriten interesin në Adriatik. Pushtimi i shkurtër i ishujve Joniane nga Napoleoni në vitin 1797 çoi në dërgim e François Pouqueville si konsull francez në oborrin e guvernatorit të fuqishëm Osman Ali Pashë Tepelena. Jo për të bërë më mirë por të mbajtur francezët si aleatë, ndërsa Anglezët dërguan agjentin e tyre më të njohur Eiliam Martin Leake. Në 1805 që të dy këta burra ishin në Butrint. Ndonëse pa dyshim ishin atje për të rregjistruar vlerën strategjike të qytetit, që të dy bënë shënime mbi antikitetin. Këto informacione të detajuara janë botuar më vonë dhe përfshijnë përkushtimet e vendit, traditat dhe zakonet e tij si dhe rrënojat e tij dhe arkeologjine. Përfundimi i luftërave të Napoleonit, si dhe pushtimit të Korfuzit nga Anglezët, bënë me të lehtë udhëtimin drejt Greqisë dhe Shqipërisë. Gjatë shekullit të 19-të udhëtarë të shumtë kaluan përgjatë vendit, disa vizituan dhe Butrintin. Një ndër turistët e shumtë ka qendur inicalet e tij si dhe datën në një afresk bizantin pranë Portës së Perëndimit të Akropolisit, AD 1789 P.A.M.. Të tjerë, si Henry Cook dhe kapiteni De La Poer Beresford, erdhen si artistë për të pikturuar dhe dokumentuar këtë vend të famshëm romantik dhe rrënojat e tij piktoreske. Artisti më i njohur i kësaj periudhe ishte piktori Edward Lear, i cili gjatë qëndrimit të tij në Korfuz në fund të 1850 ka paguar disa vizita në kontinent dhe ka vizituar dhe pikturuar Butrintin dhe paisazhin e tij.

Dëshironi të udhëtoni?

BUTRINTI Pak histori dhe informacioni të dobishme për të shijuar historinë e shpallur pasuri të trashëgimisë kulturore por dhe natyrën e bukur

Butrinti, një zhytje magjike në histori

Si të vizitosh parkun më të madh në vend

Akomodimi

Hotel Livia

Midhje të freskëta tek Parku

Hotel Livia ndodhet në zonën e Ksamilit perballë Ishullit të Korfuzit, vetëm pak metra larg Trashëgimisë Kulturore të ruajtur nga Unesco, Butrinti. Hoteli ka



nje ndertesë të përbere prej tullash duke imituar kështu arkitekturën e vilave të lashta romake. Ai ofron 11 dhoma me hapsire të bollshme të pajisura me mobilje druri si dhe me dys-heme të shtruar me terrakote Mesdhetare. Restoranti ofron midhje të freskëta me marra nga liqeni i kripur si dhe peshik krap. Cmimi fillon nga 30 euro me mengjes

Tel: 069 20 51 263

Bed and Breakfast

Akomodim i lirë në fshat

Disa familje që jetojnë në fshatrat e fushës së Vrinës ofrojnë strehim Bed&Breakfast. Strehimi është modest dhe ekonomik. Shpesh janë të përbere nga dhoma tradicionale, të mobiluara a rreth portës të rehatshme. Një familje

zakonisht mund të strehojë deri në katër persona por në fshat mund të gjenden strehime për grupe deri në 20 persona.

Tel: 069 22 19 784

Internacional

Buzë rrugës Sarandë-Butrint

Disponon 24 dhoma të gjitha me pamje nga deti, 18 dhoma dopio, 6 me tre krevatë, 4 suita. Të gjitha dhomat të



pajisura me ajër të klimatizuar të përgjithshëm, TV, frigo-bar. Bar në taracë në një ambient tepër të këndshëm, restorant, piceri, parkim, plazh. Distanca nga deti 20 m, distanca nga rruga buzë rrugës. Buzë rrugës nacionale Sarandë-Butrint, në zonën e re turistike Turizëm-Kanali i Çukës. Cmimi fillon nga 30 euro me mengjes

Tel: 0682092928



Kasollija e Souvenireve

Dyqani i Souvenir-eve ndodhet Brenda portës së Butrintit. Aty ndodhet një ndërtesë prej druri që quhet Kasollija, çatia është e mbuluar me kashtë dhe është e ndërtuar sipas teknikës tradicionale. Kasollija drejtohet prej grave të fshatrave të fushës së Vrinës, pranë Butrintit të cilat shesin ekskluzivisht produkte të bëra nga komuniteti vendas. Ndër produktet që shiten do të gjeni: mozaik të bërë me dorë me motiv nga Pagëzimorja dhe monumentet e tjerë të Butrintit, si dhe artikuj argjendarie, qendrisje, objekte të pikturuara, çanta të dekoruara edhe dru të gdhendur. Të gjitha të ardhurat nga shitja e mallrave ju shkojnë menjëherë prodhuesve. Kasollija është e hapur që nga mesi i Majit deri në fund të Shtatorit.



lit të 5-të kishte peshkopin e vet, Bazilika e Madhe ishte kisha e peshkopit. Bazilika e Madhe u ndërtua në fillim të shekullit të 6-të e.s. në të njëjten kohë me Pagëzimoren. Bazilika fillimisht duhet të ketë pasur tri koridore të ndara nga kolonada me kapitule të cilat ishin të ripërdorura nga ndërtime më të hershme. Në pjesë të tjerë të qytetit janë gjetur deri tani tetë kisha të tjera. Më e rëndësishmja prej tyre ndodhet në fushën e Vrinës në bregun tjetër të kanalit të Vivarit. E ashtuquajtura Porta e Luanit e merr emrin e saj nga një riliev i vizatuar i një luani që

kafshon në fytyrë një dem, e vendosur sipër hyrjes. Rilievi i Luanit nuk ishte pjesë e murit original, por u vendos këtu në shekullin e V-s. me qëllim që të zvogëlonte madhësinë e portës dhe ta bënte më të lehtë për tu mbrojtur.

MUZEU I BUTRINTIT

Muzeu i Butrintit ishte rinovuar dhe rihapur në vitin 2005 që të siguronte një vitrinë për pasurinë dhe kompleksin historik të sitit. Muzeu ndodhet brenda kështjellës së rindërtuar në kodrinë akropoli në një ambient modern dhe elegant. Muzeu përmban historinë e Butrintit si një mikrobote të historisë mesd-

hetare, e lidhur ngushtë me vendndodhjen e tij brenda një rajoni të vogël lagunor si dhe peisazhit. Jo vetëm rindërtimi i vizatimeve të deleguara, po ashtu dhe arkivi material mbështet këtë temë bashkëkohore dhe e kthen vizitën në një eksperiencë magjepëse.

PEISAZHI I LARMISHËM PËRRETH BUTRINTIT

Brenda Parkut Kombëtar të Butrintit ndodhet një shumëllojshmëri e gjerë e habitateve - ligatinat bregdetare, lagunat me ujë të kripur, lumenj dhe toka të hapur kullotje - është siti me i pasur për biodiversitetin në të

Info e dobishme

Parku Kombëtar i Butrintit është hapur gjatë gjithë vitit nga ora 8 e mengjesit deri në mbrëmje. Muzeu është i hapur nga ora 8 deri në 16. Ju duhen rreth tre orë për të vizituar Parkun.

Tarifat e hyrjes

700 Lekë për të huajt
500 lekë për të huajt në grupe prej më shumë se dhjetë
200 Lekë për vendasit

■ Sigurohuni që të merrni një biletë dhe ta mbani me vete gjatë gjithë kohëzgjatjes së vizitës tuaj.

■ Manualët udhëzues në gjuhën angleze dhe shqipe janë në shitje në zyrën e biletave të Parkut. Këto përshijnë udhëzues për monumentet e Butrintit dhe shfjeteve të mjedisit përreth Butrintit, si dhe udhëzues për shtet arkeologjik të afërt dhe për eskursionistët në Shqipërinë jugore.

■ Lejohet që të bëhen fotografi, ndonëse brenda në muze është i ndaluar rreptësisht përdorimi i flash.

■ Udhëtime me varka bëhen rregullisht në Diapor përmes liqenit të Butrintit dhe kalasë së Ali Pashës në deltën e kanalit të Vivarit.

gjithë Shqipërinë dhe parku mbron 26 specie me interes të ruajtjes globale, siç është breshka e vogël, ujku dhe shqiponja me bisht të bardhë. Peisazhi i mrekullueshëm dhe mjedisi i pasur natyror shtrihet përfundimisht Butrintit. Përveç shteteve brenda Parkut Kombëtar të Butrintit, të Luginës së Pavllas në jug ndodhen shumë të tjerë, më pak të njohur, të cilat ofrojnë një hapësirë të mbetjeve kulturore.

Dëshiron të shkosh në kinema?

DARK SHADOWS është një film ku përzihen gjinitë dhe botët e ndryshme, nga ajo gotike tek ultrapop

Legjenda e çuditshme e një plejboji të shndërruar në vampir, në fokusin e Tim Burton

“Dark Shadows”, në Millennium

Nje film me Johnny Depp, Eva Green, Michelle Pfeiffer, Helena Bonham Carter

Johnny Depp, në rolin e një vampiri, Eva Green një rolin e një shtrige dhe bashkë me ta edhe aktoret Michelle Pfeiffer, Helena Bonham Carter. Të gjithë nën drejtimin e regjisorit të njohur Tim Burton, për të sjellë një film ku horrori dhe humorit qëndrojnë harmonikisht bashkë. Ky është “Dark Shadows”, filmi që fillon projeksonet në kinema Millennium prej datës 1 qershor. Një film ku përzihen gjinitë dhe botët e ndryshme, nga ajo gotike tek ultrapop duke përdorur romantizmin si një tipar të veprave më të mira që Tim Burton ka realizuar.

MALLKIMI MISTERIOZ
Në vitin 1752, Joshua e Naomi Collins, së bashku me djalin e tyre Barnabas, largohen nga Liverpool, për të filluar një jetë në Amerikë. Por



edhe një oqean nuk mjafton për t'i shpëtuar një mallkimi misterioz. Pas dy dekadash Barnabas ka nën zotërimi e tij të gjithë qytetin e Collinsport. Ai është i pasur, i fuqishëm,

plejboj ekspert derisa bën gabimin dhe thyen zemrën e Angelique Bouchard (Eva Green). Ajo është një shtrigë me gjithë kuptimin e fjalës, që e dënon me një fat më të keq

se vdekja, duke e shndërruar në një vampire dhe duke e varrosur të gjallë. Dy shekuj më vonë, Barnabas del nga varri i tij dhe e gjen veten në botën e vitit. Duke u kthyer në Collinswood zbulon se prona e tij dikur në lulëzim është rrënuar dhe e mbuluar nga sekrete misterioze. Ndërkohë trashëgimtarët e familjes së tij, janë plot probleme. Për t'i zgjidhur Elizabeth Collins Stoddard ka punësuar një psikiatër, doktorëshën Julia Hoffman, të cilës do t'i duhet të merret me vëllain e Elizabeth Roger Collins, vajzën adoleshente Carolyn Stoddard dhe trashëgimtarin e vogël të fronit David Collins. Duke u bazuar në skenarin e Seth Grahame-Smith (autor i “Krenari, paragjykim dhe Zombie”) si dhe në serinë televizive të Dan Curtis

(1966-1971), Tim Burton realizon me një film vizualisht të pasur dhe plot shpirt. Horrorit dhe melodramës, Burton i shton një element tjetër që e ka bërë filmin të veçantë. Është pikërisht humorit i lehtë dhe i qartë që karakterizon përshtatjen e vampirit Barnabos me realitetin.

DISA VLERËSIME MBI FILMIN

“Një mjeshtëri e vërtetë me shkëlqime të një kinemaje të madhe”. Kështu është “Dark Shadows”, 20 minutat e para të të cilit shpalosin një Tim Burton në kulmin e freskësisë së tij, sidomos pas shumë të diskutueshmit “Alice in Wonderland”. Ato batuta të para e presin spektatorin krahëhapur në një botë gotike ku kamera lëviz pa asnjë problem sa tek të gjallët tek të vdekurit.

PROGRAMET E KINEMASE

NE FUNDJAVE



Filmat në sallë

“Dark Shadows”
(Në të gjitha oraret)

“The Dictator”
(Në orën 18:00)

Orari dhe Çmimet

Filmi 2D

ora 10:30 – 300 lekë
ora 13:00 – 300 lekë
ora 15:30 – 500 lekë
ora 18:00 – 500 lekë
ora 20:30 – 500 lekë
ora 23:00 – 500 lekë

Filmi 3D

ora 10:30 – 500 lekë
ora 13:00 – 500 lekë
ora 15:30 – 700 lekë
ora 18:00 – 700 lekë
ora 20:30 – 700 lekë
ora 23:00 – 700 lekë

NE FUNDJAVE



Filmat në sallë

“The Dictator”
(Në orën 11:00 dhe 16:00)

“Bel Ami”
(Në orën 13:00 dhe 21:00)

Orari dhe Çmimet

ora 13:00 – 500 lekë
Qendra Kristal
ora 18:00 – 500 lekë
Qendra Kristal
ora 12:30 – 500 lekë AGIMI
ora 17:30 – 500 lekë AGIMI
ora 20:00 – 500 lekë AGIMI
ora 22:00 – 500 lekë AGIMI

Sacha Baron Cohen, diktatori i fundit

Sacha Baron Cohen. ko mikru britanik vjen këtë herë në ekranin e madhe nën petkun e një admirali që e ka të mbushur krahëorin me 68 medalje në “The Dictator”. Filmi është drejtuar nga Larry Charles regjisor i “Borat”, prodhimet të suksesshëm të vitit 2006 ku Sacha Baron Cohen luante rolin e një gazetari nga Kazakistan. Në “The Dictator” aktori luan dy role, atë të diktatorit dhe sozisë së tij, ndërsa kontributi artistik i Cohen është edhe në skenarin e filmit. Filmi tregon historinë e një diktatori në

shtetin afrikanor verior Eadiya, që rrezikon jetën për tu siguruar që demokracia nuk do të mbërrijë në vendin e tij që e drejton me grusht të hekurt. Pasi mbërrin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në një takim të OKB-së, admiralit i përgjithshëm Aladin zbulon se është zëvendësuar nga sozia e tij, një coban. Kështu ai endet rrugëve të Nju Jorkut, njihet me pronaren e një dyqani ushqimesh biologjike e cila do të ndryshojë krejtësisht mënyrën e tij të menduarit. Fillimisht u tha se skenari i filmit ishte një për-



shtatje e lirë nga romani i Saddam Husein, “Zabibah and the King”, por më pas media raportoi se kjo nuk ishte e

vërtetë. Megjithatë ngjashmëritë mes diktatorëve dhe personazhit janë të tilla sa që disa media e kanë cilësuar

portretin e gjeneralit Aladin të ngjashtëm me atë të Gëdafa. Aktori britanik ka bërë çmos për të krijuar figurën e të fundmit diktator dhe duke satirizuar politikë diktatoriale që ende është e pranishme në disa vende të botës. Ndoshta kjo është një nga arsytet që filmi është ndaluar të shfaqet në dy vende të Azisë Qendrore të njohura si shtete të mbyllura. Kështu filmi nuk është lejuar të shfaqet në Turkmenistan dhe Tashkikistan. Dikur “Borat” ishte ndaluar të shfaqej në Kazakistan.



Bel Ami, mes klasikes e modernes

Një dramë në ekranin e madh që e gjen historinë nga letëria. Është “Bel Ami” filmi që ka filluar të shfaqet në kinema Imperial. Kush e mban mend romanin me Gi de Mopasan tani ka mundësinë të shohë sesi vjen ai në artin e kinemasë, “Bel Ami”, tregon arritjet e ish-ushtarit të varfer Georges Duroy në

eliten Pariziane të viteve 1890 dhe gjithashtu është një rrefim ambicijeje, pushteti dhe joshjeje. Në këtë filmi protagonistët janë idhulli i të rinjve, Robert Pattinson, e mirënjohura Uma Thurman, si dhe aktorët Kristin Scott Thomas, Christina Ricci dhe Colm Meaney. Filmi cilesohet si një poemë epike e gërshetuar me detaje moderne.

SKEDA E FILMIT

Titulli: “Bel Ami”

Regjia: Declan Donnellan, Nick Ormerod

Skenari: Rachel Bennette

Aktore: Robert Pattinson, Christina Ricci, Uma Thurman, Kristin Scott Thomas, Colm Meaney, Natalia Tena, Holliday Grainger

Kohezgjatja: 102 min

Gjinia: Drame

Dëshiron të ndjekësh një spektakël?

FUNDJAVA artistike në kryeqytet. Nga muzika simfonike, tek shfaqja teatrale dhe një ekspozitë e artit bashkëkohor britanik

Muzika e “Deception” premierë në Tiranë

Në drejtimin e dirigjentit Bruce Hangen

ROVENA RROZHANI

Sazoni i orkestrës simfonike të RTSH ofron këtë javë një koncert të pasur me muzikë klasike që përfshin në program pjesë të njohura dhe të panjohura për publikun shqiptar. Kështu mbremjen e së premtes në sallën qendrore të Universitetit të Arteve, do të vijë koncerti i vetëm që Brahms kompozoi për violinë dhe orkestrë, një pjesë për harqe nga Samuel Barber, Ravel dhe premierë, një nga krijimet e kompozitori austriak Eric Wolfgang Korngold. Dhe është pikërisht muzika e filmit “Deception” e shndërruar në një vepër të

Koncertin e hap violonçelisti Ignacy Grzelazka fitues i Grand Prize, për performancën me të mirë solo



mirëfilltë klasike nga vetë kompozitori. Por jo vetëm kompozitorë dhe pjesë të zgjedhura. Edhe performancat solistike të këtij koncerti janë të spikatura.

Koncertin e hap violonçelisti Ignacy Grzelazka fitues i Grand Prize, për performancën me të mirë solo dhe performancën me të mirë në muzikë dhomë në Allegro-Vivo Music Festival ne Horn, Austri. Ai është shfaqur në hollë të rëndësishme në Europë dhe SHBA dhe ka regjis-

truar një CD me muzikë të improvizuar.

Violonistja lituaneze Egle Jarkova do të luajë Brahmsin. Ajo është fituese e shumë çmimeve ndërkombëtare kompozitore e ndërkombëtare, Jarkova vjen në Tiranë pasi performancave në Austri, Kroaci, Gjermani, Itali, Lituanë, Poloni, Portugali, Rusi, Sloveni, Spanjë dhe Zvicër. Jarkova vjen në Tiranë menjëherë pas diplomimit të saj në Konservatorin e Bostonit.

Pas diplomimit takon skenën e vendit të saj edhe

pianistja Inesa Gegprifti, e cila gjithashtu ka përfunduar studimet në Konservatorin e Bostonit. Fituese e disa çmimeve të rëndësishme kompozitore e ndërkombëtare, Gegprifti vjen pas disa koncertesh në hollë të rëndësishme e Itali, Austri, Slloveni, Kosovë, Maqedoni, Puerto Rico dhe SHBA. Në këtë koncert ajo luan në piano kompozimin e Ravel.

Në fund, por jo i fundit për nga rëndësia është dirigjenti. Baketa e këtij koncerti i takon

Fakte për kompozitorët

■ **Samuel Barber** -Një nga kompozitorët më të famshëm amerikan të shek.XX, i njohur për veprat e tij pianistike, orkestrale, korale dhe operistike. Adagio për harqe i ka siguruar atij një vend të rëndësishëm në repertorin e pjesëve të famshme instrumentale.

■ **Maurice Ravel** -Koncerti për piano e orkestrë në sol maxhor u kompozua midis viteve 1929 – 1931. Koncerti ndjek formën tre kohëshe klasike dhe është influencuar nga muzika jazz. Premiera e koncertit u drejtua nga vetë Ravel.

■ **Eric Wolfgang Korngold** – Kompozitor austriak zhvilloi pjesën më të madhe të aktivitetit muzikor në Holliuid. Koncerti u kompozua në fillim për muzikën e filmit “Deception” që pasqyron jetën e një çelisti, i cili luan në premierën e një koncerti. Në vitin 1946 Korngold e transformoi veprën në koncert

■ **Johannes Brahms** – Koncerti për violinë e orkestrë u kompozua më 1878 dhe iu dedikua violinistit gjerman Joseph Joachim. Ky është koncerti i vetëm për violinë e orkestrë nga Brahms dhe sipas Joachim, ai është një nga katër koncertet për violinë, më të famshëm në historinë e muzikës.

amerikanit prestigjioz Bruce Hangen, aktualisht drejtor i aktivitetëve orkestrale në Konservatorin e Bostonit. Përpos këtij pozicioni Hangen shënon një karrierë të pasur artistike gjatë së cilës ka drejtuar orkestrat simfonike të Omaha, Utah, Kansas, Portland , Denver, dhe ka bashkëpunuar me orkestrat e St.

Louis, Baltimore, Pittsburgh, San Francisco, Atlanta, Jacksonville dhe Houston. Hangen është i njohur për dirigjimet e tij edhe në edhe në Japoni, Kanada, Taiwan, Zelande e Re.

Koncerti është një bashkëpunim mes Orkestrës Simfonike të RTSH-së dhe Ambasadës Amerikane.

JETA ARTISTIKE

1-2-3 QERSHOR



Galeria kombëtare e arteve

“Made in Britain”

Ekspozitë
110 vepra të artit bashkëkohor britanik në një ekspozitë. 29 autorët që vijnë para publikut shqiptar (shumica për herë të parë) janë ndër më të njohurit e më të rëndësishmit e dhjetëvjeçarëve të fundit në skenën e artit pamor.

Ora: 10.00-18.00

Cmimi: 200 leke

2-3 QERSHOR



Teatri i Komedisë

“Histori në Zoopark”

Autor: Edward Albee
Regjia: Arbër Jakllari
Aktorë: Visjan Ukenaj, Arbër Islami
Ora: 19.00
Cmimi: 300 leke

Piterin dhe Xherri, dy njerëz të panjohur në park. Vepri ndërtohet mbi misterin e një ngjarjeje në Zoopark, të cilën sipas Xherrit, Piteri do të ketë mundësi ta mësojë vetëm një ditë më pas në gazeta e televizor

1 QERSHOR



Teatri i Metropolit

“Pema e Çokollatave”

Regjia: Suela Xhonuzit
Aktorë: Suela Xhonuzi, Medi Gurra
Ora: 10:30
Hyrya: Falas

Dy fëmijë Sindi dhe Juli dhe një pemë magjike ... Një pemë e lashtë dhe mjaft e ditur, e cila di të flas gjuhën e njerëzve. Organizon kuicë dhe lojëra argëtuese dhe fal çokollatë.

1 QERSHOR



Universiteti i Arteve

Koncert Simfonik

Orkestrës Simfonike të RTSH-së, formacioni “Girolamo Diruta”

Dirigjent: Vladimiro Vagnetti
Ora: 19:00
Hyrya: e lirë

Muzika e kompozitorëve italianë Giacomo Carissimi, Domenico Stella, Albino Varotti dhe Alessandro Borroni

Teater


Një klithmë për vetminë

Histori në Zoopark” është shfaqja që propozohet këtë fundjavë në Teatrin e Komedisë. Drama e Edëard Albee vihet në skenë nga regjisori Arbër Jakllari i cili ka përfshirë në role aktorët Visjan Ukenaj dhe Arbër Islami.

Shfaqja fillon me Piterin dhe Xherri dy njerëz të panjohur në park. Vepri ndërtohet mbi misterin e një ngjarjeje në Zoopark, të cilën sipas Xherrit, Piteri do të ketë mundësi ta mësojë vetëm një ditë më pas në gazeta e televizor. Piteri duket i interesuar për historinë por, është njekohesisht i thekuqur nga i pan-

johuri! Perpara se të tregojë atë ç'fare ka ndodhur, Xherri perpiqet të hyjë në bisedë me Piterin, duke e pyetur për jetën e tij. Piteri është një burrë mbi të tridhjetat, i martuar, ka dy vajza, dy papagaj. Ai ka një post, drejtues në një shtypshkronjë. Xherri është ana e kundërt e medaljes. Ai është afro të tridhjetave, i pa punë, nuk ka familje, prindërit i kanë vdekur kur ka qenë njëmbëdhjetë vjeç. Ai jeton në një pension. Xherri rrefehet për mardheniet dhe jetën e vështirë sociale në komunitetin ku jeton. Gjatë gjithë pjesës Xherri le të refetencë “historinë e zooparkut...”,

duke i thënë se do të tregojë pak më vonë! Xherri rrefehet për historinë e tij me qenin e pensionit. Piteri perpelitet të kuptojë mesazhin nga kjo histori, derisa bie në mendime të thella. “Historia e zooparkut”, sa vjen dhe behet me mister. Xherri fillon të sillet çuditshëm, ai i kërkon Piterit stolin. Dy burrat nisin të konfliktohen për stolin, derisa arrijnë në dyluftim. Xherri vret veten nga dora e Piterit. Duke e falenderuar Piterin për këtë, perfundon, “historinë” që ka ndodhur në zoopark, me fjalën “kjo ishte ajo që ndodhi në zoopark” Xherri vdes i vetëm në park.



Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

Luga
e argjendte

Receta nga Dhurata Thanasi

Imam Bajëlidi Tradita që dhuron elegancë!

Patëllxhani është një bimë e ardhur nga India Jugore dhe e kultivuar shumë në Azinë Juglindore, por shfaqet në Botën Perëndimore rreth 1500-tës. Patëllxhani është një zarzavat i pasur në fibra dhe me pak karbohidrate të tretshme. Është i mrekullueshëm në rregullimin e nivelit të sheqerit në gjak dhe në kontrollin e thithjes së glukozës. Kjo e bën patëllxhanin një zgjedhje të mirë në ushqim për njerëzit me diabet të tipit 2. Patëllxhanët mund të ndihmojnë për të ulur nivelin e kolesterolit të gjakut dhe gjithashtu presionin e gjakut duke pakësuar rrezikun e sëmundjeve të zemrës. Kaliumi, tek patëllxhani, ndihmon për të mbajtur trupin e hidratuar në nivele të sakta duke shmangur mbajtjet fluide, të cilat mund të kontribuojnë në sëmundjet koronare të zemrës. Patëllxhanët janë të pasur me fibra dhe ujë dhe për përmbajtje të ulët të kalorise duke i bërë ata një ushqim ideal për përfshirjen në dietë për humbje peshe. Rekomandohet të mos gatuhet të skuqura, sepse kane aftësi të thithin shumë vaj duke u shumësuar kaloritet. Rekomandohet të hahen me lëkurë, pasi të lëkurat është vendi ku përqëndrohet shumica e fibrave. Për shkak të përmbajtjes së lartë të fibrave patëllxhanët ndihmojnë në sistemin e tretjes për të punuar mirë dhe me lehtësi në rastet e kapsllëkut. Disa ekspertë besojnë se ngrënia e patëllxhanëve ul rrezikun e kancerit të zorrës së trashë dhe kancerëve të fjetë të traktit tretës. Përmbajtja e lartë e ujit tek patëllxhanët ndihmon në hidratimin e lëkurës dhe e mban atë të duket më e re. Patëllxhanët përmbajnë sasi oksalate. Një efekt i dëmshëm i tyre është se shkaktojnë nivele të koncentru-

DETAJ

6-patëllxhanë
4-lugë gjelle
vaj ulliri
1-qepë e madhe
e grirë në rende
5-6 thelpinj
hudhra
3-4 kokrra
piper jeshil
Piper të kuq ose
spec (sipas
dëshirës)
1-dorë majdanos
të grirë
4-domate te
medha te grira
mire dhe pa
farëza dhe
lëkurë
1-lugë kafeje
kanellë
Gjysem deri 1
lugë caji sheqer
Gjysem kokrrë
limon të
shtrydhur



ar oksalate në trup duke u kristalizuar, gjë që sjell probleme të caktuara të kujdesit shëndetësor.

PËRGATITJA

Filloni të ngrohni furrën me ventilim në temperaturë 190 gradë C. Pritni secilën prej patëllxhanëve në gjysma. Hiqini pjesën e tullit dhe lërin patëllxhanët si zgavra. Vendosini në një enë me ujë të përveçuar dhe lërin në valë për 5 minuta. Mëpas hiqini nga uji dhe lërin të kullojnë përmbys. Tulin e tyre priteni në copëza të vogla. Në një tigan me bazë të gjerë hidhni vajin e ullirit, qepën, të cilën do ta zverdhi pak, më pas shtoni zemrat e copëtuara të patëllxhanit dhe vazhdoni tiganisjen derisa të shterojë uji që ato nxjerrin. Shtoni thelbet e hudhrave, domatet e grira, piperin jeshil ne kokrra dhe specin djegës, së fundmi kanellën dhe majdanosin e grirë dhe lërin të gatohen dhe për 5 minuta të tjerë. Hiqini nga zjarri dhe vendosini mënjandë duke i shtuar lëngun e limonit dhe sheqerin. Mbushini "varkat" prej patëllxhani me "harxhën" e gatuar. Pjesën e mbetur e shtroni në tavën ku do të shtini patëllxhanet. Mubulojeni me letër alumini dhe pëqini për gati 30 minuta. Shërbejeni të vakët.



Patëllxhani

Sekrete me "shije"



Patëllxhani kur blihet, mund të rruhet mire në frigorifer për pothuajse një javë, padyshim pa hequr bishtin i cili e mban gjatë të freskët. Përpara se t'i gatuar, pritini në format që i dëshiron gataja që do përgatisni, vendosini në një kullësë, shtojni kripë, mbulojeni me pjatë përmbys dhe vendosini një peshe. Lërin për 2 orë. I gjithë lëngu i hidhur do të kullojë dhe do të kenë një shije më të mirë. Konsumoheni sa më shumë në muajt e verës, pasi kjo periudhë nxjerr në pah gjithë vlerat dhe mirësitë e tij. Imam Bajëlidi (sipas mënyrës sime)

PATËLLXHANI fibra dhe elegancë në tryezën tuaj. Disa këshilla për të shfrytëzuar vlerat ushqyese të këtij zarzavati

PROGRAMACIONET E FILM TV

SOT

TOPCHANNEL

20:00 Emisioni "Fiks Fare"

20:50 "Kthim në parajsë" film

KLAN

20:05 Provat e krimt pj 13

21:00 Emisioni "Zonë e lirë"

VIZION+

19:55 "Jetë e dyfishtë" pj.104

21:00 Emisioni "Debat"

DIGITALB

21:15 "Përtej kufijve" Dramë

21:00 "Doktori nga perëndimi" Aksion

E SHUTURË

TOPCHANNEL

19:45 Emisioni "Pop Channel"

20:45 "Post Big Brother 5"

KLAN

20:05 "Prova e krimt" pj 14

20:50 "Ezel" pj 89,90

VIZION+

20:00 "Mos e beso po deshe"

21:00 "Histori Dashurie"

DIGITALB

21:00 "Rrezik i hapur" Aksion

21:30 "10 ditë për të larguar 1 djallë" komedi

E DIEL

TOPCHANNEL

20:05 "Exclusive" Dokumentar

20:45 Top fest 9 finale

KLAN

20:10 "Anatomia e Greit" pj. 109

21:00 X Factor Albania

VIZION+

19:45 "Dancing with the stars" forum

20:45 "Sketch show"

DIGITALB

21:00 "Dashuria ilaci më i mirë" Hits

23:00 "Fqinj im vrasës" Komedi

Këshilla

Truke të thjeshta për tu ndjerë mirë

REDUKTO STRESIN!

Për të reduktuar stresi gjatë punës, mjafton një truk i vogël: shmangni kontrollin e email mentre svolgi atre mansonit. Riducendo il numero di attività svolte contemporaneamente diminuirà anche il livello di stress.

GJIMNASTIKA NË UDHËTIM!

Udhëtimet e gjata në avion krijojnë probleme me këmbët. Por disa ushtrime të thjeshta ju lehtësojnë:

kontraktë pulpat 4 ose 5 herë njëra pas tjetrës. Lëviz këmbët në kahun e orës dhe kahun antior

CLODINI SYT!



Pas një dite të gjatë në kompiuter mund të lehtësoni sytë tuaj me një ushtrim shumë të thjeshtë: fërkoni pëllëmbët e duarve me shpejtësi që të nxehen, vërin pëllëmbët mbi qepallat e mbyllura dhe për disa minuta përkulni kokën përpara, nxehtësia dhe errësira do të clodhin sytë

tuaj.

NJOLLA QË FRIKËSON!

Mos lejoni që një njollë në këmishën apo bluzën tuaj të preferuar t'ju prishë ditën, sidomos kur bëhet fjalë për një njollë kafeje. Mund ta heqësh fare lehtë nëse i hedh pak ujë me gaz.

CIURO MENDJEN!

Dëshiron të përmirësosh gjumin? Para se të flini shkruani të gjitha shqetësimet tuaja në një fletore. Jko do të clirojë mendjen tuaj dhe do të pushoni më mirë.

Vila 12

Cdo të premte Lounge Bar, me grime 200L Lounge Drink, **Cdo të shtunë** Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela

Cdo ditë një menu e pasur me gatime shqiptare dhe italiane.

Cdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shqiptare, dhe një pije.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

RRUGA "MUSTAFA MATOHITI", PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA

Cel. 0696070651

Dëshiron të qëndrosh në shtëpi?

KËSHILLA për t'u orientuar në vizionin mbi arredimin e shtëpisë, nga restauruesja dhe arreduesja italiane Marina Daneri

NGA MARINA DANERI


Filluam shkrimet tona mbi arredimin, duke folur për feng shui, disiplinën mijëvjeçare, qëllimi i së cilës është arritja e harmonisë së brendshme dhe të jashtme të njeriut me ambientin, në një lojë reciproke ndërveprimesh energjie, të kushtëzuara edhe nga ambiente të arëduara në mënyrë të shëndetshme dhe të rehatshme. Pastaj folëm për "lojën" e riciklimit të materialeve të destinuara për t'u shkatërruar, që jo vetëm josh bricoleur dhe të pasionuar pas atyre që bëjnë gjërat vetë, por edhe arreduesit. Ç'mund të themi për karriken e stiluar nga rekuperimi i xhinseve që sapo ka dalë në treg? Janë lëvizje dhe reagime që vijnë nga një kriizë botërore ekonomike por që mbeten stimuj pozitivë dhe krijues. Pra të flasësh për arredimi sot, do të thotë të nisësh nga vëzhgimi i ndryshimeve të shoqërisë sonë dhe në të njëjtën kohë të prekësh një temë tepër të ndjeshme dhe "intime": shtëpia jonë, mënyra sesi jetojmë dhe sesi ajo na pret. Me këtë shpjegohet edhe suksesi i shumë formateve televizive që i kushtohen arredimit dhe në shumë vende të botës. Parullat? "Rinovojmë së bashku shtëpitë tona". Mund të gjejmë sugjerime të cmuara dhe ide për ristrukturimin e ambientit, përmirësimin e mobiljeve ose thjesht të plotësojmë dëshirën tonë për të ndërruar arredimin. Mund të flasim për objekte, si

Arredimi i shtëpisë sonë nuk do të thotë vetëm krijimi i një ambienti që na pret me ngrohtësi, por edhe plazmimi i ambientit tonë duke e bërë të dallueshëm dhe të njohur së pari për ne dhe pastaj për të tjerët

të dobishme ashtu edhe dekoruese, për cohat dhe ndriçimin si dhe gjithçka që e bën funksionale ambientin ku jetojmë. Shtëpia bëhet në këtë mënyrë një organizëm i vërtetë, kujdesi për të cilën është i lidhur

Si të arredosh me harmoni shtëpinë!

Si të trajtojmë dhe zgjedhim mobiljet



Efekti vintage

Në foto tregohet sesi një qoshe e errët dhome, ndoshta dhe e pashfrytëzuar është shndërruar në një kënd plot dritë dhe fantazi. Mund shihen qartë shkrirjet e stileve, një tualet i vjetër i dekoruar sipas stilit shabby chic, objekte etnike, një pikturë moderne në mur dhe ngjyra në harmoni...në tokë një tapet që mund të jetë edhe ike! Në këtë rast efekti vintage është i siguruar dhe kjo me fare pak shpenzimeve (gjithmonë nëse nuk është një pikturë origjinale apo për të tepër një Picasso original!

mobiljeve. Duke u informuar dhe duke mësuar që të njohim se çfarë na pëlqen dhe na duhet, duke kultivuar shijen personale me krijimin e një 'atmosfera shtëpie, fitohet padyshim një kënaqësi më vete. Oferta në treg, favorizon maksimumin e lirisë të frymëzimit, duke na orientuar drejt stileve të ndryshme, me prejardhje dhe epoka të larmishme. Ajo që ka rëndësi në këtë proces është dozimi dhe harmonizimi.

Kush pëlqen shijen paksa 'retro' të objekteve që janë pjesë e historisë së dizajnit mund të kërkojë për objekte origjinale, por të modernizuara të shekullit njëzet. Të pasionuarit pas vintage do të zgjedhin objekte jashtë serisë, por të një cilësie të mirë dhe linja që evokojnë një periudhë kohë të së shkuarës: elektroshtëpiake ndoshta jo më funksionale por të bukura dhe të firmuara. Nostaljikët e kohëve apo stileve të jetës mund të zgjedhin baulet e vjetra,

ngushtë me ne dhe ndjenjat tona. Në këtë kuptim arredimi i shtëpisë sonë nuk do të thotë vetëm krijimi i një ambienti që na pret me ngrohtësi, por edhe plazmimi i ambientit tonë duke e bërë të dallueshëm dhe të

njohur së pari për ne dhe pastaj për të tjerët. Kontributi i arreduesit, interior designer, është i cmuar dhe i pazëvendësueshëm, por të gjithë ne prefojmë të bëjmë sipas shijeve tona në zgjedhjen e ngjyrave apo

valixhet e lëkurës, ndoshta të vjetëruara por të mbushura plot me shenja që kujtojnë udhëtime të gjata.

Nëse ju pëlqen stili vintage, por nuk doni që të hiqni dorë nga prakticiteti, mund të blihen objekte të vjetra që ëkanë hyrë në historinë e dizajnit, por të rinovuara sipas teknologjive më të fundit. Televizorë, radio, impiantë stereo.

Kush nuk dëshiron efektin e vjetërsisë false, por kërkon pamjen e cmuar të antikes do të preferojë të shtojë ndonjë pjesë antikuari. Do të zgjedhë mobilje dhe objekte të krijuara jo përtej 800-ës, nga ebanisti, apo artistë-artizanë. Por të flasësh për antikuaret do të thotë të hapësh një kapitull të ri dhe të madh. Mjafton të them për momentin që zgjedhja e një mobiljeje të vjetër do të thotë distancim nga mobiljet e realizuara në seri, sigurisht që funksionale dhe mjaft elegante, por të kufizuara në vlerë artistike për shkak të riprodhimit të saj. Në të kundërt mobiljet antike, shpesh të krijuara për të pasuruar ambiente luksoze, përmbajnë një unicitet që trashëgohet brez pas brezi, shtëpi pas shtëpie dhe dorë pas dore. Por sot preferohet shumë që të bashkohet modernja me antiken sidomos në rast se kombinimi bëhet me shije, në lojën me epoka të ndryshme jo vetëm që mobilja antike do të ruajë individualitetin e vet, por edhe atmosfera që do të krijojë do të jetë "pa kohë". Natyrisht që një mobilje antike, ndoshta e cmuar duhet trajtuar me dashuri! Duke u kujdesur për mobiljet tona, do të mundemi jo vetëm të gjallërojmë ose të rrisim bukurinë apo vlerën e tyre, por edhe t'i mbajmë funksionale dhe të dobishme. Gjithashtu mësojmë që t'i njohim dhe zbulojmë gjëra të reja, mbi mënyrat e dikurshme të jetuarit, ose mbi historinë e zakoneve të një vendi për të cilin është menduar një mobilje e caktuar. Së fundi duke përdorur për mirëmbajtjen e tyre, produkte të përshtatshme me materialin që kanë, natyralë dhe ekologjikë 100 për 100, do të garantojmë harmoni për shtëpinë tonë e do të tregojmë edhe njëherë vëmendje e ndjeshmëri për ambientin.

Libri

Pipa Li në kërkim të jetëve të parrëfyera

Çfarë pjesë të jetës sonë fshëhim, kur duam të krijojmë një jetë të qëndrueshme e të suksesshme prej të rrituri?

Pipa Li kishte pikërisht një jetë të tillë në moshën 50-vjeçare, kur i shoqi, më i madh se ajo, një botues në pension, vendosi se duhej të shkonin në një shtëpi të moshuarish jashtë Nju-Jork Sittit. Befas, Pipa gjendet e kapur në grackën e asaj që

e kishte ndërtuar vetë në mënyrë të gënjeshtërt. Fillon të humbasë mendjen dhe ajo çka kishte ndryrë në vetvete, fillon të tronditet. Hap pas hapi, ne fillojmë të marrim vesh të vërtetën e jetës së saj në rini dhe se si kjo e çoi deri në martesë – vite rebelimi dhe mospranimi, thyerje tabush dhe sfida të fuqishme.

"Jetët e parrëfyera të Pipa Lisë" është hulumtimi për një grua të zon-

jën, kureshtare dhe që vështrohet në shumë pamje – një portretizim tepër inteligjent i shumë jetëve përtej një emri të vetëm. Kjo është historia e romanit më të fundit të shkrimtares Rebecca Miller. Kritika vëren se...

Përshkrimi që i ka bërë Miller personazhit kryesor është aq i hollësishëm dhe i vizatuar me dashuri, sa është e pamundur të mos zhytesh tërësisht në të." Gjithashtu Miller spikat për rrëfimin e mrekullueshëm të një gruaje amerikane në kërkim të lumturisë. Gazeta britanike "The Observer" shkruan: "Miller është një shkrimtare e mrekullueshme. Hulumtimi brenda jetëve të parrëfyera të Pipas është njëllloj sikur të hapësh një seri matrioshkash ruse, ku çdonjëra prej tyre rrëfen një histori më vete." Romani vjen në shqip nga Anxhela Cikopano.



Personazhi i javës

ROVENA RROZHANI

vijon nga faqja 13

...Do të thoja që është thjesht një dëshirë e mirë për t'i parë gjërat me dashuri, që jo shpesh ndodh.... Kur i shoh kështu, është si të bësh një sy qorr dhe një vesh shurdh, që prapë nuk është shumë mire sepse qdokush duhet të ketë një opinion, një kritikë konstruktive. Pastaj është familja, njerëzit që ke lënë, këtu, janë shokët, miqtë. Nuk më ushqen ndonjë gjë e piketuar. E di që kthehem prapë tek ai malli që kanë njerëzit kur jetojnë jashtë, por unë do ta vija më shumë peshën tek dashuria, tek çështjet e zemrës, tek ato gjëra që të lidhin, që i ke lënë këtu përreth. Mund të jetë një mik, mund të jetë një vend, mund të jetë një varr, mund të jetë një gur, mund të jetë një dashuri e humbur.. nuk e di...Këto gjëra më ngacmojnë, më bëjnë që të kthehem me dëshirë dhe ta kërkoj e ta gjej edhe atë ekuilibër që kam.

Ja përshembull dita e djeshme më ngacmoi shumë. Ju e dini që këtu kam varrin e vëllait dhe të babait. Vëllai është vrarë në mënyrë shumë dramatike, teksa kalonte kufirin gjatë diktaturës. Shkova dhe pashë që rreth varrit ishte rritur shumë gjelbërimi. Fëmijët përreth kërkonin lekë apo bonbone. Njëri prej tyre kishte një sqepar në dorë. Futa dorën në xhep. I dhashë ca para dhe mora sqeparin dhe fillova të pastroj. Mund të kem ndenjur të paktën një orë, duke pastruar dhe duke folur me tim vëlla. Ai ka qenë piktor. Ç'ndodhi me mua? Fillova ndiej ajër dhe mu mbushen mushkëritë plot.... Nganjëherë më duket vetja si shumë mëkatarë dhe kur shkoj në varrezë tek im atë apo vëllai, më ndodh që kur laj varrin ose kur heq barin apo kur i qaj hallet, lehtësohem. Thjesht idea që një shpirt gjendet aty, më duket sikur më lan mëkatet. ... Kjo më ndihmon dhe kjo është ajo pika kur them: "Hej kthehem edhe për këtë! Kthehem edhe për shkuar aty, për të larë mëkatën, për të folur me ta, për t'i takuar!". Kur shko-va tek im atë pak metra më sipër, më ndodhi një tjetër gjë interesante. Personi që më shoqëronte më tha që duhet t'i ndizja një cigare ashtu siç bën gjithmonë nëna ime.

Unë nuk e pi cigaren, nuk e kam futur asnjëherë në gojë, nuk e kam mbajtur as në gisht, ndërsa babai im e ka pirë gjithmonë... Më dha çakmakun dhe e ndeza. Ia vura mirë varr dhe ajo që filloi të digjej aq mirë dhe mendja më thoshte: "Sa i pihet tani babait një cigare!" Dielli hinte, cigarja digjej dhe unë isha në kujtim. Në atë pikë pata paqe me veten.

Në këto momente vjen frymëzim për të krijuar?

Larjen nuk e lidh me frymëzimin, nuk e lidh me spuntun që mund të më japë ajo situatë, thjesht ndihem në paqe me veten.

Eda Zari: Shqipëria dhimbje e bukur

Rrëfim për turneun dhe të afërmit



Ndihem mirë, rehatshëm, kurse nëse do t'i hidheshim atyre gjërave që më ngacmojnë, kjo ndodh gjithmonë kur jam në fazë të zezë, në sketerrë e sipër dhe jam në një tunel...., aty fillon pjesa krijuese. Në fazën rozë, ku jam në qiell të shtatë, nuk dua të di kë kam përreth dhe nuk krijoj, sepse nuk më bëhet të krijoj. Në këtë fazë jam njeriu më pak kreativ dhe më pasiv. Ndonjëherë i gëzohem edhe asaj që është diell, por në në koshicë i gëzohem edhe anës së errët. Nuk e detyroj veten të futem tek ai tuneli që të jem më kreativ. Çdo gjë vjen vetë dhe ajo më jep dëshirën për të krijuar. Aty e kam substancën dhe jo tek lumturia. Atë e shijoj, i ngazëllem, e jetoj. Nuk zgjat shumë, mund të jetë një orë, dy orë, mund të jetë një ditë maksimumi. Pastaj ajo qetësia me shpirtin dhe sadisfaksioni është e vazhdueshme.

Toka Inognita, është një album i gëzueshëm në fakt.

"Toka Incognita" nuk ka të bëjë me anën e zezë. Ka qenë një kreativitet më shumë muzikal, më shumë inspirues, ngacmues. Është ardhja këtu që nuk të ballafaqon vetëm të ngrenin etë pirin, por edhe me një kulinaritet që është muzika. Ajo jeton në shtëpinë time, është pjesë e familjes sime dhe më rrethon. Hyj aty në atë pellg, lahem, shpilahem,

marr ç'kam për të marrë, dal...Idea ishte për ta bërë një album me të cilin unë gjithmonë derisa të shkojë jeta ime, të di ku të identifikohem, të kënaqem, të mos mbyll sytë e të them: "Të lutem, mos ma vër atë se ka qenë një fazë katastrofale e imja!", por ta dëgjoj me dëshirë. Edhe ata njerëz që e dëgjojnë sikur dhe dy vetë të ndiejnë që ka sineritet, që është muzikë që nuk gënjën dhe që ajo lloj muzike ka nivel shumë pretendues muzikor, një nivel të caktuar që publiku që nuk e dëgjon duke pirë kafe, por ulet dhe preokupohet.

KËNGËTARJA e njohur shqiptare në një rrëfim mbi përjetimet e saj në vendlindje, frymëzimin, pasionin dhe raportin e saj me folkun

Për folkun

Këngëve të albumit të saj të ri, preferon ndonjëherë tu vërë nëntitull. "O shpirt sa të du" këngëtarja ua rekomandon atyre që duan të thonë fjalët më të thella të shpirtit. Ndërsa "Kroi" lasgushian është skena më interesante ku mund të njihen në mënyrë shumë të singertë mashkullit e femra. Por jo vetëm. Histori misterioze rrjedhin bashkë me ujin, simbol i pastërtisë që dhuron paqe. E preferuar për Edën është kënga "Zymbylat" ose tabloja më e bukur e të thënit "Të dua". Këtu biseda shkon drejt raportit artistë-folk. Eda këndon nën zë pjesë nga "Zymbylat" dhe komenton: "Të mendosh që është thjesht një tekst popullor që në shumicën e rasteve quhet këngë ahengu. Por ajo është kaq klasike, elegante ...". Ajo do të donte që artistët e rinj të merrim më shumë nga arti popullor, por sërish nuk i pëlqen të gjykojë... "Nëse do të flisnim nga fokusi im, çfarëdo që të jetë folk i pashkruar, nëse ti e sjell në një frymë të sa më të singertë dhe të përshtatshme për dëgjuesin e ri, unë mendoj se njerëz të janë mirënjohës" thotë ajo. Nuk e quan veten misionare të këtij vizioni, por thekson "...mendoj se gjithsekushi nga ne po të bente një punë të singertë, të ruante këtë estetikën dhe elegancën e folkut do të bente një punë shumë të këndshme".

Thuhet që albumi është një martesë mes xhazit dhe isopolifonisë. Ka funksionuar kjo martesë?

Po. Është një martesë, madje jo vetëm, por që në fillesat e para ka pasur një pllenim të jashtëzakonshëm. I jemi dedikuar motiveve që janë të marra nga isopolifonia shqiptare, muzika keltike dhe I kemi përpunuar duke mos ia hequr apo shtuar vlerat, por vetëm për t'ia treguar ato. Krahas kësaj kemi vënë identitetin tim tjetër muzikor që është xhaz. E gjithë substanca përreth është shumë unike dhe të paktën nga jehona që ka patur, albumi cilësuar sa autentik aq dhe unik. Si duket ka qenë edhe pjekja e mirë muzikale, për t'ihënë më shumë strukturë këngëve e për ta bërë më të përshtatshme edhe për një të huaj që e dëgjon dhe nuk i kupton fjalët. Ka

qenë goxha mirë. Kemi bërë një gjë që ka këmbë e këpuçë bashkë.

Si po shkon turi?

Kemi patur dy koncerte në Tel Aviv, kurse në Kinë kemi dhënë koncert në Operan e Shangait. Një mrekulli që më inspiroi. Më ka bërë përshtypje disiplina e atyre njerëzve dhe reagimi i tyre. Kënga "O shpirt sa të du", një baladë që unë e kam trajtuar në një tjetër formë tek njerëzit shkonte këndshëm edhe pse nuk i kuptonin fjalët dhe thitthej. Turi vazhdon. Kemi dhe disa plane për këtu në Shqipëri. Pastaj do të vazhdojmë në vendet baltike, pastaj prapë në Gjermani, Austri, Zvicër.

Përveç skenës të shijojnë shumë edhe udhëtimet...

I shijoj edhe nëpërmjet fokusit të kameras. Kam pesë vjet që merrem me fotografi. E kam hobi që po bëhet serioz. Para ose pas provave kam kohë të fokusoj, sidomos gjërat e vjetra. Nuk e di pse jam kaq e fiksuar pas tyre. Mund të jetë një mur, mund të jetë një histori, një person, që ka një pamje të caktuar që më inspiro. Nuk ka pse të jetë spektakolare. Kam disa albume, dhe i bëj me shumë dëshirë madje kam filluar të merrem edhe me printime sa që shumë njerëz më thonë, ti po merresh me muzikë apo me fotografimin.

Cilin nga vendet ke fiksuar më tepër...

Brazilin. Ndoshta nga diversiteti që ka vendi, aty ku mendon që është parajsja po aq afër është edhe ferri. Po ashtu edhe në Shangai, ferri ishte në një tjetër formë sepse kishte një lloj lirie fjale, dhe e gjitha kjo lë strukturë brenda meje. Detti i Vdekur është një gjendje tjetër, kur fillon të trillosh, dhe bëhesh dhimbje me të. Kurse Shqipëria është dhimbje, dhimbje e pritje nga unë... Mbetet dhimbje. Jam në një dilemë që nuk di çfarë emri t'i vë. Nuk e përcaktoj dot se çfarë kam. Gjithmonë kur vij këtu më kap një mall, I pakuptueshëm... pastaj vë re ritmet e ndryshme. Aty ku ecet shpejt, është edhe një ritëm i ngadalë dhe kjo ma prish atë balancën dhe më shkakton një dhimbje që do t'ia lë kohës për ta kuptuar. Unë kam pasur një dajë dhe ai thoshte se "Është art kur vjen në një moment të jetës dhe zbulon bukurinë e dhimbjes". Nuk e di, unë mendoj se e kam zbuluar atë. Ja ta krahasoj me shkuarjen time tek varri. Është dhimbje e tëra, krijohet tablo e një femre që ka përjetuar shumë gjëra, humbje, një personi që është shumë e fortë, por edhe një nënë me fëmijë, dhe e shikon duke pastruar dhe duke folur me veten. Ajo është bukur e atij momenti sepse ti shprehesh, sepse ti e xhërdhë, si ajo pulvora që e pasi e bën pe, fillon ta bësh një triko tjetër. Kur e përjeton, je më e qartë, më e kthjellët. Më ndihmon për të bërë diçka më të bukur rreth vetes, jetës sime, personit tim, për tu qartësuar në cepat e trurit tim.

unë isha pjesë e delegacionit. U bë goxha punë, por prapë unë i mbetem idesë që ai nuk është festival që të prezanthesh si këngëtar, si artist, si kompozitor.



Festa e 1 qershorit

Të jetosh si fëmijë

Rigjetja e fëmijërisë së munguar, ndërsa blinte lodra për nipin

■ ■ ■ TIRANE

Jeton çdo ditë me fëmijërinë e saj. Ajo ka ndërtuar një strehë të përhershme ku koha nuk hyn dot. Një teatër jetësor, tjetër nga ky që luhet çdo ditë para syve tanë. Një botë metafizike: Botën e lodrave. Denisa e jeton këtë botë me një pasion të çuditshëm, të ndryshëm nga gazetaria dhe nga të tjera pasione të saj.

"Shpesh, me kureshtje pyes fëmijë në moshë të ndryshme, se kur kanë luajtur për herë të fundit me një lodër dhe dëgjoj me keqardhje se aty rreth moshës 7-vjeçare pushojnë së luajturi si fëmijë", thotë Denisa. Për të, të luash do të thotë shumë gjëra njëherësh: Do të thotë të rritsh, të sendërtosh realitetet të tjera më të mira se ai që ekziston, të arrish të pamundurën. Mbi të gjitha është katarsis shpirtëror.

Kjo dashuri ishte një rizbulim që i ndodhi 7 vite më parë, kur nisi të blinte lodra për nipin e saj të parë të porsalinur. Dalgadalë vuri re se blerja e lodrave u kthye në një argëtim edhe për atë vetë. Madje, pikasi se kjo ishte një botë e munguar për të, por shumë e dëshiruar. "Nga fëmijëria ime nuk mbaja mend asnjë lodër për të qenë. Ishte kohë krize, - kujtoj ajo. - Me kulla nuk kisha luajtur asnjëherë, ndoshta ngaqë nuk kisha patur ndonjë kukull që të lëvizte sytë, duart, këmbët, të kish të garderoibë, krevat, shtëpi, ballkon me lule, tryezë kuzhine e sobë. Një herë kujtoj që prindëru u ra në pako një revolver, edhe ai statik (e ç'mund të bësh me një send të thatë!), ndërsa lodra më e bukur që e ruaj ende është një telefon që më ra në pakon e Mbrëmjes Qendrore të Nxënësve..."

Fëmijëria ime ishte një përçapje e vazhdueshme për të plotësuar boshllëkun e argëtimeve që mungonin. Kujtoj se si përpigësja të sajoda lodra vetë dhe isha vazhdimisht në kërkim. Edhe pasi shoqet e mia shkonin në shtëpi, unë vazhdoja të luaja për të "shpikur" të reja për të nesërmen. Ishin lojëra dinamike, teatrore, figura cirku, prosta, gurmac, letra, "mos u nxeh"... variante më të ndërlikuara se ato që njiheshin, por që shpejt bëheshin pronë e të gjithë fëmijëve të lagjes. Pas vitesh, kur shihja vëllezër e motra më të vogla të shoqeve të fëmijërisë, të luanin "shpikjet" e mia, vija buzën në gas. Ishte një kënaqësi që mund ta njohin disa njerëz.

KËNAQËSIA E KRIJIMIT

Ndonjëherë hidhet nga krevati për-pjetë me një ide të re, që nuk e kishte bërë më parë. "Më pëlqen se ka variacione të pafundme, -thotë kolegia jonë.- Këto lloj lojërash të bëjnë të ndihesh pak si shkencëtare, pak si artiste, domethënësi të karakteristika të hulumtimit fëmijor. Zbavitja shtohet bashkë me shkallën e vështirësisë, pasi janë lodra pa skema orientuese, janë blerë pjesë-pjesë hedhur rrëmujshëm në tregun e gabit, pjesëza pa emër, të cilave duhet t'u gjeje ose ricalktoje funksione. Por pjesën më të madhe të këtyre rraqeve i kam marrë me karrocën e romëve për t'i sjellë në shtëpi. Ishin dy kuti shumë të mëdha. E t'ju them të drejtën, per-



Denisa Kona duke treguar lodrat e mbledhura vitet e fundit

sonazh surreal më dukej vetja e hipur në një karrocë kuajsh".


DO JEM KONSTRUKTORE LODRASH NË NJË VEND INDUSTRIAL!

Ferma, kështjellat, qyteti i bletëve, qyteti i lodrave, qyteti i trenave... Denisa tregon se preferon pikërisht këto lodra që përbëhen nga qindra e qindra detaje dhe që me të cilat mund të ndërtohet ansamble. Fantazia e kapërcen gjithnjë realizimin. Me mendje kërkon të tjera funksione, po të kishte mundësi do t'u sugjeronte fabrikuesve të këtyre seteve firmato, gjëra të reja. Sikur të kishte lindur në një vend tjetër, ndoshta ajo mund të ishte bërë një konstruktore lodrash. "Do të merrja njëherësh dy kënaqësi: kënaqësinë e vetë procesit të krijimit dhe kënaqësinë e zbavitjes së fëmijëve... 18 vjeçe, sapo kisha nisur jetën studen-

tere. Ju duket e çuditshme po t'ju them se krahas përfytyrimeve për dashurinë, kisha edhe të tjera përfytyrime? Në atë kohë fantazoja skulptura druri dhe objektet ishin tre: Kali, pema dhe trupi i njeriut. Befasia ime ishin fjalët e një të njohuri skulptor që tha se këto ishin objektet estetike të artit, tri linjat e bukurisë. Mirëpo kali... pema... arushi... atavizmat më çonin mendjen në një botë përrallash. Figurat e përrallave të re-vistave të dikurshme, nisa t'i ndërtoj me mendje tredimensionalisht. Gjeja vështirësi në realizimin teknik si përshembull, çfarë duhet të kishte çikrku të kalonte në pemë, si t'i bëja të lëvizshme degët dhe çatinë prej kashte sikur fryn era, me çfarë materiali ta bëja lumin dhe ku t'i bëja burimin etj. Por këto mbetën fantazi në erë...fantazi boshe por sport për mendjen.

Festa e fëmijëve

Rudina...duke pritur 1 Qershorin



Rudina Magjistari duke treguar tatuazhin në Facebook

Duke pritur 1 qershorin! Kështu e titullon trion e fotove bukurshja e spektakleve, Rudina Magjistari. Nuk ka arritur ta fshehtë tundimin për të qenë pak fëmijore, pas-ditë e djeshme kur hodhi në profilin e saj në "Facebook", tre foto me të njëjtën "vulë" fëmijore: Një tatuazh ngjyës në tëmthin e djathtë, dy lule me kërcell jeshil dhe me petale bojë-qielli dhe vjollcë. Rudina duket shumë e ngazëllyer nga tatuazhi dhe merr komente lavdëruese për look-un, por jo për tatuazhin dhe moton e vënë për 1 qershorin, festën e fëmijëve.



KOMENT

NGA ELJAN TANINI

Qyteti ku fëmijët kanë harruar të luajnë!

vijon nga faqja 1

...Nuk shoh më fëmijë të luajnë. Kanë harruar lojrat apo nuk ka më fëmijë në lagjet tona? Ndoshta nuk ka më topa apo litarë për të kërcyer!

Duket sikur nuk ka më fëmijë që luajnë bashkë: djem dhe vajza që pastrojnë oborrin e pallatit! Çuna që gjuajnë me llastiqe për të ngrënë kumuri (dhe ndonjë gjyshe që i pjek ato në sobë) apo për të thyer xhamat e zonjës Va. Vajza që luajnë shtëpirash, mamash apo babash, të tjerë që luajnë komand-komand, syllambyllja e topadjes-si! A ndahen përsëri për të shtirë teksobici apo edhe doçekanoçe? Po me tapacka nga shkalla në shkallë me kapak kavanozi? A ulen përsëri në shkallët e pallatit, dhe të dalë ndonjë zonjë Pa për t'i larguar, duke i hedhur ujë ose me fshesë në dorë se gojia po del për të pastruar shkallën? Ku janë vajzat e vogla që mbledhen për të bërë ushqimin e kukullës? Përse brezi im ka luajtur dhe tani jo më?

A e bëjnë ende vajzat "MISS-in" e pallatit e të lagjes? Ende shijnë lekë për të blerë dhuratën e "MISS-it"? Po juria ku është? Gratë e pallatit, përse nuk dalin në dritaret e shkallëve a ballkone për të parë sfilatën?! Djemtë, a zihen më me fjalë të pista, a cahen nëpër këmbë, duke hipur në garazhe poshtë lagjes a në pisha, a shkojnë nga liqeni për të kapur peshk e për t'u larë? (Se mu kujtua); të gjithë laheshin në liqen, unë jo, se më vinte ndot nga era e ujit, por ndonjëherë me dhunë edhe jam larë për hatër te grupit! Nuk ka më liqen, por as pemë me pisha poshtë pallateve!

Po ata që bëjnë karroca me kuzhineta! A gjen ndonjë burrë moshe që shet gjela dhe mollë të pjekura me sheqer? Ka lëpirëse, por a ka fëmijë, të cilët kur shohin njëri-tjetrin që po ha fara luledielli shkojnë të blejnë edhe ata! Ndoshta unë nuk shoh të ketë, por të gjithë po kthehen në legjendë urbane. Harrova, të paktën festojnë edhe 1 Qershorin. Flas si një fëmijë për qytetin e tij, atje ku gjunjët gërvisheshin dhe qaheshin mbi garazhet e rreshtuara para pallatit, aq sa urinoja mbi gjunjë që të piqej lëkura, aty ku pëlqejta të hidhesha prej tyre në rrëzë; apo të luanim në trotuare, duke vënë në lojë këdo.

Nuk harroj edhe atë shprehjen time: "Shteta, më fal sa është ora?" Unë nuk dua aspak të them se ishim ne fëmijët që luanim, duke bërë qejf, por të nënvizoj se s'po shoh aspak fëmijë të tjerë të luajnë poshtë pallateve! Për çfarë mendojnë fëmijët e sotëm? Ku janë? A luajnë më dhe? Ose hedhja në lojë e kalimtarëve të trotuarit kundrejt kalimit të një teli imagjinari, këtë të fundit e zëvendësojnë shumë mirë hija e shtyllës së ndricimit! Apo hedhje sendesh të leshta në këmbët e kalimtarëve si minj imagjinari... Sa andej këtej syllambyllësi me doçekanoçe, dallëndyshe të zezë nga ato të mëdhatë, që fluturojnë vegimthi në ikje drejt perëndimit!

*P.S. Qëllimi i këtij shkrimi është të kujtoj lojën e fëmijërisë



Reportazhi

LUSHNJE

DHURATA HAMZAI

Me krenari ne themi sot se qyteti ynë është qyteti i Festivalit të Valles Burimore, i Vaçe Zelës së pavdekshme, i Vath Koreshit: shkrimtarit të kabasë së gëzimit dhe hidhërimit, i Margarita Xhepës: Ofelisë shqiptare, i Pavlinës, i Ilias... Dhe vargu i njerëzve të artit dhe kulturës nuk mbaron, se kjo tokë prodhon art dhe kulturë", tha kryetari i Bashkisë z. Fatos Tushe në fjalën e mikpritjes së Festivalit Folklorik Tipologjik Ndërkombëtar të Valles Burimore që ka nisi në Lushnjë më 29 Maj. Festivali prej tri ditësh ka krijuar një atmosferë të ndezur në jetën kulturore të qytetit të Lushnjës. I organizuar nga Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare Folklorike dhe bashkia e qytetit, festivali ka ngjizur një traditë të bukur kulturore. Sheshi kryesor i qytetit është kthyer në një ansambël tërheqës, ku veç valltarëve dhe gjallërisë së qytetarëve syri të shihet pamje nga 5 edicionet e Festivalëve të shkuara dhe një ekspozitë të pasur të kostumeve popullore. "Kjo është një pasuri kombëtare që mjeshtrit e kostumografisë po e trashëgojnë brez pas brezi", pohon kryetari i Bashkisë, z. Fatos Tushe, i cili ka kontribuar me përkushtim të madh pranë stafit drejtues të Festivalit për të gjitha përgatitjet. Në natën e parë, vetë qyteti i Lushnjës çeli festivalin me grupin e parë përshëndetës. Më pas kanë nisur konkurrimi grupet e Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës dhe gjatë këtyre ditëve festivalit i janë bashkuar edhe 12 grupe pjesëmarrëse që vijnë nga jashtë Shqipërisë. Programi i festivalit është konceptuar me një gërshtim të aktiviteteve sportive të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare përgjatë gjithë javës që kulmojnë në mbrëmje me shfaqjet e grupeve folklorike të ardhura nga qytetet e tjera të Shqipërisë, si edhe nga vendet fqinje. Për grupet pjesëmarrëse janë organizuar vizita në Muzeun e Qytetit, në Shtëpinë Muzeu ku 92-vjet me parë u mboldh Kongresi Kombëtar i Lushnjës, kongresi që hodhi themelet e shtetit Shqiptar dhe të Parlamentarizmit Shqiptar. Janë bërë edhe vizita në Manastirin e Ardenicës ku heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu vuri kurorën me Donikën e Arvanitasve.

Fatos Tushe: "Lushnja është qyteti i Festivalit të Valles Burimore, i Vaçe Zelës së pavdekshme, i Vath Koreshit, i Margarita Xhepës: Ofelisë shqiptare, i Pavlinës, i Ilias..."



Kryetari i Bashkisë së Lushnjës Fatos Tushe

rrugët e qytetit, ku qytetarët zgjedhin kostumin më tërheqës.

"Janë emocione që nuk përshkruhen me fjalë ato që krijon këto ditë Festivali Tipologjik Ndërko-

mbëtar i Valles Burimore. Vallja Shqiptare ka shoqëruar jetën tonë në dasma e në ksothde, në fitore betejash dhe në fshikullime satirike të kohës", thotë z. Tushe. Ndër-

sa shton se "Vallja burimore mban gjallë dhe transmeton brez pas brezi traditën, zakonet dhe doket e kombit tonë, nga më të lashtët në rajon. Është ky folklor që mban gjallë bujarinë mikpritëse dhe respektin Lushnjarr për miqtë nga Turqia, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi dhe Kosova. Them Kosova sepse aty është kufiri ynë shpirtëror që jeton në paqe dhe në harmoni me popullin e tjerë fqinjë." Lushnja është sot qyteti me 6 gjerdanë festivaresh, është qyteti i dy kongreseve, i Kongresit të Shtetit Shqiptar dhe Kongresit të Parë Arsimit Shqiptar.

Sipas Tushës lushnjarrët thonë me krenari se në qytetin tonë u hodhën themelet e shtetit të ri shqiptar, u hodhën bazat e arsimit Shqiptar. Ndër të tjera ai thotë se: "Kjo tokë që Zoti e ka bekuar, ka fatin të jetë e pashtershme, të prodhojë, të transmetojë dhe të vërë në pedestalin e historisë Lushnjën, qytetin tonë të dashur, të ngrohtë që na fal të gjithëve aq shumë dashuri nga dielli që e ngroh dhe toka mbi të cilën ne jetojmë". Me këngën vallen dhe artin e mikpritjes ndriçohet edhe kujtesa kulturore-historike e Lushnjës në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë.



Festivali i Valles Burimore në Lushnjë

FESTIVALI: Tri ditët e zhvillimit të Festivalit të Valles Burimore në Lushnjë. Përgatitjet dhe mikpritja nga Kryetari i Bashkisë Fatos Tushe dhe organizatorët. Ndriçohet kujtesa kulturore-historike e Lushnjës në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë



Në foto: Festivali i Valles Burimore në Lushnjë

Lushnja hedh vallen popullore


Flet Kryetari i Bashkisë Fatos Tushe: Kjo tokë prodhon art dhe kulturë

Aktiviteti

Edicioni i 6-të i Festivalit Ndërkombëtar të Valles Burimore



Ky aktivitet është organizuar nga Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike dhe bashkia e qytetit të Lushnjës. Ai është kthyer në një traditë për qytetin e Lushnjës duke gjallëruar jetën kulturore të qytetit. Për tre net më radhë festivali ka ndezur atmosferën festive në rrugët e qytetit duke i dhënë një gjallëri të madhe që rrallë herë ka ndodhur ku qindra qytetarë mbushën sheshin kryesor të qytetit. Në edicionin e 6-të këtij festivali kanë marrë pjesë 12 grupe nga vendi dhe jashtë tij. Mbrëmjen e parë ishte qyteti i Lushnjës i cili hapi festivalin si grupi përshëndetës. Me pas nisi konkurrimi me grupet e Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës. Këtë vit harta e konkurseve është shtirë edhe jashtë Shqipërisë. Festivali do të zgjas tre ditë dhe ne të marrin pjesë si përshëndetës edhe grupe nga Greqia, Italia, Bullgaria etj.



ZBAVITJE

[SHQIPTARJA.com] nditëse

Gabimi i mjekut të shton jetën

Kur mjekët i bënë të ditur amerikanit Ed Furlong, i vetëm një homonim i aktorit të Terminator 2) nga Bostoni se sëmundja që ai kishte nuk i jepte më shumë se një vit jetë, atëherë mendoi se ishte më mirë për të që të shkëputej nga puna dhe vitin që i kishte mbetur ta kalonte duke bërë ç'të donte. Dhe në fakt ashtu bëri. I njoftoi eprorët e tij në shoqërinë ku kishte punuar për gati 40 vjet si logaritar se do të shkëputej nga puna dhe vendosi që kursimet t'i shpenzonte në garat e kuajve që ishte edhe pasioni i tij. Kështu pra filloi të vinte baste nëpër hipodrome të ndryshme, në pritje të ditës së fundit për t'u ndarë nga kjo botë. Mirëpo Ed Furlong kishte qenë vërtet njeri me fat, sepse jo vetëm që në bastet e hipizmit i eci shumë, duke fituar shuma të mëdha, por e ndjente se edhe me shëndetin kishte përmirësime të jashtëzakonshme. Ka kohë që i ka kaluar afati që i dhanë mjekët e ai, jo vetëm që nuk ka ndërmend të shkojë në botën tjetër, por tashmë me paratë e fituara nga bastet është bërë pronar i një stalle të madhe me kuaj race...



Vendos qetësinë për të prishur qetësinë

Aju ka qëlluar ndonjëherë të qëndroni, fjala vjen në plazh apo në vende të tjera publike të ndjeheni të bezdisur nga volume i lartë i radios së të tjerëve, sidomos kur nuk i ndani edhe shijet muzikore me ta? E kjo gjë i ndodhte shpesh edhe gjermanit Rudolf Rodel, një djalos që nuk i honpste dot të rinjtë e tjerë që ia shpifnin me volumin e radios të ngritur në kupë të qielit. Mirëpo Rodel është nga ata djemtë e zotë që nuk le gjë pa sajuar. Kështu, duke qenë se i jepet shumë edhe në fushën e elektronikës, vrau pak mendjen dhe sajoi një aparat të tillë, i cili është në gjendje t'u "kryejë gojën" fare të gjitha radiove që ndodhen në një reze të caktuar pranë tij. Vetëm kështu gjeti qetësinë dajaloshi Rodel, i cili merret reze i qetë, pa u bezdisur nga kafkonia e radiove të të tjerëve. Por gjeti edhe belanë. Sepse jo vetëm, që e zbuluan, por edhe e denoncuan. Dhe, çka është më keq akoma, sado paradoksale që mund të duket, gjykata e Hamburgut, ku u zhvillua procesi gjyqësor ndaj tij, e dënoi për "prishje të një shërbimi publik".



Emocione fatale

Kur, pas kërkesës për ndihmën e shpejtë, ia mbëriti ekipi mjekësor në shtëpinë e Thomas Turner, një gjeometër pensionist 74 vjeçar nga Colorado, pati kohë vetëm të konstatoje se ishte ishte tepër vonë, pasi trupi i pensionistit dergjej tashmë i pajetë me mes të dhomës. Mjeku përgjegjës pasi e vizitoi amrit në konkluzionin se të ndjerit Turner vdeka i kishte ardhur nga infarkti. Sipas mjekëve, infarkti kishte qenë shumë i fortë dhe ishte shkaktuar nga emocione të forta. Dhe në të vërtetë emocionet nuk i kishin munguar Turner-it të gjerë. Sepse, siç u mësuva më vonë nga të afërmit e tij, vetëm një ditë para se ta pësonte nga zemra kishte provuar dy emocione shumë të forta. Së pari, në mëngjesin e një dite më parë, pas shumë përpjekjesh kishte fituar divorcin me gruan e parë dhe menjëherë, pak orë më vonë sapa kishte vënë kurorë me gruan tjetër...



SUPER FJALEKRYQ

1	2	3	4	5	6	7	8			9		10		11		12		13	14	15	16	17	18	19		20	21	
22									23		24			25	26			27									28	
29									30					31	32		33					34				35		
36			37				38						39		40							41					42	
43							44												45	46	47							
48			49			50										51		52						53			54	
		55				56						57				58									59	60		
	61		62	63			64			65				66		67						68	69		70			
71							72					73			74	75						76		77				
78							79		80			81		82				83	84		85			86			87	
88							89				90	91		92				93						94			95	
96							97				98							99								100		

■ HORIZONTAL

- Sandrelli aktore.
- Dijetë angleze.
- Rossi në MotoGP.
- Në krye të masave.
- Ai B prek mëlcinë.
- Pak mështesi.
- Me four për nisje nga starti.
- Janë anëtarë të sekteve.
- Kështu fillon idolatria.
- France që që shkrimtar.
- Qe xhelozja e Olimpiti.
- Një "King" James i NBA.
- Një skuadër e Nikosias.
- Iniciolet e Duvall aktor.
- Pak misterioze,
- Piktori i Ura e Namrit.
- Mund të jenë krediti dhe debiti.
- Kështu bëhet ai që i merret erzi.
- Mund të jenë rrethuar në Hamas.
- Jacques le... shkruar nga Diderot.
- Fillojnë argumentin.
- Mund të përmbysin regjime.
- Është habitat i luanëve në Afrikë.
- Mbyllin komentin.
- Në krye të amatorëve.
- Janë barnat.
- Rajone Urbane Durrës.
- Janë kulla xhamie.
- Haza që që këngëtare dhe aktore.
- Janë lloje njerëzish.
- Thonë se nuk gjykohen.
- Bëhet me aprovim.

70. Agjenci Informative Tiranë.

71. U hodhën në Tartar nga Zeusi.

73. Në hyrje të stacionit.

74. Janë situatat për të qeshur.

76. Grupi i vëllezërve Gallagher.

78. Kanë manometra.

82. Kufizojnë katete.

83. Jessica Parker aktore.

86. Është pjesë e operas.

88. Është qytet italian.

89. Janë këmbë oktapodi.

93. Është si mantel.

95. Iniciolet e Rohmer.

96. Bëhet një për të mirë.

97. Një pjesë e ustallarëve.

98. Dundat aktore.

99. Tapeti për judo.

100. Ai dhe ajo

■ VERTIKAL

1. Kanë dhembë të hekurt.

2. Një garë mes sipërmarresh.

3. Ente Prodhuese Autonome.

4. Haxhiu piktur.

5. Ylli i baletit.

6. Liedholm "baroni" i futbollit.

7. Vitet pa lufji.

8. Kështu përfundon fukarai.

9. Michelangelo, alias Caravaggio.

11. Fillojnë nazet.

12. Bëhet e dhe me notë.

13. Atje ku shkon ai që ngjitet.

14. Emri i dikurshëm i Tokyo-s.

15. Një pikë në ligji.

16. Kufizojnë një trup.

17. Ishulli i Odiseut.

18. Ka kryeqytet Kathmandu.

19. Një repart për veshët.

20. Kërkojnë riamatim.

21. Iniciolet e Delon.

23. Janë pa... gojë.

24. Mund të jenë edhe sinagoga.

26. Një është për të mbyllur derën.

30. Është udhëtimi i... Isaac Asimov.

31. Venezia e Mesjetës.

33. Është kopshti me... lule.

35. Ente Tregtare Sarandë.

38. Këndon Nessun dorma.

39. Një mik i Charlie Brown.

40. Një pjesë e cetaceve.

42. Jepen për hartim.

44. Pak polarizimi.

45. Eli këngëtare.

46. Kanë adeluar në parti.

47. Jacques i Monsieur Hulot.

50. Ikin e... s'kthehen më.

52. Mbajnë rroba në dollap.

55. I famshëm ai i Anne Frank.

60. I famshmi Konica

61. Një mund të jetë dallues.

62. Është principi.

63. Pak analogji.

65. Bëhet nuse me ne.

66. Të çara ato të Shollohov.

68. Një i prerë është "Jo".

69. Iniciolet e Adjani aktore.

71. Një argument i paprekshëm.

72. Një fund balerinas.

75. Janë vitet.

77. Një shaka pa çifte.

79. Gjëja e romakëve.

80. Kufizojnë teoremat.

81. Një mund të jetë prove

84. Gjysmë alarmi

85. Është lloj papagalli.

87. Tiran pa kufji.

90. Aktualisht kryesojnë.

91. Kalimi në ekstreme.

92. Kufijtë e lëvizjes.

94. Nisin nga kreu.

HOROSKOPI



Dashi



Demi



Binjakët



Gaforja



Luani



Virgjëresha



Peshorja



Akrepi



Shigjetari



Bricjapi



Ujori



Peshqit

Parashikohet një ditë interesante në drejtim të punës dhe shansve të mira për të përmirësuar raportet me punëdhënësin ose ortakun. Jeta juaj sentimentale premtom momente të këndshme në mënyrë.

Nga ana profesionale jeni në qendër të vëmendjes dhe kjo ka tërhequr vëmendjen e atyre që kanë shumë në dorë të bëjnë për ju. Aferdita pozitive në shenjë do të stimulojë ndjeshëm erosin tuaj.

Pritet një ditë jo edhe aq pozitive nga ana profesionale, por do të jetë shumë më kriuese nga ana sentimentale, sidomos në raportet me partnerin. Kujdes nga euforia që ju pushton herë pas here.

Shkrihen si bora në diell tensionet e këtyre ditëve të fundit, të vënë nën morsetën e Hënës dhe Marsit. Ndërsa ndjenja dhe marrveshja me personin që dashuroni është perfekte.

Me Hënën në kundërshtim do të ndjeni përreth një nervozizëm dhe mos kënaqësi, por asgjë nga këto nuk do të arrijë të vërë në rrezik programet tuaja të ditës dhe projektet e ardhshme.

Hëna tek Demi sponsorizon në një farë mënyre këtë ditë. Eoën për mrekulli ana afektive dhe një ftesë e papritur do t'ju hapë rrugën për t'u futur në një ambient interesant kulturor.

Do të jeni përgjegjës e disa pyetjeve, do të nxirni një shumë parash dhe mund të përfundoni kështu një kontratë biznesi. Jeta në çift shkon për bukuri e përzier me romantizëm dhe pasion.

Nga ana profesionale një projekt që ju e keni shumë për zemër ndoshta ka nevojë për t'u modifikuar ose për t'u shtyrë për një herë tjetër. Kujdes nga gënjeshtrat me partnerin.

Duhet të tregoheni shumë fleksibël në punë në kufij të pranueshëm, diçka nuk do të shkojë ashtu siç doni ju kështu do të detyrohemi të modifikoni paksa planet tuaja.

Hëna është në dispozicionin tuaj dhe dita bëhet menjëherë frenetike dhe e shndërrueshme. Do të keni një forcë shumë të madhe bindëse duke i bindur të tjerët për atë që doni.

Mos kërkoni t'ua a hidhni të tjerëve sidomos njerëzve të familjes, sepse edhe mashttrimet e vogla me qëllim të mirë mund të zbulohen menjëherë dhe pa pandehur.

Dielli që sapo ka hyrë në shenjë tuaj, ju jep energji, ritëm, refleks të shpejta dhe komunikim. Do të jeni të aftë të përpunoni projektet e t'pasuroni me ide të reja dhe brilante.

LAJME
NGA BOTA■ Itali, 37 tërmete
gjatë orëve të natës

Nuk ka qenë një natë e qetë në Itali. Pas tërmetit të së martës që shkatëroi rajonin e Emilias, toka është lëkundur sërish plot 37 herë, duke ushqyer tensionin dhe frikën në zonat ku njerëzit jetojnë në çadra. Sipas raportimeve të mediave italiane, që citojnë autoritetet që mbikëqyrin aktivitetet sizmologjike, 29 lëkundjet janë regjistruar pas mesnatës deri në orën 05:00, në zonën e Emilia Romanjës. Kjo zonë në 10 ditë është goditur nga dy tërmete të dhunshme me fuqi 5.9 dhe 5.8 ballë, që në total kanë shkakuar 24 të vdekur dhe rreth 14 mijë të pastrehë. Gjithësesi, lëkundja më e fortë mes atyre të regjistruara natën që sapo kaloi ka qenë 2.7 ballë në ultësinë lomberdeze, në provincën e Mantovës, e verifikuar në orën 04:16, në një thellësi prej 10 kilometrash. Ndërsa pak pas mesnatës, në orën 00:21, një lëkundje prej 2.6 ballë lëkundti zonat përreth Modenës, të dëmtuara nga tërmeti i dy ditëve më parë.

■ Vetëdjegjet, policia
kineze bastis Tibetin

Forcat kineze të sigurisë kanë kryer një seri bastisjesh në Lasa të Tibetit, ku dhe kanë arrestuar të paktën 600 persona pas dy rasteve të vetëvënies së zjarrit ditën e diel. Dëshmitarë të dy akteve të zjarrvënies janë arrestuar, ndërsa tibetianë nga jashtë Lasës janë dërguar në shtëpi, raportojnë mediat ndërkombëtare. Dy burra tibetianë i vunë flakën vetes jashtë tempullit Jokang, një veprim ky që dukej si një protestë anti-kineze. Incidente të tilla ka pasur shumë në zonat tibetiane jashtë Tibetit, por këto ishin të parat që regjistroheshin në Lasa. Një nga dy personat humbi jetën ndërsa tjetri u mbijetoi plagëve, njofton agjencia e lajmeve "Xinhua", sipas të cilës të dy ata ishin nga zona jashtë Tibetit.

■ Breivik ishte
i droguar gjatë sulmit

Anders Behring Breivik përdori stimulantë përpara se të lëshonte sulmin e tij vdekjeprurës në Norvegji në datën 22 korrik të vitit të shkuar, u bë e ditur gjatë procesit që po zhvillohet në Oslo. Një ekspert i toksikologjisë dhe mjekësisë ligjore, Joerg Moerland, deklaroi në cilësinë e dëshmitarit se vrasësi kishte marrë një përzierje ephedrine, kafeine dhe aspirine. "Mund të thuhet se ai ishte lehtësisht ose mesatarisht i droguar. Substanca ka luajtur një rol stimulant në veprimet e tij", deklaroi eksperti gjatë procesit. Breivik ka pranuar përgjegjësinë e sulmit me bombë në Oslo dhe atë me armë në Utoja, ku 77 persona mbetën të vrarë dhe 242 të plagosur, por mohon përgjegjësinë kriminale për këto veprime.

■ Klinton: Vrasjet në Siri forcojnë pozicionin për veprime më të ashpra Sekretarja amerikane e shtetit Hillary Clinton tha se pas vrasjeve të përditshme në Siri po forcohet pozicioni për veprime më të ashpra ndërkombëtare, por megjithatë, theksoi se për një ndërhyrje ushtarake duhet mbështetja ndërkombëtare, përfshirë aleatën e Sirisë, Rusinë. Duke folur para studentëve në Kopenhagë, Clinton vërejti se OKB-ja dhe mbështetja ndërkombëtare bënë të mundur ndërhyrjen e koalicionit kundër Muamer Gadafit në Libi në vitin e kaluar, por, në rastin e Sirisë, Clinton tha se gjërat po bëhen më të vështira.

■ Copëtoi viktimën dhe i dërgoi
pjesët në zyrat e partive

Një aktor porno nga Kanadaja është shpallur në kërkim ndërkombëtar pasi akuzohet se ka vrarë një person dhe copat nga trupi i tij ua ka dërguar zyrtarëve të partive politike. Luka Rocco Magnotta dyshohet se është arratisur nga Kanadaja. Ai është futur në listën e Interpolit. Sipas BBC, Magnotta i ka postuar të martën një këmbë njeriu zyrës së kryeministrit Stephen Harper, kurse një dorë njeriu e dërgoi në zyrat e Partisë Liberale. Një nga këshilltarët e kryeministrit hapi pakon dhe mbeti i shokuar. Një zëdhënës i partisë tha se ishte dëgjim i merrshme. Dyshohet se viktimë është rreth të 30-ave. Ka po ashtu dyshime se Magnotta ka qenë në lidhje me viktimën.



SHUMË DHURATA NË MAJ

Gjatë muajit MAJ
klientët me blerje mbi 2,000 lekë në TEG,
do të kenë mundësi të fitojnë çmime
çdo fundjavë dhe 1 çmim të madh
në fundjavën e fundit të muajit.
Çmimi i madh përmban një SET Elektroshtëpiak
(Home Cinema, Frigorifer, TV dhe Lavatriçe).

*Lotaria do të hidhet çdo të shtunë, ora 19:00, hyrja e Gjelbërt TEG, duke filluar nga data 12 Maj.
*Lotaria për çmimin e madh do të hidhet ditën e shtunë, datë 2 Qershor, ora 19:00, Hyrja e Gjelbërt, TEG.
*Shënimi emrin, mbiemrin dhe nr. Tel në faturën e blerjes në TEG dhe vendoseni në kutinë e shorteut, Hyrja e Gjelbërt.



**Destinacioni
me i afërt i dhuratave
të mëdha!**

www.teg.al 

• Alba Malltezi
Drejtores e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtores e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Elton Qyno

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
Cel: +355696060418

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë